



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të zhvilluara në datat 20 dhe 21 nëntor 2018.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për statusin e dëshmorit të atdheut”. *(Komision për dhënie mendimi)*
3. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar. *(Komision përgjegjës)*
4. Seancë dëgjimore me kandidaturat për komisioner të Avokatit të Popullit, për vendet vakante në tri seksionet këtij institucioni.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafa, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Petro Koçi- Zëvendësministër i Mbrojtjes.

Ismail Shehu- Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes

Behar Salillari- Përgjegjës i stafit teknik të Komisionit Qendror “Dëshmor i Atdheut” në Ministrinë e Mbrojtjes

Besmir Beja- Këshilltar i ministres së Drejtësisë;

Katrin Treska -Drejtoreshë e Përgjithshme Rregulltarore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

Eljona Bylykbashi- Përgjegjëse Sektori e Reformave Ligjore dhe Përafrimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Mimoza Sadushi- Kryetare e Dhomës Kombëtare të Noterisë

Fatmir Laçe-j-noter

Elona Saliq- noterë

Vladimir Martini- noter

Agnes Bernhard – shefe e Misionit Ndërkombëtar EURALIUS

Tedi Dobi – ekspert vendas në Misionin Ndërkombëtar EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja- Përsëritje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kourumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjet e rendit të ditës.

Sot në rendin e ditës kemi 4 çështje:

Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit

Shqyrtimi i projektligjit “Për statusin e “Dëshmorit të Atdheut”

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar.

Seancë dëgjimore me kandidaturat për komisioner të Avokatit të Popullit, për vendet vakante në tri seksionet e këtij institucioni.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës. A jeni dakord me procesverbalet? Dakord Miratohen procesverbalet e mbledhjeve të datave 20 dhe 21 nëntor të vitit 2018.

Vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relatori i këtij projektligji është deputeti Spartak Braho. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Mbrojtjes: zoti Petro Koçi zëvendësministër i Mbrojtjes, zoti Ismal Shehu, drejtor i Drejtorisë së Programimit të Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, dhe zoti Behar Salillari, përgjegjës i stafit teknik të Komisionit Qendror “Dëshmor i Atdheut”.

Zoti Koçi, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve! Do t’ju lutesha të bënit një prezantim të këtij projektligji për kolegët e Komisionit të Ligjeve dhe pastaj do t’ia kaloj fjalën relatorit Braho.

Petro Koçi – Faleminderit!

Në emër të qeverisë, paraqesim projektligjin “Për statusin e “Dëshmorit të Atdheut””. Qëllimi i këtij ligji është shpallja ose njohja e statusit “Dëshmor i Atdheut” për të gjithë ata persona

që me akte heroizmi kanë kontribuar në luftën për liri, pavarësi dhe çlirim kombëtar, ose mbrojtjen e integritetit territorial, si edhe në luftën kundër krimit, terrorizmit ose në mbrojtje të pronës publike dhe private duke dhënë edhe jetën.

Ligji sjell disa risi në lidhje me ligjin përkatës, së pari, zgjeron kriteret që duhen respektuar për të merituar shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, ndërkohë janë zgjeruar organet e qeverisë vendore, por edhe të tjerë që propozojnë dhënien e këtij statusi Komisionit Qendror për Statusin e Dëshmorit të Atdheut është përcaktuar më mirë lista e dokumenteve që duhen plotësuar për shpalljen e këtij statusi, si edhe, nëse marrim parasysh nenin 5 ku përgjithësisht janë rreshtuar kriteret, për herë të parë ky ligj përcakton edhe rastin e atyre që kanë humbur jetën në protesta paqësore të paarmatosura, siç është rasti i 4 të rënëve më 21 janar, ose edhe të tjerëve, të cilët kanë qenë në mbrojtje të procesit elektoral.

Gjithashtu, në këtë projektligj përcaktohet më mirë edhe rasti i shpalljes dëshmor për ata që kanë humbur jetën gjatë Luftës së Dytë Botërore, sepse shpeshherë për arsye politike shumë shtetas ose persona nuk e kanë marrë këtë status për arsye të gjykimeve të mëvonshme politike. Përveç atyre, që sipas ligjit të sotëm duhet të kishin humbur jetën me armë në dorë, kemi futur edhe kategorinë e njerëzve që kanë qenë mbështetës ose pjesëmarrës në mënyrë të armatosur në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, si edhe të gjithë ata që kanë humbur jetën për shkak të akteve hakmarrëse të ushtrive pushtuese, siç ka qenë rasti i dy ushtrive nazifashiste në vendin tonë dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Ligji përjashton në mënyrë të qartë të gjithë ata që kanë qenë pjesë e formacioneve që kanë bashkëpunuar me pushtuesit dhe që mund të kenë humbur jetën në rrethana të ndryshme. Nga ana tjetër përcakton qartazi rastin e të gjithë atyre që kanë humbur jetën për shkak të torturave në kampet e përqendrimit, gjë që mund të ketë ndodhur edhe pasi kanë kaluar dy vjet nga momenti i daljes nga këto kampe.

Këto janë risitë që sjell ky ligj.

Gjithashtu, përcaktohet më mirë statusi i varrezave të dëshmoreve, që tashmë do të quhen Varrezat e Dëshmorëve “Nënë Shqipëri”, si edhe kompetenca më të qarta për Komisionin Shtetëror të Dhënies së Statusit Dëshmor i Atdheut në procesin e njohjes ose shpalljes së këtij statusi. Njohja si proces është një njohje formale për të gjitha aktet që janë marrë më parë nga institucionet sipas dispozitave përkatëse, që kanë qenë në fuqi ndër vite, kurse sa i përket shpalljes, komisioni bën një gjykim më të thelluar, ndërsa te procesi i njohjes mjafton një dokument që vërteton se për një shtetas është dhënë ky titull ose ky status nga një organ, siç ka qenë dikur

Komiteti Ekzekutiv ose më vonë Kryesia e Këshillit të Ministrave, ndërsa për rastet konkrete që propozohen nga këshillat e bashkive, të qarqeve ose prefekti ose ministri do të bëjë një gjykim më konkret nisur nga shqyrtimi i dokumenteve përkatëse arkivore ose nga ato të kohës për shkak të momentit kur ka ndodhur ngjarja.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Braho.

Spartak Braho – Statusi i Dëshmorit të Atdheut aktualisht është i rregulluar nëpërmjet ligjit nr 8607, të vitit 2000, i titulluar “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”. Gjatë implementimit 18-vjeçar të atij ligji pa dyshim janë evidentuar problematika që lidhen me kriteret, me procedurat, me shpalljen, si dhe me organet që japin të drejtën, duke sjellë me këtë rast edhe nevojën e ndryshimeve, të cilat i ka propozuar Ministria e Mbrojtjes. Kanë bërë propozime të amendamenteve Komiteti i Veteranëve të Luftës Antifashiste e të tjerë.

Nuk do të zgjatem në hollësi të tjera në lidhje me risitë e projektligjit, pasi i tha zoti Koçi, por do të evidentoj disa probleme që projektligji i propozuar duhet t’i ketë parasysh.

Së pari, projektligji zgjeron rrethin e subjekteve që përfitojnë statusin e Dëshmorit të Atdheut. Kjo është një çështje e domosdoshme për t’u theksuar edhe për t’u rregulluar. Së dyti, janë shtuar kriteret që duhet të plotësohen për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” si edhe lista përkatëse e dokumenteve që janë të vlefshme për këtë procedurë. Ligji përjashton nga dhënia e statusit të dëshmorit personat e dënuar me vendim të formës së prerë për krime kundër njerëzimit për bashkëpunim me pushtuesit për veprimtari terroriste dhe agjenturore kundër interesave të Shqipërisë, si edhe për vrasje me dashje pas datës 9 maj 1945.

Njëkohësisht, risi tjetër e projektligjit është zgjerimi i gamës së autoriteteve publike, këshillin bashkiak, ku bëhet kërkesa familjare për shpalljen Dëshmor i Atdheut të personit të tyre. Unë do të shtoja këtu mendimin se në pikën 1 të nenit 10 parashikohet këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, prefekti, ministri përkatës, ndoshta kjo e drejtë duhet t’u jepet edhe deputetëve, megjithatë ta diskutojmë, sepse ka një hallkë tjetër që vendos për këtë, por nuk ka arsye që një deputet, që ka të drejtë të propozojë për ligje, të mos propozojë për dhënien e statusit të Dëshmorit të Atdheut.

Ndërkohë, përmirësim tjetër është procedura e nderimit të “Dëshmorëve të Atdheut” dhe menaxhimit të Varrezave të Dëshmorëve dhe objekteve në nderim të tyre dhe parashikimi i

rregullave për mbështetjen dhe zgjidhjen e veprimtarive të organizatave, të cilat kanë si objekt në veprimtarinë e tyre festat ose momentet që lidhen me nderimin e Dëshmorëve të Atdheut.

Së fundi, risi është edhe zgjerimi i rrethit familjar për efekt nderimi, por jo për trajtim financiar, duke shtuar prindërit e prindërve, bashkëjetuesit, bashkëjetuesen, njerkun, njerken, thjeshtren, si dhe nipat e mbesat e Dëshmorëve të Atdheut.

Çfarë parashikon tjetër projektligji? Unë do të theksoja shkurtimisht disa gjëra që lidhen kryesisht me diskutimin nen për nen të projektligjit, të cilat mund t'i rishikojmë pasi në nenin 2 të projektligjit konstatojmë se janë përdorur terma të tillë, si “akte të rralla patriotizmi, vetëmohimi, heroizmi të jashtëzakonshëm” Duke qenë se këto kritere do të përdoren për njohjen e statusit të “Dëshmorit të Atdheut” dhe dhënien e përfitimeve që parashikohen në projektligj, rekomandojmë që komisioni përkatës përgjegjës të marrë në konsideratë mundësinë e kufizimit të këtyre termave të nenit 4 me qëllim që të shmangen vlerësimet subjektive.

Në nenin 3, ku bëhet fjalë për subjektet, është shprehja “janë të ndjerë”, pastaj vazhdon ““Dëshmorët e Atdheut”, familjarët e tyre”, e të tjera. Këtë fjalën “të ndjerët” e konsideroj gabim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kur të vijojmë te diskutimi nen për nen, ka vërejtje sa u përket formulimeve të disa neneve.

Unë si relator vlerësoj mundësinë e miratimit të këtij projektligji, ndonëse e theksoj se ka ardhur me vonesë nga ana e qeverisë. U propozoj kolegëve ta miratojmë pasi është në përputhje me ligjet e tjera dhe me Kushtetutën!

Ulsi Manja- Faleminderit!

A ka pyetje në lidhje me projektligjin? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen të këtij projektligji.

Ju lutem, zoti Koçi, aty ku keni sugjerime ose komente mund të ndërhyni.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2.

Spartak Braho - Ka një propozim: të hiqen fjalët e mëdha aktet e rralla të heroizmit të jashtëzakonshëm, e të tjerë. Unë them të mos ketë cilësorë të tillë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në ligjin e mëparshëm nuk janë këto cilësorë. Derisa nuk janë në ligjin e mëparshëm nuk kemi pse t'i shtojmë.

Petro Koçi – Këto fjalë janë vendosur për të kufizuar procesin e propozimeve, sepse në praktikën tonë vijnë me dhjetëra propozime për raste të humbjes së jetës për arsye aksidentale dhe vihem në vështirësi morale me njerëzit. Gjithsesi, nëse ka ndonjë këmbëngulje nga komisioni, mund të hiqet njëra nga fjalët, për shembull mund të mbetet “akte të rralla” dhe mund të hiqet “të jashtëzakonshme”. Ideja është që dëshmorë shpallet ai që në rrethana kur është i ndërgjegjshëm se mund të humbasë jetën, ai prapë e kryen aktin e sakrificës.

Elena Xhina- Kur kam qenë në këshill të qarkut, kemi shqyrtuar të tilla dosje. Kishte raste kur ishin vrarë aksidentalisht duke u arratisur ose duke kullotur bagëtitë, vinte kërkesa për t'u shpallur dëshmor. Këto specifika mendoj se e specifikojnë dhe e ngushtojnë rrethin e personave që propozohen për t'u shpallur dëshmor i atdheut.

Mbase mund të heqim fjalën “të jashtëzakonshme”.

Ulsi Manja - Edhe unë jam dakord që fjala “të jashtëzakonshme” është një kategori që nuk do të përcaktohet asnjëherë.

Unë jam dakord me nenin 2, duke hequr fjalën “të jashtëzakonshme”. Propozim i bërë nga zonja Xhina.

Kush është akord me nenin 2, me propozimin për të hequr fjalën “të jashtëzakonshme”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3.

Spartak Braho – Sipas zoti Koçi, pas fjalës të ndjerët presja është gabim. Pra, nuk duhet të jetë presja.

Ulsi Manja - A jeni dakord me nenin 3 duke hequr presjen, siç propozon zoti Braho? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, ka një propozim nga kolegu Hyseni që fjala “të ndjerët” të hiqet fare dhe të mbetet subjekte të këtij ligji janë “Dëshmorët e Atdheut”.

Kush është dakord me nenin 3, me sugjerimin e bërë nga kolegu Hyseni? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4 “Përkufizimet”.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Zoti Manja, unë mendoj t’i sugjeroj komisionit përgjegjës të respektojë rregullin e teknikës legjislativ duke i vendosur përkufizimet në rendin alfabetik.

Ulsi Manja- Dakord.

Atëherë, kush është dakord me nenin 4 me sugjerimin e bërë nga zoti Braho që në pikën 1 të hiqet fjala personit fizik dhe të zëvendësohet me individët. Dhe me sugjerimin e bërë nga kolegja Hysi për komisionin përgjegjës? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 5 “Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut””.

Petro Koçi – Te germa “i” “shtetasit shqiptarë që bien në mbrojtje”, duhet bërë “rënë në mbrojtje”, pra ideja është që edhe kanë rënë, edhe mund të bien.

Ulsi Manja- A jeni dakord me nenin 5 me sugjerimin e bërë nga zoti Koçi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 “Përrjashtimi nga statusi i Dëshmorit të Atdheut

Spartak Braho – Për nenin 6, ndoshta edhe këtu është gabuar me një presje, sepse neni parashikon rastet e përrjashtimit nga titulli “Dëshmor i Atdheut” dhe thuhet: “Ata që janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë: 1, Për krime kundër njerëzimit; 2. Bashkëpunim me pushtuesit e vendit; 3. Veprimtari terroriste dhe agjenturore kundër interesave të Shqipërisë; 4 Vrasje me dashje”, Shprehja “pas datës 9 maj” i përfshin edhe 4 rastet e tjera të mësipërme?

Pra, flitet për vrasjet me dashje pas datës 9 maj?

Dakord.

Petro Koçi-Pjesa përpara ka qenë pjesë lufte dhe nuk mund të hyjmë aty.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – E kam edhe pyetje, edhe diskutim dhe për këtë kërkoj ndihmën e ministrisë. Janë disa akte ndërkombëtare të dala pas Luftës së Dytë Botërore, të cilat klasifikojnë një kategori të gjerë individësh që kanë qenë bashkëpunëtorë, të cilët edhe mund të jenë vrarë gjatë luftës. Historia ka treguar se pas viteve '90-tës një kontingjent i tyre ka gjetur penetrim në hapësirat ligjore për të marrë lavde dhe merita dhe nesër nuk është ndonjë çudi që mund të na bëhen edhe dëshmorë të Atdheut. A mund të futen këtu një pikë e pestë dhe të thuhet: “Të gjithë ata që ndalohen me akte ndërkombëtare”. Pra, ka akte të posaçme, besoj se ju i keni konsultuar, të dala pas Luftës së Dytë Botërore për çështjen e bashkëpunëtorëve të nazi-fashistëve.

Ulsi Manja – Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Projektligji e përcakton se kush është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, pasi mund të jetë nga gjykatë kombëtare ose ndërkombëtare, për bashkëpunim me pushtuesit e vendit. Më pas, kur vijmë te përcaktimi i kategorisë, sigurisht që duhen respektuar të gjitha definicionet ndërkombëtare bazuar në dokumentet...

Alket Hyseni – Titulli i nenit është “Përfshirja nga statusi”. A do t’i përfshijmë këta që bien ndesh me aktet ndërkombëtare...?

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, këtë pikë ne mund ta ezaurojmë, duke ia rekomanduar komisionit përgjegjës, sepse tani nuk jemi në gjendje të gjykojmë se cilat janë aktet ndërkombëtare specifike në këtë drejtim. Pra, ne ia sugjerojmë komisionit dhe nëse ka akte ndërkombëtare specifike për këtë problem mund të shtohen.

Spartak Braho – Çështja është që ne të kemi detyrimin për t’i zbatuar aktet ndërkombëtare.

Ulsi Manja – Hedhim në votim nenin 6. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 6.

Neni 7 “Dëshmorët e shpallur me vendimet e organeve shtetërore të mëparshme”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 7.

Neni 8.

Ulsi Manja – Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Kam një sugjerim për nenin 8, ku pika 3 të hiqet, pasi përmbajtja e saj propozohet dhe integrohet në parashikimet që bën neni 9, pika 2.

Ulsi Manja – Përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes.

Petro Koçi – Jemi dakord.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 8, duke hequr paragrafin e tretë? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 8 me sugjerimin e bërë nga kolegu Braho.

Kalojmë në nenin 9 “Kërkesa për shpalljen “Dëshmor i atdheut” dhe njohjen e statusit”.

Spartak Braho – Kam një sugjerim për nenin 9. Pika 1 sugjerohet të ndryshohet sipas kësaj përmbajtjeje që do t’ju lexoj: “Kërkesa për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor” mund të paraqitet nga përfaqësues të familjes së të ndierit për të cilin kërkohet që të shpallet ose njihet “Dëshmor i atdheut”, ose përfaqësues të autorizuar të organeve shtetërore, Organizata e Dëshmorëve të Atdheut dhe të shoqërisë civile”. Unë dhe deputetët e komisionit shtuam një fjali. Pra, pika 2 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje: “Formati i kërkesës, llojet e dokumenteve që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre përcaktohen me udhëzim të kryetarit të komisionit qendror të statusit “Dëshmor i atdheut””.

Ulsi Manja –Pra, paragrafi i tretë u hoq te neni 8 dhe u shtua te neni 9.

Petro Koçi – Ne jemi dakord me shtesën që bëhet te pika 1, për rastin e deputetit, i cili do të ushtrojë të drejtën për të vënë në lëvizje organin e qeverisjes vendore, i cili ka të drejtën ligjore për ta përcjellë propozimin te komisioni shtetëror për njohjen e statusit.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, meqenëse edhe Ministria e Mbrojtjes është dakord të shtohet te rrethi i personave propozues edhe deputeti, sepse në fund të fundit i zgjedhur është deputeti, populli e ka votuar dhe nuk besoj se ka arsye.

Kush është dakord me nenin 9 me sugjerimet e bëra? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 9.

Neni 10 “Komisioni qendror i statusit “Dëshmor i atdheut”.

Spartak Braho – Në pikën 3 të këtij neni sugjerohet të bëhet ky ndryshim dhe të lexohet në këtë mënyrë: “Rregullat e detajuara për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të komisionit qendror, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve nga shoqëria civile në këtë komision përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Shkronja “b” në pikën 7, të ndryshojë si më poshtë: “Komisioni qendror raporton para Këshillit të Ministrave për përmbajtjen e detyrave të parashikuara në këtë ligj jo më shumë se 1 herë në vit ose sa herë kërkohet nga Këshilli i Ministrave”.

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Në fakt, ky nen është bërë sallatë, nuk ka pse duhet as pika 1 dhe as pika 2 kur hyn te pika 3. Shikoni se çfarë thotë pika 3 e nenit 10: “Pranë Ministrisë së Mbrojtjes krijohet komisioni qendror i statusit “Dëshmorët e atdheut”, i cili është autoriteti që i jep statusin dëshmorit të atdheut”. Kaq mjafton, ndërsa këtu vazhdon: “Sipas propozimit të bërë nga këshilli i qarkut, këshilli i bashkisë, prefekti ose ministritë përkatëse për subjektet në fushën e tyre e të tjera..”.

E dyta, në të thuhet: “Komisioni qendror i statusit “Dëshmorët e atdheut” është organ kolegjal i përbërë nga 7 anëtarë. Ky komision përbëhet nga ministri i Mbrojtjes, nga katër zëvendësministra (nuk thuhet se cilët do të jenë) dhe nga 2 anëtarë të shoqërisë civile”. Pra, këtu është dhënë përbërja se cilët janë, pasi zakonisht në ligj ne i shënojmë, për shembull janë zëvendësministrat si ai i pushtetit vendor apo i Ministrisë së Financave, por nuk e di se si e kanë menduar ata.

Më pas vijmë te pika 3, e cila i rrëzon këto dy të parat dhe në të thuhet: “Përbërja dhe rregullat e detajuara për organizimin, funksionimin (pra edhe përbërja dhe rregullimi), bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave”. Atëherë, pse janë këto dy të parat kur bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave? Në qoftë se do ta vëmë në ligj, zoti kryetar, se si do të bëhet komisioni qendror, unë jam dakord që të jetë pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe të drejtohet nga ministri i Mbrojtjes, por duhet bërë e detajuar siç e kemi bërë edhe për ligjet e tjera. Pra, shtatë anëtarët e përhershëm të komisionit qendror të saj duhet të jenë katër zëvendësministrat e fushave 1, 2, 3 dhe 4, një i shoqatës së bashkive, për shembull, ose i shoqërisë civile, siç e duan këta. Këtu duhet të jenë të pasqyruara saktë dhe drejtë dhe se si do të zgjidhen.

Po vij te pika 5, gjithmonë jam kundër këtyre gjërave, sepse më pas del që marrin nga 19 paga. Shikoni se çfarë thuhet këtu: “Për anëtarët e komisionit sipas Këshillit të Ministrave të caktohet masa e shpërblimit të tyre”. Kë do të shpërblejmë ne, katër zëvendësministrat dhe shoqërinë civile? Do të shpërblejmë ata që i kemi në punë, përveç rrogës që marrin, ne këtu i fusim edhe një nen ku çdo muaj i fusim nga një 200 apo 300-e dhe del dyfishi apo trefishi i pagës i vetë ministrit, edhe i Kryeministrit, edhe i deputetëve.

A ka mundësi të rregullohet ky nen, sepse më duket sikur është pak sallatë?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Spartak Braho – Doja t’i bëja një pyetje juristit. Anëtarët e komisionit aktual, a marrin pagesë?

Ulsi Manja – Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Anëtarët e komisionit marrin shpërblim...

(Diskutime pa mikrofon)

... bëjnë një mbledhje një herë ose dy herë në vit dhe shpërblimi është 3 mijë lekë të reja. Unë jam dakord me zotin Fino, shpërblimi t'u hiqet zëvendësministrave dhe të mbetet vetëm për përfaqësuesit që vijnë nga organizatat e dëshmorëve.

Ky është një rregullim që bëhet për çdo lloj komisioni, nuk është vetëm për këtë komision.

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, fjala për ju.

Alket Hyseni – Ka disa parime mbi të cilat ndërtohen të gjitha komisionet apo strukturat kolegjiale të përkohshme, të cilat monitorojnë qoftë bordet, qoftë këto lloj komisionesh, sepse atje ka një punë ekstra. Çështja nuk qëndron në faktin është zëvendësministri apo jo, kjo nuk ka rëndësi, sepse zëvendësministrat mund të mos futen fare, por kjo është një punë ekstra që bëhet dhe është mbi detyrën e tij funksionale, prandaj ka një shpërblim simbolik. Ju lutem, mos ta harxhojmë kohën me këto gjëra, sepse këto janë rregulluar me ligj të posaçëm, edhe me vendim të Këshillit të Ministrave. Zoti Fino, mendoj se nuk është ky problemi, për 5 anëtarët që janë aty...

(Diskutime pa mikrofon)

Kjo nuk na prish punë, por e rëndësishme është ta theksojmë nga ana e teknikës legislative, ajo që tha edhe zoti Fino, pasi këtu ka një kakofoni, prandaj përbërjen ose do ta zgjidhim në nen ose do t'i biem shkurt dhe të themi që Këshilli i Ministrave rregullon përbërjen e të tjera dhe ta mbyllim, në të kundërt do të merremi ne me detajet ose do t'ia lëmë Këshillit të Ministrave. Jam dakord për këtë gjë, ndërsa sa i takon pjesës tjetër për pagesën...

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Këto nene plotësojnë njëri-tjetrin, ligji përcakton skemën me të cilin do të ngrihet komisioni dhe autoritetin që përcakton emrat përkatës, që është Këshilli i Ministrave. Nuk mundemi ne që në ligj të përcaktojmë emrat e dikastereve, sepse ju e dini që herë pas here dikasteret e ndryshojnë emrin. Ne nuk mund të themi zëvendësministri i Shëndetësisë, i Infrastrukturës, i Drejtësisë e të tjera, sepse herë pas here qeveritë i ndryshojnë emrat e dikastereve, prandaj lihet në këtë mënyrë, si dhe i lihet autoritet Këshillit të Ministrave të përcaktojë konkretisht ata katër zëvendësministrat, sepse siç jua thashë ndryshon emri i dikasterit.

(Diskutime pa mikrofon)

Bashkim Fino – Katër zëvendësministrat dhe dy anëtarë të shoqërisë civile...

(Diskutime pa mikrofon)

Çfarë do të japin këta, kur mund të ishte një përfaqësues i qarkut, i bashkive apo i shoqatave se ata në fund të fundit vijnë me propozime. Pse duhet nga shoqëria civile kur këtu janë shumë shoqëri civile?

Ulsi Manja – Shoqërinë civile e kemi për të rritur transparencën, zoti Fino, në çdo bord.

Petro Koçi – Në këtë nen te pika 3 ka një propozim, të cilin e ka relatori dhe ne jemi dakord me atë propozim.

Ulsi Manja – Po, zoti Braho, që ta mbyllim diskutimin për nenin 10.

Spartak Braho – Zakonisht ndryshimet e emërtimeve të dikastereve bëhen në rastet kur krijohet një kabinet i ri qeveritar. Në qoftë se e keni parasysh, emërtimet e reja konfirmohen dhe emërtimet e vjetra zerohen me një shtesë që bëhet në atë ligj, ku evidentohet fakti që nominimet e vjetra ndryshojnë. Në rastin konkret ne mund ta vëmë, por ajo që mund të themi nuk qëndron në faktin se ndryshojnë qeveritë apo emërtimet, problemi është se duhet të jemi konkretë. Për shembull, në emërtimet e anëtarëve që vijnë nga shoqëria civile apo Komiteti Kombëtar i Veteranëve, pasi kemi dy Komitete Kombëtare të Veteranëve. A do të jenë ata pjesë?

Petro Koçi – Mund të jenë njëri nga Komiteti Kombëtar i Veteranëve dhe tjetri nga Organizata Kombëtare “Dëshmorët e Atdheut”. Ju e dini që organizatat mund të shtohen dhe mund të ndryshojnë ndër vite, prandaj kjo mbetet fleksibël që qeveria të gjykojë se cila organizatë është më e rëndësishme dhe që ka më shumë peshë në publik.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Koçi!

Po, zoti Doshi.

Tom Doshi – Petro, pse mos të jetë edhe një përfaqësues nga të persekutuarit politikë, sepse po lini dy organizata që përfaqësojnë komunistët? Edhe këta kanë të drejtën e tyre, pasi edhe ata kanë dëshmorë. Unë mendoj se duhet të jetë edhe një përfaqësues nga të persekutuarit politikë, pasi ju na e bëtë si në '44-ën, vetëm veteranët. Edhe të persekutuarit kanë të drejtën të kenë një anëtar.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Doshi!

Sa i takon nenit 10, që ta mbyllim diskutimin për këtë nen, jam dakord të reflektojmë çështjen e teknikës legislative lidhur me riformulimet që propozohen, qoftë për pikën 3, por edhe për pikat e tjera të nenit 10.

A ka sugjerime të tjera? Nuk ka.

Hedhim në votim nenin 10 me sugjerimet përkatëse për komisionin përgjegjës.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, për ta detajuar edhe sugjerimin e kolegut Fino. Pra, të gjitha sugjerimet e teknikës legislative që u bënë nga kolegët Braho, Fino dhe Hyseni të reflektohen te neni 10 dhe t'i përcillen komisionit përgjegjës.

Kush është dakord me nenin 10? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 10.

Kalojmë te neni 11 “Komisionet vendore”.

Spartak Braho – Në nenin 11, pika 4 sugjerohet të hiqet, pasi në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 54 dhe 77, këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarkut vendosin për rregullat, procedurat dhe mënyrën e realizimit të funksioneve të deleguara. Pra, ata vendosin vetë se e kanë të parashikuar.

Pika 4 të hiqet.

Ulsi Manja – Përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes.

Behar Salillari - I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë,

Për këtë pikë, qëllimi pse është futur afati 1-mujor ka qenë unifikimi i procedurave për shqyrtimin e rasteve kur ka kërkesa për dëshmor i Atdheut. Është e qartë se ka një ligj për vetëqeverisjen vendore, por ky është një funksion i deleguar qeverisjes vendore dhe nëse ne e lëmë të hapur pa përcaktuar afat i bie që Këshilli Bashkiak Dibër për 3 muaj, Vlora 2, Tirana 7 e të tjera, nuk do të ketë një procedurë të saktë dhe të mirëpërcaktuar për kërkesat që mund të vijnë nëpër zona të ndryshme të Shqipërisë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Ky nen duhet rregulluar në funksion me ligjin e pushtetit vendor, sepse nuk është i rregulluar ashtu siç duhet. Po ta lexoni me kujdes nenin dhe gjithë pikat e tij, nuk krijohet problem brenda 1 muaji, pasi në ligj mund të vihet që brenda 1 muaji organet e pushtetit

vendor duhet të marrin vendimet përkatëse, por po t'i shihni të gjitha nenet përkatëse thuhet: këshilli i qarkut, këshilli i bashkisë ose i prefektit. Unë mendoj se fjala “prefektit”, duhet eliminuar.

Pse duhet eliminuar, zotërinj të Ministrisë së Mbrojtjes? Prefekti ratifikon vendimet e këshillit të bashkisë dhe të këshillit të qarkut, ai nuk është shtojcë e tyre. Kjo do të thotë se në qoftë se komisionet e këshillit të bashkisë përkatëse apo të këshillit të qarkut përkatës brenda një muaji e miratojnë një kërkesë përkatëse, gjithmonë çdo vendimmarrje që merr këshilli i bashkisë dhe i qarkut për efekt i ratifikon dhe kjo do të thotë se këto ligje juridikisht janë të rregullta. Më pas e ka vetë në dorë prefekti këtë vendim të këshillit të qarkut që të ndihmon ty, sepse ti je organ ekzekutiv dhe mund t'i kërkohet llogari prefektit ma sill këtë material.

Këtu thuhet: “Meqenëse këshilli i bashkisë dhe këshilli i qarkut mund ta kalojnë”, ti thua “ose të prefektit”, pra në qoftë se nuk e sjellin ata, do ta sjellë prefekti. Jo, nuk është kështu. Unë mendoj se duhet rregulluar terminologjia në funksion me ligjin e pushtetit vendor, pasi nuk është siç duhet. Prefekti nuk është shtojcë e këshillit bashkiak dhe e këshillit të qarkut.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Unë kam një qasje për shtesë, pasi nuk e kuptoj përse duhet të jenë edhe këshillat e bashkive dhe këshillat e qarqeve, pasi po u ngarkojmë disa gjëra kot. Ne kemi këshillin e bashkisë, ku ezaurohet kërkesa për një individ në nivel lokal të këshilli i bashkisë, prandaj për çfarë duhet të jetë këshilli i qarkut?

(Diskutime pa mikrofon)

Të drejtën e propozimit po ngremë tani dhe këtë ia japim këshillit të bashkisë, ndërkohë këtu janë të kundërt. Pra, mund t'ia japim prefektit, i cili është një organ më i përqendruar dhe më i shpejtë në vendimmarrje se sa këshilli i qarkut, i cili mbledhet një herë në disa kohë. Nga praktika kemi raste ku efektivë të Policisë së Shtetit ose të ushtrisë bien në krye të detyrës dhe për këtë arsye duhen marrë disa vendime të shpejta për t'i nderuar në kohën e duhur kur bëhen ceremonialet e përcjelljes së tyre. Pra, të presim këshillat e qarqeve...

(Diskutime pa mikrofon)

Kam një mendim, meqë nëse nuk është te ligji specifik për pushtetin lokal t'i thjeshtojmë disa gjëra, t'ia lëmë këshillit të bashkisë dhe të mos ia lëmë këshillit të qarkut, sepse i japim kot kompetenca.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Risia në këtë nen është vendosja e këshillit të bashkisë për herë të parë si autoritet propozues, pasi këshilli i qarkut dhe prefekti kanë qenë. Prefekti, është subjekt propozues më vete. Pra, sigurisht prefekti e kalon, në rastin kur propozimi vjen nga bashkia apo qarku, jep një gjykim lidhur me ligjshmërinë e aktit, por ai e ka vetë autoritetin për të bërë propozimet përkatëse.

Në këtë rast ligji rrit numrin e autoriteteve që kanë fuqi propozuese. Meqenëse ne kemi shtuar kriteret për të shpallur dëshmorë, sidomos sa i takon Luftës së Dytë Botërore, kemi zgjeruar edhe numrin e organeve që mund ta bëjnë këtë gjë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Koçi!

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Jam absolutisht....

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti kryetar, pak rregull, ju lutem, se duhet të dëgjohet në audio ajo që do t'ju them, pasi nuk e kam as për Tomën dhe as për Alketin!

Ulsi Manja – Keni të drejtë, zoti Fino. Ju lutem, pak qetësi dhe ta mbyllim këtë ligj, pasi kemi një ligj tjetër shumë voluminoz për të diskutuar!

Bashkim Fino – Jam kundër, zoti kryetar, sepse të drejtën për të propozuar e kanë organet e zgjedhura dhe jo organet e emëruara. Këta e kanë rregulluar në ligj dhe po të lexosh nenin 12, për të gjitha rastet, sepse ne sapo kaluam në nenin 5 kush shpallej dëshmor, apo jo? Për ato raste që shpallet dëshmor duhen organet e pushtetit vendor dhe ato duhen respektuar. Në organet e pushtetit vendor janë kryetari i bashkisë, këshilli i bashkisë, kryetari i qarkut, këshilli i qarkut, por jo prefekti, ai nuk është. Prefekti është ratifikues i vendimeve lokale që merr bashkia apo qarku, është emëruesi, një i emërtuar nga ministri qoftë ai i Mbrojtjes apo i Brendshmi. Kjo gjë është rregulluar në nenin 12, në të cilin thuhet: “Në rastet e të rënëve sipas shkronjave “Gj”, “H”, “I”, “J” e të tjera, ka të drejtë të propozojë edhe ministri”. Kjo do të thotë që të drejtën e propozimit nga lart e ka ministri dhe nuk është e nevojshme të vihet prefekti. Pra, nuk shkon që një njeri i vetëm në një qark të propozojë njësoj për dëshmor kur propozon një këshill bashkie apo një këshill qarku që janë edhe pluripartiak, atë që e tha pak më parë kolegu Doshi, sepse janë të zgjedhur nga populli, ndërsa prefekti është i emëruari i qeverisë, prandaj nuk duhet të jetë fare këtu. Prefekti vetëm ratifikon vendimet.

Sa u takon të gjitha rasteve të tjera, që nuk u interesojnë organeve të pushtetit vendor, është zgjidhur te neni 12, ku ministri sjell dhe propozon që ky të jetë dëshmor i Atdheut, për këtë apo për atë rast. Pra, nuk duhet të jetë prefekti, pasi në këtë mënyrë i japim një detyrë kot prefektit, për mua personalisht, pasi barazojmë vendimet e këshillit të bashkisë dhe të qarkut me... propozimi që ka të bëjë me prefektin, një njeri me 50 e ca veta këshilltarë.

Kjo është pikëpamja ime për shkak të njohjes së pushtetit vendor.

Ulsi Manja - Kam vetëm një pyetje lidhur me nenin 11, pika 4: prefekti është futur për të respektuar afatin 1-mujor, për të konfirmuar vendimet e këshillit të bashkisë, apo...?

(Diskutim pa mikrofon)

E keni futur si subjekt propozues dhe jo organ që konfirmon vendimin e këshillit bashkiak?

(Diskutim pa mikrofon)

Pse duhet të jetë prefekti këtu? Ne i miratuam te neni 9 se cilat janë subjektet propozuese.

(Diskutim pa mikrofon)

Në momentin që ke thënë “organet shtetërore” pse duhet të jetë i cituar prefekti këtu?

Petro Koçi - Janë veç organet që bëjnë kërkesën dhe veç organet që bëjnë propozimet. Janë dy gjëra të ndryshme.

Ulsi Manja - Edhe mua, në fakt, më duket e ekgagjeruar që prefekti të ketë të drejtën të propozojë për t’u bërë dëshmor i atdheut!

Alket Hyseni – Këtu nuk po flitet se cili e ka të drejtën e propozimit. Të drejtën e propozimit e kanë shumë organe shtetërore, që patjetër, brenda tyre, janë të gjitha të pushtetit lokal, edhe prefekti është, por këtu po flasim se cilat organe kanë të drejtën të ngrenë komisionet lokale dhe vendore dhe këtu janë përcaktuar 3. Unë gjykoj që janë shumë, duhet të jenë 2. Nëse do të jetë bashkia dhe prefekti, apo bashkia dhe këshilli i qarkut, ejani ta diskutojmë, por 3 s’mund të jenë. Ngelëm duke ngritur komisione pafund. Këtu bie dakord me Bashkimin, që të gjitha këto komisione kanë edhe një shpërblim. Kështu që, ejani të ngremë vetëm 2, një në bazë bashkie dhe një në bazë qarku, nëse doni, por nuk ka nevojë të jenë 3.

Ulsi Manja - Një koment të fundit nga Ministria e Mbrojtjes lidhur me nenin 11, pika 4.

Petro Koçi – Ka shumë raste, pavarësisht se ne tashmë kemi futur autoritetin e këshillit të bashkisë, që besoj se do ta lehtësojnë këtë proces, por në shumë raste ka qenë e vështirë me këshillat e qarqeve për të gjykuar për kërkesat që kanë bërë familjarët apo shoqata të ndryshme.

Kini parasysh këtu edhe kontekstin politik, sepse shpesh ka vendosur mbi shpejtësinë apo ngadalësinë e gjykimit të një këshilli të caktuar. Prandaj është vënë edhe prefekti, i cili ka 18 vjet që e ushtron këtë lloj të drejte. Ne mendojmë që duhet të mbetet, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne tashmë kemi zgjeruar mundësinë e shpalljes “Dëshmor” të shumë individëve, të cilët kanë humbur jetën, sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ju e dini që, për shembull, në rastin e masakrës së Borovës, 101 të vrarë quhen viktimë, nuk quhen dëshmorë. Me këtë ligj do të shpallen “Dëshmorë të Atdheut”, po dikush duhet t’i propozojë. Pra, duhet një shpejtësi veprimi dhe ndaj është vënë këshilli i qarkut, ai i bashkisë dhe prefekti.

Ulsi Manja - Po, faleminderit!

Besoj se debati është ezauruar për këtë pikë.

E hedhim në votim nenin 11, sipas variantit që është propozuar. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 12.

Ju lutem, zoti Braho, të ecim pak më shpejt!

Spartak Braho – Te neni 12 propozohet një sugjerim në pikën 8: “Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut të mbajnë statusin e varrezave monumentale...”

Ulsi Manja - Jemi te neni 12.

Spartak Braho – Kërkoj ndjesë! Jeni dakord me nenin 12.

Alket Hyseni – Përveç ministrit, mund të ketë situata me Shërbimin Informativ, që nuk është në varësi të asnjë ministri, kështu mendoj të shtohet një togfjalësh: “Ministri apo titullari më i lartë i fushës së përgjegjësisë”. Sepse nuk e kemi të qartë se si do të veprohet në rastin e shërbimit informativ.

Petro Koçi – Prapë një ministër e bën, mund ta bëjë ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm apo një ministër tjetër, sepse janë organe që bashkëpunojnë. Kështu është vepruar edhe më parë. Mos harroni që edhe ministrat kanë një kryeministër e kështu me radhë.

Ulsi Manja - Nuk besoj se ka sugjerime për nenin 12. E hedhim në votim nenin 12. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 13 “Vendprehja e dëshmorëve të atdheut”.

Spartak Braho - Në pikën 8 sugjerohet të bëhet ky ndryshim me përmbajtjen: “Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut mbajnë statusin e varrezave monumentale dhe trajtohen si monumente kulture, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin publik të varrimit dhe të trashëgimisë kulturore”.

Ulsi Manja - Pra, kemi riformulim të pikës 8 të nenit 13. Jeni dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 14, “Ceremonia e varrimit të dëshmorit të atdheut”.

Nuk ka sugjerime me sa shoh nga relacioni për nenin 14.

E hedhim në votim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15 “Objektet në nderim të dëshmorëve të atdheut”.

Spartak Braho - Në fund të pikave 2 dhe 3 të shtohet shprehja “në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për trashëgiminë kulturore”.

Ulsi Manja - Kush është dakord me sugjerimin në nenin 15, që në fund të pikave 2 dhe 3 të shtohet kjo shprehje?

Petro Koçi – Bëhet fjalë për lapidarë e pllaka përkujtimore, jo për varreza. Ato janë dy gjëra të ndryshme.

Spartak Braho - Po, pra, lëvizja e tyre të bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi, se mund t’i teket dikujt dhe ta heqë lapidarin nga ky vend se duhet ta spostojmë në një vend tjetër.

Ulsi Manja – Këtë sygjërim bëri kolegu Braho, pra “Lëvizja e objekteve në nderim të dëshmorëve të atdheut të bëhet në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për trashëgiminë kulturore”.

Ismail Shehu - Këtu është parashikuar një procedurë e thjeshtë ku janë vetë këshillat që i kanë ngritur këto pllakata lapidare që do t’i lëvizin prapë. Pra do të ketë një vendimmarrje të një organi publik për të bërë këtë lëvizje. Në qoftë se hyjmë të respektojmë rregullat e trashëgimisë kulturore, ejani të flasim se çfarë është trashëgimi kulturore, një pllakatë me një emër, siç kemi në Ministrinë e Mbrotjtjes të rënët e Tekenit, që nuk është objekt i trashëgimisë kulturore. Në atë pikë nuk ka vend për të futur këtë fjalë. Kjo ka qenë arsyeja.

Petro Koçi – Ka raste kur bëhen rregullime urbane, për shembull, dhe po që se do të pengohet dhe do të vonohet rivendosja e një pllake...

Ulsi Manja – Do të vështirësohet procedura e zhvendosjes në rast se do të ketë shpronësim publik ose vepra publike. Ju mendoni se ky përkufizim e vështirëson procedurën?

Vasilika Hysi – Faleminderit, kryetar!

E kuptoj shqetësimin e drejtë të kolegut Braho duke pasur parasysh se si është zhvendosur monumenti i “5 Heronjve të Vigut” në Shkodër, që nuk është në dinjitetin e askujt prej nesh, por nga ana tjetër, jam dakord edhe me shqetësimin që ngriti përfaqësuesi i qeverisë, që, në qoftë se do të futen edhe përmendoret, pllakat përkujtimore në veprimtaritë ose objektet e kulturës, ka një procedurë të zgjeruar në bazë të ndryshimeve me ligj që kemi miratuar për monumentet kulturore.

Kam një pyetje: kur ju thoni në projektligj, që këtë e kërkojnë interesat e larta shtetërore, nuk e kuptoj cili është interes i lartë shtetëror. Është shumë i paqartë! Thoni me vendim, ose me urdhër të autoritetit që e ka ngritur. Në rast se ne rregullojmë këtë dhe adresojmë shqetësimin që ngre me të drejtë kolegu Braho, do të ishte një balancim shumë i mirë dhe mund t’i sugjerojmë komisionit përgjegjës për ta rregulluar këtë pjesë.

Spartak Braho – Mund ta heqim dhe ta lëmë: “...në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, ta përfundojë zoti Braho!

Spartak Braho – Ky ligj nuk ka të bëjë për trashëgiminë kulturore, ndaj them ta heqim.

Ulsi Manja – Më duket se pika 2 e nenit 15 është e riformuluar saktë. Ai që ka disponuar me vendim apo urdhër për ta ngritur këtë përmendore, lapidar, pllakatë përkujtimore, po ai organ shtetëror disponon edhe për të kundërtën. Pra, në qoftë se ngritja e një lapidari ka qenë vendim i këshillit bashkiak, po me vendim të këshillit bashkiak do të zhvendoset për interesa të larta shtetërore. “Interesa të larta shtetërore”, mund të ishte më e saktë “interes i lartë publik”, sepse nuk jam në gjendje ta dalloj se cili mund të jetë një rast i interesit të lartë shtetëror. Për shembull, një projekt rruge nuk mendoj që është interes i lartë shtetëror, por interes publik, kështu që fjala “shtetërore” mund të zëvendësohet me fjalën “interes publik”, madje më mirë i thënë thjesht, se nuk mund të jetë i lartë ose i ulët interesi publik.

Vasilika Hysi - A mund të shtoj diçka?

Në këtë kuadër, kur për një interes publik mund të ketë zhvendosje të një lapidari, duhet të parashikojmë që ai që e zhvendos dhe që ka urdhëruar zhvendosjen, të vërë një përkujtimore a një pllakë, jo ta lerë mënjanë. Pra, të rregullohet situata.

Alket Hyseni – Flitet për zhvendosje, jo heqje.

Zoti kryetar, unë kam një shqetësim! Në tërë këto vite, ka pasur një situatë kur këto objekte të rëndësishme të memories sonë historike janë lënë pa mirëmbajtje. Ky ligj mund t'i rregullojë, por vetëm përdorimi i një termi “mirëmbahet” dhe “ruhet” pa u thënë nga kush dhe cili, mendoj se duhet rregulluar. Ky është ligji i vetëm ku mund ta rregullojmë. Pra, duhet të themi: “Pavarësisht kush e ndërton, mirëmbajtjen dhe ruajtjen do ta ketë pushteti lokal në juridiksionin e të cilit ...”. Pra, në momentin që këto objekte hyjnë në këtë kategori, që rregullohen me ligj të veçantë, duhet të përcaktohet edhe organi i mirëmbajtjes, sepse kanë ngelur jetime, janë katandisur në turp në vend të memories historike, dhe kur vijnë turistët e huaj habiten. Ose të mos e rregullojmë, të mos i fusim në ligj!

Ulsi Manja - Fjala për përfaqësuesin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Behar Salillari – Për zhvendosjen dhe mirëmbajtjen u sqaruam që është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe mirëmbajtja me të njëjtën logjikë ecën. Nuk janë vetëm këshillat bashkiakë e pushteti vendor, kemi pafund përmendore, lapidarë e pllakata nëpër prona që janë nën përgjegjësinë e administrimit të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe ministrive të tjera. Në këto raste mirëmbajtjen, ruajtjen, përmirësimin, zbukurimin etj., i kanë vetë këto institucione. Të gjitha pllakatat dhe përmendoret që janë brenda reparteve ushtarake, i mbajmë, ruajmë dhe administrojmë ne dhe nuk mund t'i kalojnë pushtetit vendor.

(Diskutim pa mikrofon)

Të mos ia lëmë logjikës këtë, siç kemi bërë gjithë këto vite, por të bëjmë diferencën midis atyre që janë brenda reparteve ushtarake dhe atyre që janë mes malesh e u kanë marrë edhe gurët.

Ulsi Manja - Po, zoti Çuçi.

Bledi Çuçi – Në lidhje me këtë, le ta bëjmë sipas listës së përkatësisë që miratohet nga Ministria e Mbrojtjes. I japim të drejtën për të nxjerrë një akt nënligjor Ministrit të Mbrojtjes, i cili bën një inventar të hollësishëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu do të thuhet se bëhet nga pushteti lokal, domethënë do të numërohet, por sipas listës, se në ligj nuk mund të vëmë listë, se është absurde. Duhet t'ia lemë një organi ekzekutiv si ministria që të bëjë listën, por ama detyrimin që ta kenë edhe pushteti vendor për ato që ka, edhe ministrinë

apo agjencitë e tjera qeveritare, këshilli i qarkut në disa vende, si detyrim t'ua njohim me ligj dhe t'ia delegojmë ministrit të Mbrojtjes me një akt nënligjor të bëjë listën e përkatësisë.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Çuçi!

Zoti Hyseni ka një formulim konkret.

Alket Hyseni – Jam i mendimit të bëjmë një formulim konkret këtu: në pikën 1 të heqim pjesën, ta ndajmë si fjali...

Spartak Braho – Na mungon inventari total. Këtë do të bëjmë. Duhet të kërkojmë inventarizimin e tyre.

Alket Hyseni – Pika e parë të ndahet në dy fjali, njëra që flet për ngritjen, se po ta shohim, e kemi të ndërtuar në dy pjesë, themi “ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen”, “ngritjen” fjalia e parë siç është, pra “ngrihen pllaka përkujtimore, përmendore, si dhe emërtohen mjedise e institucione publike” dhe do të heqim vetëm fjalët “mirëmbahen dhe ruhen lapidarët” dhe kalon fjalia e dytë, “mirëmbahen dhe ruajtja kryhet nga organet e pushtetit lokal apo ministria, e cila ka urdhëruar ngritjen, sipas listës së miratuar nga Ministria e Mbrojtjes”.

Petro Koçi – Kjo mund të bëhet duke ndryshuar renditjen, pra fjalën “ngrihen” mund ta lëmë në fund dhe ta nisim “mirëmbahen, ruhen ose ngrihen” pra, të mos e ndryshojmë shumë fjalinë, se kam përshtypjen...

Ulsi Manja - Do të doja një mendim nga kolegët, përtej propozimit të zotërinjve Çuçi dhe Hyseni, e zgjidh shqetësimin që kemi nëse do të themi te pika 1 e nenit 15 “Brenda territoreve nën juridiksionin e tyre ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen, sipas fushës së përgjegjësisë lapidare, pllaka përkujtimore, përmendore dhe emërtime në institucionet publike”. Pra, secili sipas fushës së përgjegjësisë që ka, Ministria e Mbrojtjes për të vetat, pushteti vendor po ashtu, kanë për detyrë ngritje, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di nëse Ministria e Mbrojtjes do të mundet të miratojë inventarin e objekteve në varësi të bashkisë, sepse ata janë organe të zgjedhura në fakt. Bashkia, këshilli i qarkut e kanë inventarin e vetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Them se duke shtuar fjalët “sipas fushës së përgjegjësisë që kanë” e zgjidhim.

Petro Koçi – Ose “sipas përgjegjësisë përkatëse”.

Ulsi Manja - Më e sakta do të ishte “sipas përgjegjësisë përkatëse”.

Kush është dakord me nenin 15 me sugjerimin e bërë te pika 1? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16 “Dita përkujtimore e dëshmorëve të atdheut”.

Nuk ka sugjerime për këtë nen. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17 “Organizimi i ceremonive përkujtimore”.

Zoti Braho nuk ka sugjerime.

E hedhim në votim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 18. Për këtë nen ka një sugjerim.

Spartak Braho – Sugjerohet komisioni përgjegjës të vlerësojë heqjen e shprehjes “dhe kur bashkëshorti/bashkëshortja e dëshmorit të atdheut martohet përsëri”.

Ulsi Manja - Pra, sugjerohet të vlerësohet heqja e shprehjes “dhe kur bashkëshorti/bashkëshortja e dëshmorit të atdheut martohet përsëri”.

Jeni dakord me këtë sugjerim?

(Diskutime pa mikrofon)

Ka edhe një sugjerim për pikën 4, të ndryshohet “Shpërblimi familjar tërhiqet nga secili familjar sipas pjesës që i përket, nga kujdestari ligjor për fëmijët nën moshën 18 vjeç, ose nga përfaqësuesi i pajisur me prokurë”. Është një sugjerim që bëhet në pikën 4.

Spartak Braho – Jam dakord me këtë që propozuam.

Ulsi Manja – Kalojmë nenin 18 me sugjerimin e bërë për pikën 3, që pjesa të hiqet. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 19 “Simbolet e statusit të dëshmorit të atdheut”.

Nuk ka vërejtje për këtë nen. E hedhim në votim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet neni 19.

Neni 20 “Organizatat e dëshmorëve të atdheut”.

Edhe për nenin 20 nuk ka vërejtje dhe sugjerime. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21 “Organizimi i familjeve të dëshmorëve”.

Edhe për nenin 21 nuk ka vërejtje dhe sugjerime. Kush është pro? Kundër? Abstenim?
Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22, “Marrëdhëniet e organizatave me organet shtetërore”.

Fjalën e ka zoti Braho.

Spartak Braho – Ky nen është pak deklarativ dhe i paqartë, prandaj kërkoj ndihmën e përfaqësuesve të ministrisë për ta sqaruar. Ndoshta duhet ndryshuar diçka ose ta lëmë kështu, nuk e di çfarë mendimi kanë përfaqësuesit e ministrisë.

Ulsi Manja – Fjalën e ka përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes.

Petro Koçi – Është e vërtetë që ky nen ka pak karakter deklarativ, por duhet të dini që gjatë shqyrtimit të këtij propozimi me organizatat, kryesisht me Organizatën Kombëtare të Dëshmorëve të Atdheut, ka pasur insistim që shteti të marrë rol financiar. Ne këtë nuk e kemi pranuar, por kemi bërë një kompromis që të mbetet te fjala “mbështet” dhe “nxit”.

Ulsi Manja – Për sa kohë që shteti nuk merr përsipër pjesën financiare ky nen le të jetë deklarativ.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mua më duket korrekt formulimi i nenit 22, për sa kohë shteti nuk merr për sipër pjesën financiare, organizatat janë të lira...

Petro Koçi – Sepse ka shumë organizata.

Ulsi Manja – Nuk mundet shteti t’i japë mbështetje financiare sa organizata dhe shoqata mund të krijohen në këtë fushë.

Hedhim në votim nenin 22, sipas formulimit që është në tekst. Kush është pro? Kundër?
Nuk ka. Abstenim? 1 votë.

Miratohet.

Neni 23 “Ankimi”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho – “Kundër vendimit të këshillit bashkiak, të këshillit të qarkut apo perfektit që refuzojnë të pranojnë kërkesën ose kur këto organe nuk marrin në shqyrtim kërkesën brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim pranë

gjykatës kompetente në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Pika 2: “Kundër vendimit qendror të statusit: “Dëshmorë të Atdheut”, si dhe në rastet kur ky komision nuk shprehet brenda afateve të përcaktuara në pikën 7 të nenit 10 të këtij ligji, subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim pranë gjykatave kompetente”.

Pra të lëmë një dritare...

Ulsi Manja – Mua më duket se rifomulimi është i karakterit të teknikës legjislative.

Fjalën e ka zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Unë jam dakord me frymën e zotit Braho, por për pikën e parë të drejtën e ankimit mund ta japim edhe pranë Komisionit Qendror. Pra, bëhet fjalë për një procedurë kërkesë paraprake. Pra, kur njerëzit mund të gjejnë zgjidhje pranë organit më të lartë “administrativ”, që në këtë rast është Komisioni Qendror, përse t’i përplasim nëpër gjykata? Për pikën e parë unë them që shkalla më e lartë administrative të jetë Komisioni dhe pastaj të shkojë në gjykatë.

Për shembull, nëse pushteti lokal nuk e merr në shqyrtim me të padrejtë, atëherë qytetari shkon te Komisioni, i cili është filtri i fundit administrativ. Nëse Komisioni e gjykon të drejtë pranon kërkesën dhe fillon procedurat, por, nëse e gjykon të gabuar, atëherë qytetari t’i drejtohet gjykatës për të gjetur të drejtën. Pra t’u japim një rrugë më të shkurtër dhe të mos i përplasim individët direkt dhe në gjykatë, për sa kohë kemi një organ administrativ qendror në shkallë republike.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjalën e ka përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes.

Petro Koqi – Këtu ka një problem. A mund t’i japim autoritet këtij komisioni që të shqyrtojë një vendim të këshillit bashkiak, që ta rrëzojë ose jo? E para.

E dyta, në praktikë ka ndodhur e kundërta, përgjithësisht propozimet kanë ardhur duke i tejkaluar kriteret që duhen respektuar për të shpallur statusin “Dëshmor i atdheut”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në tejkallim ne i rrëzojmë propozimin në komision.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Zoti kryetar, duhet të kuptojmë që kjo nuk është një kompetencë që buron nga pushteti lokal si organ, por është një kompetencë që ia jep ligji, pra nuk e involvon atë me çështjen e të votuarit dhe procedurën ta iniciojë në bazë tek organet e pushtetit lokal. Kjo nuk bie

ndesh me asnjë parim të autonomisë lokale. Pra nuk shprehet një parim i autonomisë lokale, por ka disa kriterë formale që ia jep ky ligj për statusin dhe mbi bazën e këtyre kriterëve nis procedurën komisioni i pushtetit lokal. Ka me qindra raste të tilla që gjykohen nga një organ tjetër qendror administrativ. Supozojmë që janë shkelur kriteret dhe pushteti lokal e bën kërkesën, a do t'ia japë Komisioni? Jo, e rrëzon kërkesën. Pra e bën rolin më të lartë administrativ në këtë rast. Kurse në të kundërt ju thoni nuk e bën. Si nuk e bën, atëherë ta heqim fare Komisionin Qendror.

Petro Koçi – Më fal, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Nëse do t'i japim këtë mundësi atij që e bën kërkesën, atëherë i bie që të eliminosh fare pushtetin vendor dhe çdo kërkesë të vijë automatikisht në Komisionin Qendror.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të detyrohesh ta shqyrtosh në themel ankimimin, pra është e njëjta gjë. I bie që çdo kërkesë që bëhet pranë organeve të qeverisjes vendore të vijë automatikisht te ne.

Ulsi Manja – Zoti Koçi, te neni 23 flitet për dy nivele ankimi vendimmarrje. Në pikën e parë flitet për ankimin në gjykatë ndaj vendimmarrjes së këshillit bashkiak, që refuzon kërkesën, dhe te pika 2 flitet për një kontestim të vendimmarrjes së Komisionit Qendror. Prandaj mendoj se neni 23 i ka zgjidhur tamam.

Petro Koçi – Po, është në rregull.

Ulsi Manja – Pra, refuzon kërkesën e këshillit bashkiak dhe duhet të shkosh në gjykatë.

Petro Koçi – Zoti Hyseni flet për pikën 1, ku thotë: “Të mos vijë në gjykatë, por të shkojë te Komisioni”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirëpo kjo bën që çdo kërkesë të vijë...

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, kam përshtypjen se kjo na krijon probleme me ligjin “Për pushtetin vendor”.

Alket Hyseni – Jo, sepse buron nga ligji kjo kompetencë.

Ulsi Manja – Kam përshtypjen që po.

Alket Hyseni – Keni krijuar një mani duke i çuar qytetarët në dyert e gjykatave dhe duke ia plasur Gjykatës Administrative çdo gjë që shpikë mendja, prandaj kjo gjykatë sot nuk funksionon nga ngarkesa.

Ne kemi një organ të lartë administrativ si filtër dhe këtu nuk do të ankohet çdokush, por vetëm ai që mendon se i është shkelur e drejta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Organet e pushtetit vendor nuk japin status, por transportojnë kërkesën te Komisioni Qendror, i cili jep status dhe thotë: “Kjo është familje dëshmori”. Çfarë do të kërkojë qytetari nga bashkia e Lushnjës, e cila nuk ia dërgoi dosjen te Komisioni Qendror, do ta çojë në Gjykatë Administrative për këtë gjë?

Ulsi Manja – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozimi i zotit Hyseni për pikën 1 është: “Refuzimi i kërkesës përpara se të ankimohet në gjykatë të ketë edhe një instancë gjykimi, që është Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Koçi, kjo ka lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për t’u shqyrtuar, pra nuk i hyhet thelbit. Ai çon kërkesën në këshillin bashkiak, i cili thotë: “Jo” dhe refuzon...

Petro Koçi – Është e njëjta gjë.

Ulsi Manja – Jo, nuk është e njëjta gjë.

Petro Koçi – Po, sepse është i njëjti komision që do të shqyrtojë çështjen në themel.

Alket Hyseni – Ai e shqyrton pastaj, nëse i plotëson ose jo 100% kriteret, ndërsa anën formale e ka në fillim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Flitet për anën formale, nuk besoj se e komplikon gjënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po duhet ndryshuar

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndryshimi do të reflektohet te neni 23, pika 2.

Hedhim në votim nenin 23 me sugjerimin e bërë për pikën 1 dhe pikën 2 nga kolegu Hyseni dhe zoti Fino. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24 “Nxjerrja e akteve nënligjore”.

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Te ky ligj propozuesi tha se nuk ka faturë financiare, por afati për nxjerrjen e akteve nënligjore të thjeshta të jetë 1 vit, mua nuk më duket e drejtë. Për ligje shumë të rëndësishme, si atyre të reformës në drejtësi, ne kemi lënë një afat nga 3 në 6 muaj, prandaj mendoj që këto akte nënligjore mund të dalin brenda 3 muajve që nga hyrja në fuqi e ligjit.

Ulsi Manja – Sa muaj propozoni?

Vasilika Hysi – 3 muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho – Zonja Hysi, edhe unë parimisht jam dakord që të lihet për 3 muaj, por nuk kanë për t’u bërë, prandaj më mirë ta lëmë për 6 muaj.

Ulsi Manja – Propozuesi e ka 1 vit, ne kemi një propozim të zonjës Hysi për 3 muaj dhe atë të zotit Braho që thotë ta lëmë për 6 muaj, se nuk e bëhen për 3 muaj.

Ta lëmë për 6 muaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 24, për afatin 6 mujor? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25 “Shfuqizime”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26 “Hyrja në fuqi”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për statusin e dëshmorit të atdheut”. Projektligji së bashku me raportin përkatës dhe me sugjerimet e bëra nga Komisioni i Ligjeve t’i përcillet komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare.

Sekretare

Klotilda Bushka (Ferhati)

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Edlira Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafa, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Besmir Beja – këshilltar i ministres së Drejtësisë

Katrin Treska – Drejtoreshë e Përgjithshme Rregulltarore e Çështjeve të Drejtësisë

Eljona Bylykbashi – Përgjegjëse Sektori e Reformave Ligjore dhe Përafrimit të Legjislacionit

Mimoza Sadushi – Kryetare e Dhomës Kombëtare të Noterisë

Fatmir Laçe – Noter

Elona Saliaj – Noter

Vladimir Martini – Noter

Agnes Bernhard – Shefe e misionit EURALIUS

Tedi Dobi – ekspert vendas

Ulsi Manja – Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës, që është shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar”.

Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore e këtij projektligji është kolegja Vasilika Hysi.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Drejtësisë zoti Besmir Beja, këshilltar i ministres së Drejtësisë, zonja Katrin Treska, drejtoreshë e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë dhe zonja Eliona Bylykbashi, përgjegjëse sektori. Nga Dhoma Kombëtare e Noterisë kemi të ftuar zonjën Mimoza Sadushi, kryetare e Dhomës së Noterisë dhe nga Misioni EURALIUS zonja Agnes Bernhard, shefe misioni.

Ky projektligj është shumë i rëndësishëm dhe bën pjesë në paketën e dytë të projektligjeve të reformës në drejtësi. Kemi konsumuar shumë kohë për diskutimin e këtij projektligji dhe janë organizuar disa tryeza konsultimi publik me aktorët e faktorët që punojnë me këtë projektligj. Ka pasur debate dhe kundërshti të forta për nene të caktuara të këtij projektligji, por, gjithsesi, siç e kam theksuar edhe në tryezën e fundit që kemi organizuar me Dhomën Kombëtare të Noterisë, dhomat vendore, me anëtarët e Këshillit Drejtues dhe me Misionin EURALIUS është rënë dakord që në fushën e përgjegjësisë së shtetit bërja e një ligji, “teori për noterinë”, na ofron ligjin, por edhe ne si shtet, me standardet më të mira europiane. Nuk besoj se do të kënaqim të gjitha interesat e noterëve që ka Shqipëria, që janë rreth 470 noterë, por e rëndësishme është që ligji që do të miratohet do t’i rezistojë kohës dhe do të zgjidhë shumë nga problematikat që janë hasur gjatë gjithë këtyre viteve në shërbimin e noterisë.

Përpara se të kalojmë në shqyrtimin nen për nen, dua të falënderoj me radhë të gjithë kolegët e mi deputetë, nismëtarën dhe relatoren Hysi, që janë përfshirë intensivisht në diskutimin e këtij projektligji, të gjithë kolegët që kanë dhënë sugjerime dhe komente për nene të caktuara.

Dua të falënderoj Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe të gjithë ata noterë në Republikën e Shqipërisë, të cilët me qëllimin për bërjen e një ligji të mirë janë përfshirë me sugjerime dhe komente për këtë projektligj. Gjithashtu edhe ekspertët ndërkombëtarë dhe vendas, që kanë punuar

me ligjin, këshilltarët e komisionit, por dhe misionin EURALIUS, zonjën Bernhard. E thënë më shkurt të gjithë grupin e punës që bëri të mundur ardhjen e këtij projektligji, të cilin do ta shqyrtojmë nen për nen në këtë mbledhje të komisionit.

Zonja Hysi, duke qenë se jeni relatore dhe keni punuar shumë me këtë projektligj, do t'ju lutem që gjatë diskutimit nen për nen aty ku janë bërë komente, t'i lexoni propozimet që janë bërë, sepse nuk i kemi të reflektuara në draft. Ne po punojmë me një draft të harmonizuar nga grupi i punës mes Ministrisë së Drejtësisë, misionit EURALIUS dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, por edhe të këshilltarëve të komisioni.

Pa humbur kohë kalojmë te neni 1 “Objekti i ligjit”.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të them dy fjalë lidhur me projektin që keni përpara dhe për procesin.

Falënderoj të gjithë kolegët e nderuar të Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe misionin EURALIUS, por edhe të gjithë dhomat lokale të noterëve, që ishin pjesë e konsultimit publik.

Për transparencë për kolegët dhe për opinionin publik, grupi i punës ka marrë një për një të gjitha propozimet dhe rekomandimet që bëri Dhoma Kombëtare e Noterisë, dhomat vendore të noterëve, por edhe të gjitha materialet që janë sjellë me shkrim në formën e propozimeve ose amendimeve. Në draftin që keni përpara kanë gjetur pasqyrim pjesa më e madhe e sugjerimeve ose e rekomandimeve të kolegëve, por nga ana tjetër nuk janë pasqyruar disa nga propozimet e tyre dhe gjatë diskutimit nen për nen unë do të përpiqem ta theksoj arsyen.

Që në fillim dua të them që mbajtja në konsideratë ose jo e një rekomandimi ose një propozimi të ardhur gjatë konsultimit publik ose të parashtruar me shkrim është bërë duke pasur parasysh edhe standardet e deontologjisë, por edhe modelet e vendeve që ne aspirojmë t'u bashkohemi. Në këtë kuadër besoj se do të ketë edhe një mirëkuptim.

Zoti Kryetar, unë dua që për çështje të teknikës legislative për fjalë dhe redakte të shprehjeve të vogla të mos ndalemi, sepse në variantin përfundimtar besoj se do ta kalojmë nesër.

Fillojmë me nenin 1. Lidhur me “Objektin” unë nuk kam ndonjë koment.

Ulsi Manja – Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Qëllimi i projektligjit”.

Vasilika Hysi – Jam dakord me variantin e riformuluar nga grupi.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

Vasilika Hysi – Te neni 3 kam sugjeruar të shtojmë shkronjën “g”, ku të themi: “Termat: “kandidat për noter”, “noter”, “zëvendësnoter”, nënkuptojnë çdo person që përmbush kriteret e përcaktuara në ligj pavarësisht gjinisë”.

Kemi pasur një diskutim që gjuha e ligjeve është një gjuhë mashkullore, ndërkohë që noterët nuk janë vetëm meshkuj. Ky është një standard që është përfshirë në të gjithë legjislacionet e Bashkimit Europian dhe është direktiva “Për mosdiskriminimin”.

Ulsi Manja – Pra çfarë propozohet?

Vasilika Hysi – Unë shtoj termin “kandidat” që përdoret “kandidat për noter”, “noter”, “zëvendësnoter”, nënkupton çdo person që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj, pavarësisht gjinisë së tij. Ne themi noteri, kandidati, ndërkohë që kemi notere, candidate e të tjera.

Ulsi Manja – Dakord. Nga Ministria e Drejtësisë a ka ndonjë vërejtje?

Specialistët – Jemi dakord.

Ulsi Manja – Nga misioni EURALIUS?

Agnes Bernhard – Jemi dakord.

Ulsi Manja – Fjalën e ka zoti Çuçi

Bledi Çuçi – Kush e përzgjedh zëvendësnoterin, sepse këtu nuk thuhet?

Vasilika Hysi – Zoti Çuçi, faleminderit për pyetjen, ju keni të drejtë. Në projektligj rregullohet pozicioni i zëvendësnoterit. Noterët nuk janë të detyruar të kenë zëvendësnoter, por është e drejta e tyre të kenë një zëvendësnoter, nëse e kërkojnë, prandaj në këtë rast ai aplikon dhe shpreh dëshirën që për shkak të ngarkesës së punës, të vëllimit të transaksioneve e të tjera, kërkon të ketë një zëvendësnoter. Pra figura e zëvendësnoterit është në zgjedhjen e noterit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Më vjen keq, zysha, por unë mendoj se është i papërshtatshëm për një nen ku duhet të shpjegojmë leksikun e fjalës “noter”. Të njëjtin standard duhet të kishim edhe tek avokati, duhet të themi “avokat është ...” pavarësisht gjinisë. Mua më duket totalisht e papërshtatshme, sepse po flasim për titullin “noter” dhe dihet që noteri është një person fizik, i licencuar sipas këtij ligji. Kur të shkojmë te ligji, ne e kemi edhe në Kushtetutë, do të vëmë re se nuk ka diskriminim. Mendoj se nuk është e nevojshme ta themi, sepse kuptohet se kush quhet

noter. Noter është kushto që plotëson kushtet dhe kur të vijmë te kushtet themi: “shtetasi shqiptar...” dhe nuk themi: “mashkulli shqiptar...”.

Ulsi Manja – Nuk e di nëse kolegja Hysi do t’i qëndrojë propozimit apo do ta tërheqë.

Vasilika Hysi - Mua më vjen shumë mirë që po bëhet ky diskutim, por ne te Kodi i Sjelljes së Deputetëve e kemi përfshirë fjalë për fjalë, *mot a mot*, se çfarë do të thotë fjala “deputet”. Pra, për veten tonë ne e kemi bërë, kështu që pse të mos e bëjmë edhe për të tjerët?

Ulsi Manja – Kjo, në fakt, është deklarative dhe nuk besoj se është diskriminim mostheksimi i kësaj gjëje.

Vasilika Hysi – A ka ndonjë gjë të keqe nëse e vendosim?

Ulsi Manja – Nuk ka asgjë të keqe, por kam frikë se do t’u mbesë hatri avokatëve që nuk e bëmë këtë gjë edhe për ta.

Alket Hyseni – Unë jam për ta hequr termin “ministri i Drejtësisë” dhe të quhet “ministri, që mbulon fushën e drejtësisë”, sepse në vite të ndryshme mund të ketë emërtime të ndryshme, mund të quhet për shembull Ministria e Drejtësisë dhe ndonjë gjë tjetër, siç ka treguar eksperiencia. Ne kemi ruajtur edhe një parim të teknikës legislative, ku u jemi shmangur emërtesave strikte. Dakord!

Kështu që këtu mendoj se duhet të bëhet ministri, që mbulon çështjet e drejtësisë ose ministri përgjegjës për Drejtësinë, por jo ministri i Drejtësisë.

Ulsi Manja - Unë nuk besoj se Ministria e Drejtësisë do të ndryshojë në të ardhmen në emërtesë, por, gjithsesi, një koment për këtë duhet dhe ta bëjmë: Ministria përgjegjëse për Drejtësinë ose ta lemë Ministria e Drejtësisë?

Besmir Beja – Historikisht është përdorur emërtimi: “Ministra e Drejtësisë” dhe unë personalisht nuk besoj se do të ketë ndryshime në funksionet ose në emërtimin e Ministrisë së Drejtësisë, por në rast se ju e çmoni të nevojshme, mund ta ndryshojmë. Në praktikën legislative ministritë janë adresuar me fushën që ato mbulojnë, jo me emërtimin që kanë, kështu që edhe mund të ndryshohet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Pra, nëse do të vendosini për ta ndryshuar, mund të jetë ministri që mbulon çështjet e Drejtësisë.

Ulsi Manja – Ne mund të themi ministri përgjegjës për Drejtësinë.

Alket Hyseni – Ose mund të bëjmë një shtesë, ku themi që me ministër të Drejtësisë kuptohet ministri përgjegjës për Drejtësinë.

Ulsi Manja - Jo, do ta lemë vetëm ministri përgjegjës për Drejtësinë.

Atëherë, kush është dakord me nenin 3, me sugjerimin e bërë për germën “c”, ku të specifikohet ministri përgjegjës për Drejtësinë, si dhe me sugjerimin e bërë nga kolegja Hysi, për të shtuar një germë “dh”, që zgjidh çështjet e mosdiskriminimit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4 “Profesioni i noterit”.

Vasilika Hysi – Nuk kam asnjë koment dhe jam dakord me propozimin e grupit.

Ulsi Manja – A janë dakord përfaqësuesit e ministrisë, përfaqësuesit e EURALIUS-it dhe të Dhomës së Noterëve?

Ju i keni të tre mikrofonët të ndezur, ndaj dua një përgjigje konkrete me “po” ose “jo”?
(Diskutime pa mikrofon.)

Dakord!

Atëherë, kush është dakord me nenin 4? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu II “Hyrja në profesion”.

Neni 5 “Kriteret për ushtrimin e profesionit të noterit”.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Këtu kam një sugjerim lidhur me paragrafin e parë, për të bërë të qartë të drejtën për t’u licencuar si noter, jo për licencim, sepse ngatërrohet me ministrin e Drejtësisë.

Së dyti, sugjeroj që në germën “dh” të përdorim fjalët “formim fillestar të detyrueshëm” dhe jo “trajnim fillestar të detyrueshëm” për ta unifikuar me gjithë tekstin.

Kam një shqetësim lidhur me germën “ë”, sepse këtu duhet të shtojmë edhe referencën në germën “e”. Unë kam bërë një riformulim të tillë: “Në përfundim të formimit fillestar, sipas përcaktimit të germës “dh” të këtij neni dhe të trajnimit praktik, sipas përcaktimit të germës “e” të këtij neni, të këtë kaluar me sukses provimin e kualifikimit për noter”. Pra, nuk mund të kalosh provimin për kualifikimin si noter, nëse nuk ke bërë formimin fillestar dhe dy vjet praktikë. Kështu duhet shtuar edhe referenca në germën “e”.

Ulsi Manja – A ka ndonjë koment nga përfaqësuesit e Dhomës së Noterëve?

Mimoza Sadushi - Dakord!

Ulsi Manja – Po, nga Ministria e Drejtësisë?

Besmir Beja – Vetëm për ta qartësuar, unë mendoj se përpara fjalës “formimit”, duhet të shtohet edhe fjalia “programi i formimit fillestar”.

Ulsi Manja - Programi i formimit fillestar unifikon termat, siç e kemi bërë me ligjin ...

Besmir Beja – Me ligjin për Shkollën e Magjistraturës apo me ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ulsi Manja – A mund t’ju jap një sugjerim? Ky është një ligj që ka 145 nene dhe do t’ju lutesha që për çështje të teknikës legjislative, nëse nuk e ndryshojmë thelbin e nenit, të mos e harxhojmë kohën kot. Në të kundërt ky ligj të shkojë për miratim në parlament në muajin shkurt. Parlamenti mbledhet me datën 21 janar në një seancë solemne dhe ky projektligj i bie të dërgohet për t’u miratuar në parlament në pranverë.

Çështjet e teknikës legjislative mund t’i zgjidhë grupi i punës, relatorja, këshilltarët, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuesit e EURALIUS-it dhe të Dhomës së Noterëve. Nëse do të ketë sugjerime të tilla, të cilat e ndryshojnë thelbin e projektligji, patjetër që do t’i nënshtrihen diskutimit.

Kush është dakord me nenin 5, me sugjerimet e bëra, që kanë të bëjnë kryesisht me çështjet e teknikës legjislative? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 6 “Provimi i pranimi në formimin fillestar”.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë sugjeroj që të bëjmë një formulim të paragrafëve dy dhe tre. Nëse do të më lejoni, dua të bëj edhe një ndërhyrje në paragrafin e pestë, që nuk ka të bëjë thjesht me thelbin, por me teknikën legjislative.

Në paragrafin e dytë thuhet: “Në rast se nga analiza konstatohet mundësia e krijimit të të paktën 7 vendeve vakante për pozicionin e zëvendësnoterit në 3 vjetët e ardhshëm, ministri i Drejtësisë, bazuar në propozimin e Dhomës Kombëtare e Noterisë, përcakton me udhëzim numrin e kandidatëve për noterë, që do të pranohen në programin e formimit fillestar.”

Unë mendoj dhe besoj se këtë shqetësim e ka edhe kolegja Bushka. Pra, përcaktimi mund të bëhet me udhëzim të ministrit të Drejtësisë bazuar në propozimin ose pa konsultimin e Dhomës

së Notërëve. Ky është parimi ose standardi që ne kemi përcaktuar në të gjithë ligjin për çdo çështje. Pra, të mos jetë një udhëzim i përbashkët.

Së dyti, lidhur me paragrafin e tretë, kam bërë një riformulim, pasi mendoj se nuk është shumë i qartë, si më poshtë: “Ministria e Drejtësisë shpall në buletin e njoftimeve zyrtare thirrjen për shprehjen e interesit për provimin e pranimit në trajnimin fillestar, e cila përmban afatin brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, që duhet të jetë jo më pak se dy javë nga data e shpalljes, dokumentacioni që duhet bashkëlidhur me të, si dhe adresën postare dhe elektronike të dërgimit të tyre. Thirrja publikohet për të paktën dy javë rresht, nga data e shpalljes së njoftimit, në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë.”. E kam bërë këtë riformulim duke hequr përdorimin disa herë të shprehjes “...duhet të jetë jo më pak se dy javë nga data e shpalljes”, sepse kjo është thënë që duhet të qëndrojë dy javë në faqe.

Së treti, në paragrafin e pestë thuhet: “Qendra e trajnimit administron shprehjet e interesit të të interesuarve për noterë dhe ia përcjell ato Dhomës Kombëtare të Noterisë”, pra jo këshillit, por ato Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Së fundi, në paragrafin e njëmbëdhjetë, këtu do të kërkoja edhe mbështetjen e kolegëve, thuhet: “Kundër vlerësimit të komisionit të kualifikimit mund të bëhet ankim”.

Tani ankimi është administrativ dhe ne kemi një legjislacion të posaçëm për ankimin administrativ, ndaj mendoj se nuk është e nevojshme që të përcaktojmë afate të tjera nga ato që përcakton Kodi i Procedurave Administrative. Pra, meqenëse qendra operon në Tiranë, dihet që kompetente është Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pra, unë mendoj se duhet të bëjmë një riformulim: “Kundër vlerësimit të komisionit të kualifikimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Pra, sipas rregullave të gjykimeve administrative.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ne mund ta lemë edhe “në gjykatën kompetente”. Në Tiranë ne kemi edhe gjykatë të shkallës së parë dhe një gjykatë Apeli, dhe çështja që ngrihet është: ankimi do të shkojë direkt në Gjykatën e Apelit apo do të ndjekë rrugën e ankimimit të rregullt? Nëse do të kalojë direkt, duhet përcaktuar që do të shkojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në të kundërt mund të shkojë, siç e ka pasur legjislacioni i kaluar, direkt në Gjykatën e Apelit.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – A mund të më sqaroni për diçka lidhur me paragrafin e dytë, sepse më duket totalisht i papërshtatshëm dhe nuk e di se cila është situata, që domosdoshmërisht duhet të rregullohet në nen? Rregullime të tilla si: “...të paktën 7 vende vakante për zëvendësnoterin në 3 vjetët e ardhshëm” për mua është te dispozitat kalimtare në kushtet maksimale që duhet të jetë në ligj ose nuk duhet të jetë fare këtu.

Vasilika Hysi – Kjo është e përhershme nuk është për një periudhë kalimtare.

Alket Hyseni – Po, por ti këtu thua: “...në 3 vjetët e ardhshëm”?

Vasilika Hysi – Po, për 3 vjetët që do të vijnë...

Alket Hyseni - Ju nuk e keni shpjeguar mirë, sepse duhet të jetë “për çdo 3 vjet”, pasi për 3 vjetët e ardhshëm kuptohet për 3 vjetët që do të vijnë.

Vasilika Hysi – Po, duhet “për çdo 3 vjet” .

Ulsi Manja – A ka ndonjë koment nga përfaqësuesja e Dhomës së Noterëve lidhur me propozimet e bëra nga relatorja?

Mimoza Sadushi – Dakord!

Ulsi Manja – Nga përfaqësuesi i Ministrisë?

Besmir Beja – Dakord në funksion të heqjes së afatit, pasi edhe ligji për gjykimet administrative parashikon që afat të ndryshëm, që është 45 ditë dhe mund të krijojë mospërputhje ndërmjet dy ligjeve.

Mimoza Sadushi – Në vlerësimin tonë është i rëndësishëm përcaktimi i Gjykatës Administrative.

Ulsi Manja - Përfaqësuesit e misionit EURALIUS.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Në lidhje me afatin 2-javor te paragrafi i tretë, ka një keqkuptim dhe propozojmë që ta lemë ashtu siç është, ndërsa për pjesën tjetër jemi dakord.

Ulsi Manja – Atëherë, e hedhim në votim nenin 6, me saktësimin për pikën 2 që të bëhet “...çdo 3 vjet”, sigurisht me sugjerimet që bëri relatorja. Paragrafi i tretë mbetet kështu siç është dhe paragrafi i 11-të përputhet me afatin që është edhe për gjykimet administrative. Patjetër, sipas sugjerimeve që bëri relatorja për paragrafët 2, 5 dhe 11-të, ndërsa paragrafi i tretë mbetet kështu siç është.

Kush është dakord me nenin 6? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7 “Formimi fillestar”.

Vasilika Hysi – Formimi fillestar është ky që kemi formuluar dhe i vetmi shqetësim ose sugjerim që kam është që të hiqen fjalët “pikët maksimale” dhe të themi: “Aplikantët që marrin të paktën 80% të pikëve në provimin përfundimtar”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – A jeni dakord me sugjerimin e bërë nga relatorja? Dakord!

Hedhim në votim nenin 7. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8 “Kandidatët për noter”.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, dua të them se për këtë nen ka pasur shumë debate, kundërshtime dhe diskutime midis noterëve dhe ka qenë çështja më e nxehtë. Siç ju e dini, deri më sot noterët e kanë trashëguar profesionin te fëmijët e tyre, te familjarët dhe ka pasur një debat lidhur me nenin 8, sepse një pjesë e noterëve kanë kërkuar që të drejtën për të marrë profesionin e nënës, të babait, të vëllait apo të motrës ta gëzojnë kur këta të dalin në pension.

Qëndrimi i EURALIUS-it në këtë pikë ka qenë shumë i fortë dhe ka sjellë në vëmendjen tonë që posti i noterit është një post publik dhe nuk mund të trashëgohet. Trashëgimia e postit të noterit është jo kushtetues dhe bie në kundërti me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Pra, kushdo mund të bëhet noter, në bazë të parimit të meritokracisë dhe të objektivit, që do të thotë se edhe një fëmijë, djalë apo vajzë, i noterëve mund të bëhet noter, por jo detyrimisht ta ketë të trashëguar atë nga nëna apo babai noter. Pra, ky njëri mund të futet në konkurs t’u bërë noter si të gjithë kandidatët e tjerë.

Së dyti, një argument tjetër, të cilin dua ta sjell në vëmendje të kolegëve të komisionit, ka qenë se noter i ka një kompetencë shumë të rëndësishme për të bërë vlerësimin e performancës ose cilësive që do të ketë kandidati për noter ose zëvendësnoter, me qëllim që të shmanget konflikti i interesit dhe mundësia që prindërit noterë të vlerësojnë djalin ose vajzën, kjo gjë nuk është e pranueshme. Për rrjedhojë edhe modelet që janë sjellë, të cilat i keni të shkruara në relacion, e tregojnë një gjë të tillë.

Në këtë kuadër, në nenin 8 nuk janë mbajtur parasysh propozimet e disa prej noterëve dhe ne sugjerojmë që në paragrafin 4 dhe në paragrafin 8, në vend të fjalës “këshilli” të themi: “Puna e kandidatit për noter vlerësohet nga noter i përgjegjës për çdo vit kalendarik. Vlerësimi dorëzohet

pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë”, e njëjta gjë është edhe në paragrafin 8 ku thuhet: “Ministri i Drejtësisë...

Ulsi Manja – Po, në nenin 8, pika 4, kështu thuhet: “Puna e kandidatit për noter vlerësohet nga noter i përgjegjës për çdo vit kalendarik. Dhoma Kombëtare e Noterisë përcakton rregulla më të hollësishme për kriteret, metodologjinë dhe nivelet e vlerësimit të kandidatit për noter. Vlerësimi dorëzohet pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë.”

Vasilika Hysi – Kështu është ekzakt, por ju keni draftin e rregulluar, ndërkohë që ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja - A ka ndonjë sugjerim tjetër? Nuk ka.

Atëherë, kush është dakord me nenin 8?

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Në pikën 2 kam diçka. Unë jam dakord që ne të tërhiqemi nga çështja e trashëgimisë, por këtu dua të di edhe mendimin e përfaqësueses së EURALIUS-it.

Në pikën 2, të nenit 8, në fjalinë e dytë thuhet: “Kandidati për noter nuk mund të jetë bashkëshort ose i afërt deri në shkallë të dytë me noterin pranë të cilit punon”. Unë mendoj se ne po shkojmë përtej asaj që duam të bëjmë. Pra, ne po pamundësojmë këdo nga familjarët e noterëve që kandidon dhe që dëshiron ta bëjë praktikën te bashkëshorti, te prindi, ndërkohë që më parë do të kalojë filtrin e shkollës, në filtrin e komisionit dhe të ministrit. Mua më duket diskriminuese që këta njerëz të mos e bëjnë praktikën tek të afërmit. Me këtë gjë ne po shkojmë përtej asaj që duam të bëjmë, pra po kalojmë nga njëra anë e peshores në anën tjetër, sepse ne dikur ua jepnim me trashëgimi profesionin, dhe këtu jam dakord që mund të ketë diskutime pro edhe kundër. Ne mund ta kishim diskutuar më gjatë, por le të lemë përfaqësuesen e EURALIUS-in të shprehet, sepse e kemi marrë këtu për prift dhe të mos i rruajmë mjekrën.

Pra, që të mos duket sikur po e tejkalojmë këtë gjë, pasi po flasim thjesht për një kandidat që dëshiron të bëjë praktikën tek i afërmi i tij. Unë mendoj se nuk është etike që fëmija yt të shkojë të bëjë praktikën diku tjetër, ndërkohë që t’i mund ta praktikosh shumë më mirë. Dëshira juaj nuk ka të krahasuar me dëshirën e një noterit tjetër për ta formuar siç duhet fëmijën tënd, për ta formuar bashkëshortin apo bashkëshorten, pastaj nëse e fiton të drejtën, kjo është një çështje tjetër, sepse do të konkurrojnë si gjithë të tjerët, si çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe nëse i plotëson kriteret, do ta marrë, por t’i heqim të drejtën e praktikës më duket sikur kemi kaluar në të kundërtën e parimit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zonja Hysi ka një përgjigje, pasi kjo pikë është shumë e diskutuar.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Shqetësimi që ngre zoti Hyseni është diskutuar për më shumë se një javë. Para se të filloja të shprehesh për paragrafët unë vura në dukje që ka qenë një çështje e debatuar fort nga një pjesë e noterëve në seancë dëgjimore, por kandidati për noter është një person, i cili do të vlerësohet nga noteri ku ai do të bëjë praktikën. Ky vlerësim do të ketë kompakt në renditjen dhe në promovimin e mëtejshëm si zëvendësnoter dhe në licencimin e tij si noter. Pyetja shtrohet: a mundet që nëna apo babai të bëjë vlerësimin e fëmijës së tij dhe ta rankojë automatikisht në nivelin më të lartë në krahasim me një kandidat tjetër, që është shumë i mirë, por nuk ka fatin që të ketë nënën apo babanë noter? Kjo është çështja.

Alket Hyseni – Kjo përgjigje është dhënë në parimin e çirakut para njëmijë e ca vjetëve, që kur filluan zejet e para, që një çirak i mirë bëhesh nga ai që ka dëshirë për të bërë më tepër se kushdo, kurse pjesa tjetër më duket se i jemi duke i rënë në qafë atyre që duhen. Vlerësimi është formal dhe ju e dini këtë gjë. Pra, ju dhe përfaqësuesit e EURALIUS-it si do t'i kërkonit llogari noterit në lidhje me vlerësimin? Cili është mekanizmi që do të kontrollojë noterin se si e ka vlerësuar kandidatin? Ju nuk keni asnjë mekanizëm, ndaj mos bëni teori të kota.

Vasilika Hysi – Në pikën 4 thuhet: “Dhoma Kombëtare e Noterisë përcakton rregulla më të hollësishme për kriteret, metodologjinë dhe nivelet e vlerësimit të kandidatit për noter.”

Alket Hyseni – Po kontrollin?

Vasilika Hysi – Prandaj është ministri i Drejtësisë, por megjithatë, meqenëse ju kërkonit një përgjigje nga përfaqësuesja e misionit të EURALIUS-it, mund të na japë një përgjigje.

Ulsi Manja - Unë shikoj se pika 2 dhe pika 4 kanë lidhje me njëra-tjetrën. Ndërkohë, lidhur me shqetësimin që ngre kolegu Hyseni, do të doja të dija një mendim nga përfaqësuesja e misionit të EURALIUS-it për pikën 2 të nenit 8.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Zyra e noterit është një zyrë publike, kështu që palët që i drejtohen kësaj zyre duhet të jenë në gjendje edhe t'i besojnë. Pra, ajo është një zyrë publike, siç e ka prokurori ose gjyqtari. Në qoftë se do të kemi parasysh këto gjëra, atëherë koncepti i trashëgimisë nuk do të ishte në përputhje me konceptin e zyrës publike. Gjithashtu, kjo ka të bëjë me edukimin e noterëve...

Siç e tha edhe relatorja, noterët duhet të garantojnë, të marrin arsimimin dhe informimin më të mirë gjatë kësaj periudhe dyvjeçare. Ashtu siç nuk pranohet për gjyqtarin që të ketë nën mentorin e tij të birin apo të bijën, e njëjta gjë vlen edhe për noterët. Duhet të garantohet që ky është një arsim, edukim mbi baza profesionale.

Alket Hyseni – Ju mendoni se zyra e prokurorit dhe e gjykatës është e barasvlershme me noterin? Po të jetë kjo logjikë, unë tërhiqem, por mendoj se nuk kanë asnjë vend për t’u barazuar, sado që t’i japim funksion publik noterit.

E dyta, a mendoni se do ta vlerësojë konkurrenti noter fëmijën e konkurrentit në mënyrë të drejtë, meqë jemi këtu? I bie që fëmija i noterit apo i afërm i tij do ta bëjë praktikën te konkurrenti, a mendoni se ka aftësinë që ai ta vlerësojë më mirë në mënyrë të pavarur?

Zonja Agnes, jemi në Republikën e Shqipërisë dhe duhet të kemi parasysh se duhet të merrni praktikën historike për bazë. Duhet të merrni përsipër praktikën më të mirë europiane, jo të një shteti europian, sepse ka edhe praktikë komplet të kundërt europiane. Besoj se duhet të gjejmë një të mesme të përpjesshme. Këtë kisha si shqetësim në emër të parimeve të së drejtës, por edhe si një shqetësim të noterëve, të cilët punojnë çdo ditë. Një pjesë e noterëve e kanë mbyllur këtë etapë dhe nuk ndihen.

Ulsi Manja – Këto diskutime i kemi mbyllur, kemi rënë dakord në parim se do të kemi këtë draftligj me misionin EURALIUS.

Po, zoti Doshi.

Tom Doshi- Të gjitha licencat që janë dhënë për noterët janë shitur nga ministrat e Drejtësisë. Mua nuk më duket e drejtë që t’i jepen atë kompetenca ministrit të Drejtësisë për dhënien e licencës.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Doshi!

Ne po e bëjmë këtë ligj të ri edhe për të adresuar këtë shqetësim që ngrini ju, absolutisht, për t’i kufizuar edhe mundësinë e abuzimit me pushtetin për dhënien e licencave, sepse jam i bindur që secili nga deputetët ka një histori për të thënë lidhur me licencimin e noterëve në Shqipëri.

Kalojmë te neni 8. Ka sugjerime të tjera për këtë nen? Nuk ka.

E hedhim në votim me sugjerimin e bërë nga relatorja, zonja Hysi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9 “ Provimi i kualifikimit për noter”

Vasilika Hysi - Unë kam bërë një riformulim për shkak të teknikës legislative në paragrafin e parë duke sugjeruar që referencat të neni 5, do t'i bëjmë të germa konkrete, jo në tërësinë e nenit.

Kam një pyetje për grupin e punës, te paragrafi i tetë, ku thuhet: “Kalimi me sukses i provimit shoqërohet me lëshimin e certifikatës” dhe përmendet shprehja “kalimi me sukses” edhe te paragrafi i katërt. Çfarë do të thotë “kalim me sukses”? Sepse nuk shikoj ndonjë pikëzim që duhet të ketë një kandidat për të thënë se ai është fitues dhe ka kaluar me sukses.

Ulsi Manja - Kush do të përgjigjet?

Po, zonja Treska.

Katrin Treska - Një fakt, ky ka qenë një sugjerim i EURALIUS-it, sepse edhe Ministria e Drejtësisë ishte me mendimin se nuk ka nevojë për lëshimin e certifikatës në këtë fazë, pasi kandidati kalon të gjitha fazat dhe në fund del urdhri i ministrit për dhënien e licencës.

Ulsi Manja – Po, të dëgjojmë edhe opinionin e misionit EURALIUS.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) - Kjo certifikatë vërteton thjesht se personi ka kaluar provimin dhe asgjë më shumë.

Vasilika Hysi - E bëra këtë pyetje se rezulton sikur do të ketë edhe një provim tjetër, përveç provimit që bën pasi ka përfunduar formimin fillestar dhe dy vjet praktikë, ka edhe një provim apo jo?

Me këtë provim ai mund të punojë edhe si zëvendësnoter dhe më pas kur hapet vendi edhe si noter. Këtë e thashë që të mbetet rekord për të mos krijuar idenë që me të drejtë ngriti shqetësimin kolegu Hyseni dhe pyeti se sa provime keni lënë.

Ulsi Manja – Po, zonja Treska.

Katrin Treska – Në paragrafin e dytë në themi: “Provimi i kualifikimit organizohet nga Ministria e Drejtësisë”. Kuptohet, është Komisioni i Kualifikimit që ndjek procedurat sipas neneve vijuese, ndërkohë që te paragrafi i tretë themi: “Kalimi me sukses shoqërohet me lëshimin e certifikatës që nënshkruhet nga kryetari i Dhomës”. Për një provim që kryhet nga Ministria e Drejtësisë, mbarëvajtja bëhet nga Komisioni i Kualifikimit. Në fakt, lëshimi i certifikatës bëhet nga kryetari i Dhomës. Ka nevojë për rishikim.

Ulsi Manja- Ka sugjerim konkret për pikën e tretë? Këtu bëhet fjalë për certifikatën pasi të kalojë provimin për noter. Bëhet fjalë se kush do t'i japë formatin A4. Kornizën, po ia japim ne në komision, formatin kush do ta printojë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë po them

Po, zonja Treska.

Katrin Treska- Kam një sugjerim, pasi po e bisedojmë tani me EURALIUS-in, mund të bëhet që ta japë kryetari i Komisionit të Kualifikimit certifikatën që thjesht vërteton kalimin formal të provimit, sepse licenca do të jepet më vonë.

Ulsi Manja - Dakord.

Neni 9 me sugjerimin e bërë në pikën 3 që kryetari i Komisionit të Kualifikimit të lëshojë certifikatën. Atëherë, kush është dakord me nenin 9 me sugjerimin e bërë për pikën 3? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10.

Vasilika Hysi- Ky nen është shumë i rëndësishëm dhe i diskutuar. Është numri i përgjithshëm i noterëve dhe i zëvendësnoterëve në raport me banorët rezidentë. Ka qenë një çështje e diskutuar. Është sugjeruar të kemi një noter për 15 mijë banorë rezidentë, duke pasur parasysh edhe rregullat e deontologjisë dhe të organizimit të noterisë, por edhe modelet e vendeve të tjera. Çështja, që ka nevojë të rishikohet për ndonjë qartësim është pikërisht numri i zëvendësnoterëve. Këtu thuhet: “Numri i zëvendësnoterëve duhet të jetë sa një e katërta e numrit të përgjithshëm të noterëve”. E kam pasur shqetësim zoti kryetar, gjatë diskutimit në grup, edhe sot nëse ne aktualisht e kemi studimin, i cili nuk do të na vërë në vështirësi për të plotësuar vakancat që mund të lindin në bashki të caktuara.

Është bërë një ndryshim që çdo 5 vjet ministri i Drejtësisë duhet të marrë mendimin e Dhomës për të përcaktuar me urdhër numrin e noterëve. Shprehja “të paktën çdo 5 vjet” për mua nuk ka kuptim. Të themi “çdo 5 vjet”. Fjala “të paktën” do të thotë që mund të bëhet edhe më parë se 5 vjet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është kjo që thotë zonja Bushka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është pyetja që unë e kam për propozuesit. Ky është një propozim që ka ardhur nga misioni EURALIUS, pas diskutimeve dhe debateve. Ne jemi tre juristë dhe po e diskutojmë në mënyra të ndryshme. Kjo duhet të bëhet e qartë: detyrimi i ministrit të Drejtësisë.

Është shumë i rëndësishëm kriteri i përcaktimit të raportit për çdo bashki, ku në pikën 2, germa ”ç” thuhet: “Mbahen parasysh veçoritë e territorit dhe mjetet e komunikimit”. Sugjeroj që fjala duhet të jetë për mundësitë e transportit rrugor, sepse mjete komunikimi janë edhe *e-mail*-i, telefoni e të tjerë, edhe këtë duhet ta saktësojmë.

Te paragrafi i katër thuhet: “Vendimi në lidhje me numrin e përgjithshëm të pozicionit nuk sjell pasoja për licencat që janë dhënë më parë për noterë dhe zëvendësnoterë. Sot nuk di të kemi licenca për zëvendësnoterë dhe mendoj se është gabim dhe duhet të hiqet.

E fundit, në pikën 7 kemi një koment unë dhe zonja Bushka. Zonja Bushka do ta paraqesë vetë.

Këtu thuhet: “Në rast se ka një vakancë një noter mund të urdhërohet të kryejë jo më shumë se 4 ditë shërbimi në muaj në një zyrë të një bashkie tjetër”. Pyetja që shtroj: ky noter do të shkojë me shpenzimet e tij?

Çfarë ndodh nëse noteri nuk pranon të shkojë? Në pikën 7 ku thoni: “Noteri mund të ankimojë urdhrin për pamundësi në Gjykatën Administrative. Ky urdhër do të pezullohet derisa të përfundojë gjykimi dhe të kemi një vendim të formës së prerë? Çfarë do të ndodhë sikur të gjithë noterët nuk do të pranojnë të shkojnë për të punuar 4 ditë në muaj shërbim jashtë njësisë? Këto janë çështje që mund të duken shumë të bukura në këtë projekt, por në praktikë duhet t’u japim zgjidhje, duhet të kemi mekanizma zhblllokimi për të gjitha rastet e mundshme. Mund të ndodhen në një situatë, që nuk do të pranojë asnjë noter të bëjë një ankim. Ju e dini se sa shkojnë ankimet administrative në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ulsi Manja - Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka - Në vijim të asaj që paraqiti relatorja, shqetësimi im lidhet me pikat 6 dhe 7 të nenit. Këtu duhet të bëhet e qartë, sepse kemi thënë që është një funksion i deleguar dhe sigurisht duke qenë një funksion i deleguar publik duhet që ne të plotësojmë vakancat. Pra, jam dakord me 4 ditë në muaj si detyrim që u vëmë noterëve duke u nisur edhe nga riorganizimi i numrit në bazë të popullsisë. Problem është çështja e shpenzimeve të noterit. Duhet të trajtohet në ligj, duhet të thuhet me shpenzimet e tij ose jo. Nëse nuk janë shpenzimet e tij, që nuk ma merr mendja që dikush, mund të jetë ministria do t’u rimbursojë shpenzimet, pra nuk do të jetë

ky rasti, por duhet të thuhet këtu, që nesër të mos ngrihet si problem nga noterët dhe të thonë: “Nuk na dalin të ardhurat për të paguar shpenzimet për 4 ditë”. Ky është sugjerimi im i parë.

Për pikën 7 unë mendoj se duhet të hiqet. Meqenëse kemi vendosur që noteri do të shkojë 4 ditë në një qytet tjetër është detyrim. Nuk ka mundësi noteri të bëjë ankim, sepse nëse noteri do të bëjë ankim i bie që derisa gjykata të nxjerrë vendimin, ai vend për 4 ditë do të mbetet pa shërbim noterial. Këtu qëllimi kryesor duhet të jetë që qytetarët të marrin shërbim noterie. Derisa të mbarojë ai gjykim, ai noter nuk do të shkojë atje. Do të fillojë procedura për emërimin e një noteri. Edhe ky i fundit mund të bëjë një ankim në gjykatë. E mendoni se sa bllokim do të ketë?! Të presim sa të mbarojnë gjykimet? Jo, nëse kemi rënë dakord në parim që noteri e ka për detyrim të shkojë, ai do të shkojë dhe nuk ka të drejtë ankimi në gjykatë.

Nuk ka nevojë ta zgjasim këtë çështje, por nëse do të jetë me shpenzimet e tij, shkruajeni në ligj, sepse është vërtet funksion publik i deleguar. Nga ana tjetër është edhe funksion, është edhe shërbim i profesionit të lirë që sjell të ardhura. Ky do të reflektohet te aktiviteti tregtar i noterit. Pra, kjo gjë të bëhet e qartë që nesër të mos bllokohemi. Keni parasysh edhe faktin se kemi thënë minimalisht një noter për bashki. Mendoni sikur të ikë edhe ai, pastaj kush e merr koston? Qytetarët, që do të detyrohen të shkojnë në një bashki tjetër të bëjnë shërbime noteriale deri sa të zëvendësohet ai.

Unë sugjeroj që ta heqim pikën 7 dhe te neni 6 të shtojmë: “ Me shpenzimet e noterit”.

Ulsi Manja - Unë jam dakord me këtë logjikë, për ta hequr pikën 7, por problemi është se “ me shpenzimet e tij” e komplikon gjënë, se noteri mund të shkojë 4 ditë në një rreth, për shembull nga Tirana në Gramsh, ose nga Dhoma më e afërt e noterisë. Problemi është se do të qëndrojë 4 ditë atje, mund të mos bëjë asnjë veprim juridik, asnjë akt noterial.

Besmir Beja - Parimisht kjo do të zgjidhet me një rregullore të brendshme nga ana e Dhomës Kombëtare, por noteri i njësisë më të afërt i takon radha për të shkuar. Është një vendim i papezullueshëm nga gjykata, në kuptimin që ai do të shkojë...

Ulsi Manja- Kush e thotë këtë?

Besmir Beja - Ta shkruajmë: “ Me shpenzimet e noterit”, sepse noteri është subjekt privat, mbledh të ardhura dhe raporton shpenzimet shtesë që ka kryer për shkak të zhvendosjes nga Lezha në Laç, apo nga Lezha në Mirditë, po flas për veten time, shpenzimet shtesë reflektohen në bilancin e aktivitetit.

Ulsi Manja - Atëherë t'i njihen si shpenzime të zbritshme kundrejt detyrimeve që ka ndaj Dhomës.

Të heqim ankimin, pikën 7 dhe këto shpenzime t'i llogariten si shpenzime të zbritshme në detyrimet që ka ndaj Dhomës. Vetëm kështu mund të gjendet një zgjidhje.

Besmir Beja - Ose ndaj biznesit të tij.

Ulsi Manja - Ndaj biznesit të tij, do ta fusim në organin tatimor e të tjerë, komplikohet gjëja. Këtu bëhet fjalë për situata jo normale. Nuk besoj se do të jetë procedurë normale, bëhet fjalë për raste të jashtëzakonshme, kur një rreth gjyqësor mund të mbetet pa shërbim noterie.

Tedi Dobi - Këtë e zgjidhim vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Treska.

Katrin Treska - Jam dakord me heqjen e pikës 7. Ai është akt administrativ që mund të ankimohet në gjykatë dhe parimi i përgjithshëm është se ankimimi nuk e pezullon zbatimin derisa të vendoset një masë sigurie. Ndërkohë, do të sugjeroni që në pikën 6 të shtohet edhe një fjali: "Infrastruktura për ushtrimin e veprimtarisë sipas kësaj pike dhe mënyra e përballimi të shpenzimeve, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Drejtësisë, për të adresuar në çdo eventualitet të mundshëm gjetjen e një ambienti.

Ulsi Manja - Zonja Treska, ne duam ta zgjidhim këtë situatë, sepse edhe fryma e këtij neni dhe e ligjit në përgjithësi është zgjidhja e situatave që qytetarët të mos mbesin pa shërbimin noterial.

Ju mund ta zgjidhni me urdhër, udhëzim të ministrit apo me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të Dhomës, por si do të veprohet me noterin që do të shkojë 4 ditë shërbim jashtë zyrës së tij të noterisë? Ne duam të zgjidhet: e para të ofrohet shërbimi.

E dyta, këtij noteri, që do të shkojë atje, duhet t'i krijohen mundësitë. Dakord që do të shkojë me shpenzimet e tij, por mundet që atje ku shkon, të mos realizojë asnjë lloj aktiviteti noterial. Çfarë do të bëjë ai? Do të shkojë të qëndrojë me shpenzimet e tij, të flejë në hotel? Të paguajë zyrën? Ku do ta ketë atje zyrën? Ku do t'i ofrojë shërbimet noterale me laptop në rrugë?

Besmir Beja - Ky është një debat pak më i gjatë sa e themi ne, po të hyjmë ne teknikalitete se si do të funksionojë. Këto zgjidhen rast pas rasti dhe nuk mund të parashikoni në ligj sesi...

Ulsi Manja - Na thoni një propozim konkret.

Besmir Beja - Zgjidhen me një udhëzim të përbashkët ndërmjet ministrisë dhe Dhomës Kombëtare, sepse në fund të fundit, vakanca krijohet nga licenca që i është hequr dikujt. Është një zyrë ekzistuese, e cila përkohësisht deri sa të zgjidhet ajo do të shfrytëzohet. Ka modalitete që..

Ulsi Manja - Kemi një formulim përfundimtar nga ana e ministrisë?

Katrin Treska- Infrastruktura për ushtrimin e veprimtarisë sipas kësaj pike dhe mënyra e përballimit të shpenzimeve përcaktohen me udhëzim të ministrit të Drejtësisë.

Ulsi Manja- Dakord. Po, EURALIUS-i është dakord?

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) - Biem dakord me paragrafin e fundit. Për periudhën 5-vjeçare, propozoj që fjalët “të paktën” të mbeten, sepse mund të ketë situata të jashtëzakonshme dhe ministrit do t’i duhet të ndërhyjë për të rregulluar numrin e përgjithshëm të noterëve.

Në lidhje me mjetet e komunikimit, kjo është e dyfishtë, është transporti rrugor dhe komunikimi elektronik, që mund të jetë në të ardhmen më intensiv.

Në lidhje me paragrafin 4 propozojmë të mos hiqet zëvendësnoteri. Për momentin nuk është e zbatueshme, por në të ardhmen do të ketë situata kur ky paragraf do t’u referohet edhe zëvendësnoterëve.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Po, zonja Treska.

Katrin Treska – Ministria e Drejtësisë ka edhe një shqetësim për paragrafin e parë të nenit 10. Në vlerësimin tonë duhet të shihet me kujdes ngurtësimin në ligj i raportit të noterëve për numër banorësh, sepse vlerësojmë se është i mjaftueshëm përcaktimi i kritereve të qarta që ndihmojnë në përcaktimin e këtij numri, pa dhënë raportin specifik në projektligj, sepse situata mund të ndryshojë me kalimin e viteve dhe do të kushtëzonte edhe ndryshimin e ligjit.

Ulsi Manja – Pra, ju jeni dakord siç është formuluar këtu?

Katrin Treska – Jo, nuk jemi dakord me përcaktimin e raportit 1 për 15 mijë në ligj.

Ulsi Manja – Ku e doni ju këtë? Pse po e bëjmë ligjin “Për noterinë”? Atëherë nuk e bëjmë fare.

Besmir Beja - Nëse mund të shtojmë diçka tjetër, duhet të kemi në konsideratë që numri aktual i noterëve është shumë herë më i lartë sesa raporti i parashikuar në ligj, që do të thotë se në vitet e ardhshme, minimalisht në 10-15 vjetët e ardhshëm të jemi në pamundësi absolute

për të hapur vende të reja noterësh. Studentët e ardhshëm të Drejtësisë, juristëve të ardhshëm do t'u pengohet e drejta për të ushtruar këtë lloj profesioni në 10-15 vjetët e ardhshëm. Për ne është e rëndësishme që ju të keni në konsideratë këtë lloj të dhëne, përpara se të merret vendimi për numrin e noterëve. Numri kaq i lartë i noterëve është një problem që duhet të zgjidhet, por duhet të adresohet në mënyrën e duhur kjo zgjidhje, që njëkohësisht të garantojë një numër të përshtatshëm të noterëve për numrin e popullsisë, por nga ana tjetër të mos parandalojë edhe të drejtën e studentëve të ardhshëm të Drejtësisë për të ushtruar këtë lloj profesioni.

Ulsi Manja - Ky ligj synon të presë një nyje gordiane me sëpatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi të dëgjoni?

Unë mendova se e keni mbyllur këtë diskutim, ju diskutoni ende? Çështja e pikësimit të numrit noter për banorë përpos kritereve shtesë është ezauruar. Synimi i ligjit është që të zbresë numrin e noterëve nga 470 (është bërë si një tip kooperative bujqësore shërbimi i noterisë në Shqipëri, e tipit të lartë), të shkojë drejt një standardi dhe ky numër të vijë duke rënë.

Çështjen e pamundësisë së futjes së të rinjve në sistem më duket se e ka ezauruar ky ligj.

Në vitin 2014 ministri që ishte ka dhënë 58 licenca, erdhi në vitin 2015 tjetri dhe dha 38. Ku shkojnë këta? Pse vend punësimi është shërbimi i noterisë? Jo, është politikë fiksimit i një numri sipas parimit një noter për kaq banorë.

Kurrsesi qëllimi aktual i Ministrisë së Drejtësisë nuk është të shtojmë në mënyrë absurde numrin e noterëve.

Ulsi Manja – Ministria ka qasje realiste. Ka 1 vit që Ministria e Drejtësisë është shumë e përgjegjshme në këtë drejtim, as nuk ka organizuar provim, as nuk është marrë fare me noterinë, sepse sa vinin ministrat e Drejtësisë, ditën e tretë mendonin se kur të bëjmë provimin e noterëve.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë kam konsideruar se është ezauruar debati i fiksimit në ligj një noter për 15 mijë banorë.

Adnor Shameti – Nuk është shqetësim fiksimit i opsionit në ligj. Ajo çka ishte e nevojshme të ishte në vëmendjen tuaj dhe të të gjithë anëtarëve të këtij komisioni, ishin pasojat që sjell në këtë fazë ky lloj fiksimit në ligj i numrit të noterëve.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Ky debat është bërë për gati 1 vit e gjysmë. Te dispozitat kalimtare, që do t'i kalojmë nesër, ne mund të rregullojmë mirë periudhën transitore, që të mos mbyllim derën e studentëve të rinj me kulturë, me informacion më të përditësuar.

Nga ana tjetër varet shumë nga puna që do të bëjë inspektimi dhe vetë Ministria e Drejtësisë për të spastruar nga sistemi ata noterë që sot kanë abuzuar dhe janë aq shumë ata që kanë abuzuar me pronat, se mjafton të ndjekësh proceset dhe denoncimet në prokurori për t'i hequr gati gjysmën e noterëve që janë në detyrë.

Unë mendoj se ky problem do të zgjidhet.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Pra, që të jemi të qartë, këto fenomene që unë sapo citova nuk i përkasin periudhës pas vitit 2017, por periudhës 2013-2017, që të jemi të qartë, sepse i kam shifrat në tavolinë dhe ato janë publike.

Çfarë ka ndodhur në vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 janë me shifra publike, janë provime të organizuara dhe licenca të dhëna. Nga viti 2012 kur numri ishte 280, ka shkuar në 470.

Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma, por edhe ne, që nëpërmjet këtij ligji të përcaktojmë rregulla të qarta loje për të shmangur abuzivizmin e madh, që është bërë ndër vite me këtë shërbim.

E hedhim në votim nenin 10, me sugjerimet që bëri relatorja, por edhe me sugjerimet që bëri misioni EURALIUS dhe Ministria e Drejtësisë.

Neni 10 ka disa rregullime. Për pikën 7, që është më e diskutueshmja, pati një propozim që të mos jetë kjo pikë.

Jeni dakord?

Ministria e Drejtësisë? Dakord.

Dhoma? Dakord.

Misioni EURALIUS? Dakord.

Edhe pika 6 me shtesën që u propozua, si dhe me propozimin që bëri Ministria e Drejtësisë (çështja e noterëve që do të shërbejnë jashtë zyrës së vet 4 ditë në muaj, të përcaktohet nëpërmjet një udhëzimi që do të nxjerrë ministri i Drejtësisë në bashkëpunim me Dhomën për t'u njohur si shpenzime të zbritshme).

Kush është dakord me nenin 10?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 11, “Vendet vakante për noter dhe radha e plotësimit të tyre”.

Vasilika Hysi – Ka vetëm rregullime të vogla të teknikës legjislative.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 11?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 12.

Vasilika Hysi – Te neni 12, paragrafi 3, hiqet fjala “e këshillit” dhe thuhet “me mendimin e arsyetuar të Dhomës”.

Kam një pyetje. Me kushtin që keni venë për t’u transferuar, në paragrafin e parë thuhet që transferimi i noterit mund të bëhet kur ai ka, të paktën, jo më pak se 5 vjet në juridiksionin ekzistues. Pse e kufizoni me 5 vjet?

Po në rast se ka nevojë një bashki dhe nuk keni kandidatë dhe nuk keni noterë që të kenë, të paktën, 5 vjet, çfarë do të bëhet? Mos mendoni vetëm për tani, sepse ligji është afatgjatë.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Logjika është për të mos krijuar shumë destabilitet. Numri i viteve është politik, por qëllimi dhe arsyetimi pas kësaj është për të mos pasur rrëmujë dhe për të ruajtur stabilitetin.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 12?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 13.

Vasilika Hysi – Në këtë nen unë kam një çështje të teknikës legjislative dhe zonja Bushka ka edhe një sugjerim.

Shoh se ka njëfarë pingpongu në referimet, neni 11 referon te 13, neni 13 referon te neni 11 dhe nga pikëpamja e gjuhës së teknikës legjislative nuk është i qartë paragrafi i dytë, si dhe te paragrafi i tretë mendoj se duhet bërë një saktësim i referencës të pikës 1/dh dhe 2 të këtij neni, sepse ka një kakofoni.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – E drejta për profesion është një e drejtë që hyn tek të drejtat për punë, hyn tek të drejtat kushtetuese. Një zëvendësnoteri, i cili pranon të shprehë interesin, i japim automatikisht 3 vjet vjetërsi të njohur, ndërsa kur ai nuk e pranon, ia heqim të drejtën të kandidojë për një periudhë dyvjeçare.

Kam merakun që kjo bie në kundërshtim me Kushtetutën. A është ky kufizim i së drejtës për punë të ligjshme në proporcion? Ose do të ulim pak periudhën dyvjeçare, të paktë ta bëjmë një vit, që të jetë në proporcion, se çdo e drejtë e njeriut ka edhe limitet e veta, nuk është e pakufizuar. Duhet të jetë në kuadër të interesit publik, duhet të jetë e parashikuar në ligj, por duhet të jetë në proporcion.

A është analizuar ky proporcioni dyvjeçar? I japim 3 vjet kur i shërben atdheut, ndërkohë ia heqim dy vjet të drejtën, kur nuk pranon (ndërkohë që mund të mos ketë pranuar se është në Tiranë me fëmijë të vogël dhe po e çojmë në Tropojë).

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Kjo ka qenë një çështje e vështirë. Janë dy interesa që duhen parë.

E para, i gjithë vendi duhet të marrë shërbimet e noterisë.

Nga ana tjetër kemi noterët, të cilët kanë zyrën në një vend të caktuar dhe nuk dëshirojnë të transferohen për një kohë të caktuar në një vend të largët..

Një nga kompromise që u gjet ishte që t'u kërkohej noterëve, të cilët ishin afër dhe të ishim më të rinj për t'u transferuar përkohësisht.

Masa më e fortë që mund të merret është detyrimi i noterit, nga ana e legjislativit, për të shkuar, por kjo do të konsiderohej si shkelje e së drejtës së aksesit.

Ky është shkaku që në ligj nuk parashikohet transferimi i detyruar dhe ai ka të drejtën e kundërshtimit, por ky afati dyvjeçar është një balancim duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm, që ai të shkojë dhe të shërbejë atje.

Klotilda Bushka - Faleminderit! Jam shumë dakord me logjikën tuaj. Kam një sugjerim. Në kuadër të proporcionalitetit, a mund ta ulin afatin dyvjeçar në një, sepse gjithë qëllimi është që ne të incentivojmë, që ata të shkojnë. Pra, u kemi dhënë 3 vjet vjetërsi, por ndërkohë, afati dyvjeçar mua nuk më duket në proporcion me kufizimin, sepse edhe një vit t'ia refuzosh tjetrit të drejtën për të aplikuar, nuk janë pak. Vetëm këtu është puna, te çështja e proporcionit. A biem dakord që dyvjeçarin ta bëjmë njëvjeçar?

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Kam frikë se nuk është shtysë e mjaftueshme, por është vendim politik. Në një vit nuk do të arrihej qëllimi, por, siç thashë, është vendim politik.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Për pikën 4 të nenit 13 kam bërë një riformulim të teknikës legislative. Fjalja fillon “Zëvendësnoteri që pranon të shprehë interesin...” Teksti është njëlloj. Kam një pyetje,

zoti kryetar. Në ligjin e noterisë, që është në fuqi, është shprehur qartë se ku fillon punë një noter, pasi ministri i Drejtësisë ka urdhëruar transferimin e tij. Në këtë nen nuk ka asnjë paragraf ku të thuhet se ku fillon punë zëvendësnoteri, e para, dhe çfarë do të ndodhë nëse zëvendësnoterit i del urdhri nga ministri i Drejtësisë dhe nuk shkon.

Gjithashtu, kam një shqetësim dhe një sugjerim për pikën 7, lidhur me ankimimin administrativ. Sugjeroj, sikurse kam bërë edhe në dispozitën e mëparshme, që ndaj vendimit të ministrit të Drejtësisë, zëvendësnoteri të ketë të drejtë të bëjë ankim sipas legjislacionit në fuqi për gjykimet administrative, pa përcaktuar afatin, sepse dihet që është afat 45- ditor dhe jo 30-ditor, siç e kemi parashikuar. Patjetër që ankimi do të bëhet në gjykatën administrative të rrethit gjyqësor Tiranë, sepse këtu është Ministria e Drejtësisë.

Pra, të jemi më të qartë.

Pra, pse nuk është rregulluar momenti se kur do ta fillojë punën, brenda sa ditësh? Çfarë do të ndodhë nëse ai nuk shkon?

Ulsi Manja – A keni ndonjë përgjigje për pyetjen e zonjës Hysi?

Atëherë neni 13 ngelet i hapur...

(Diskutime pa mikrofon)

Katrin Treska – Është i detyruar noteri që brenda 60 ditëve, nga dalja e urdhrit të ministrit, të fillojë veprimtarinë. Në të kundërt merren masa sipas ligjit, siç është te ligji aktual.

Ulsi Manja – Dakord. Siç është te ligji aktual do të funksionojë edhe për noterin, edhe për zëvendësnoterin.

Kush është dakord me nenin 13, me sugjerimet e bëra?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 14.

Relatorja është dakord.

Ministria e Drejtësisë? Dakord.

Dhoma? Dakord.

Misioni EURALIUS? Dakord.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet neni 14.

Neni 15.

Vasilika Hysi – Te neni 15 kam vetëm një çështje që do të doja të diskutoja edhe me EURALIUS-in, edhe me kolegët, edhe me ministrinë.

Një noter bën kërkesë se ka nevojë për një zëvendësnoter, por në asnjë pjesë të tekstit nuk gjej pëlqimin e noterit.

Pra, noteri është i detyruar të pranojë cilindo zëvendësnoter që rankohet.

Cili është modeli që është përzgjedhur këtu?

Çfarë do të ndodhë nëse asnjë noter nuk pranon një zëvendësnoter, ose numri i kërkesave do të jetë i pakët?

Çfarë do të bëhet me zëvendësnoterët që janë në proces?

Pra, kam nevojë të di se si mund të zgjidhim çdo problem të mundshëm në një situatë hipotetike që mund të ndodhë.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Posti i zëvendësnoterit është i parashikuar në Gjermani, Austri, Holandë, Kosovë dhe stili, pozicioni apo kompetenca e këtij posti janë të njëjta.

Vasilika Hysi – Më falni, unë bëra një pyetje se çfarë do të ndodhë nëse asnjë noter nuk pranon një zëvendësnoter. Çfarë do të bëhet me zëvendësnoterët që janë në proces? Pra, ata kanë kaluar konkursin, është bërë përzgjedhja dhe nuk i merr asnjë noter.

Katrin Treska – Që kur fillon e konkurren për zëvendësnoter, ai ka kërkesën e noterit. Pra, duhet të ketë kërkesa të noterëve, të jetë dhënë pëlqimi i noterëve që duan një zëvendësnoter. Më pas hapet konkursi për zëvendësnoter.

Vasilika Hysi – Si çështje të dytë shtrova problemin që unë si notere kam bërë kërkesë se kam nevojë për një zëvendësnoter dhe kur shoh listën se kush ka fituar, nuk marr asnjë. Pra, kemi një kontradiktë midis kërkesës dhe pëlqimit. Ai do të marrë të parin që listë, të dytin apo të tretin? Jemi 3 noterë që kemi kërkuar një zëvendësnoter. Secili do të marrë një, por cilin?

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ne mund ta lëmë nenin 15 të hapur dhe vazhdojmë me nene të tjera.

Kalojmë te neni 16, “Betimi i noterit”.

Relatorja është dakord.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet neni 16.

Neni 17.

Vasilika Hysi – Te neni 17 kam një pyetje për titullin. Ne themi “Regjistri i Noterisë”, ndërkohë që noteria ka shumë regjistra, se edhe vetë noterët kanë regjistra. Në qoftë se ne këto do t’i quajmë regjistri që mban ministri dhe dhomat kombëtare për noterët, zëvendësnoterët, po regjistrat që mban noteri si do të quhen?

Pra, keni përdorur të njëjtën terminologji.

Katrin Treska – Sepse ato janë në regjistrin e përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale. Kanë emërtime specifike.

Vasilika Hysi – Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Më fal! Këtu flitet për titullin për regjistrin e noterëve, ndërsa në pikën 4 thuhet se çfarë bën nju shtetas që ka marrë licencën për të ushtruar profesionin. Pra, rregullat e si përzgjidhet, si kalon afati e të tjera. Më duket e pika 4 nuk e ka vendin te regjistri i noterëve, por duhet të vendoset aty ku flitet për emërimin dhe përzgjedhjen e noterit e të zëvendësnoterit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Pra, lidhur me nenin 17, ta hedhim në votim, zonja Hysi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Te neni 17, pika 1: “Ministria e Drejtësisë dhe dhoma e noterëve mbajnë veç e veç regjistra”.

Tani, nëse ka mospërputhje midis dy regjistrave, cili do të prevalojë? Duhet një parashikim këtu.

Katrin Treska – Edhe sot, Ministria e Drejtësisë dhe dhoma mbajnë veç e veç regjistra, dhe i njëjti set dokumentacioni që depozitohet në ministri, depozitohet edhe në dhomë. Është thjesht një garanci më shumë. nëse në një moment të caktuar, dhomës apo ministrisë i mungon një e dhënë, e ka institucioni tjetër.

Ulsi Manja – Pra, janë komplementare me njëra - tjetrën. Plotësojnë njëra -tjetrën.

Katrin Treska – Po. ndërkohë, në lidhje me nenin 17, pika 4 që u përmend i bie të transferohet te neni 13.

Ulsi Manja – Atëherë, në lidhje me nenin 17 ka një propozim. Pika 4 të transferohet te neni 13. Ndërkohë ka një pyetje nga zonja Bushka, që kur ka mospërputhje midis dy regjistrave. Dakord, në rastin kur kanë humbur dokumentet te njëri dhe i ka tjetri, se kjo është situatë e

zgjidhur, por a mund të ndodhë të ketë mospërputhje në përmbajtjen e dokumenteve që ka njëri institucion, me tjetrin? I referohem përmbajtjes së dokumentit, jo dokumentit si dokument fizik, jo inventarit.

Katrin Treska – Deri tani nuk kemi pasur mospërputhje. Pra, kush ka qenë i regjistruar në Ministrinë e Drejtësisë, ka qenë i regjistruar edhe në dhomë. Megjithatë, në raste specifike edhe mund ta vëmë, se mund të ndodhë ndonjë rast. Për të ardhmen mund të vendosim se cili do të jetë regjistri që do të prevalojë karshi tjetrit.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ta hedhim në votim?

A ka EURALIUS mendim në lidhje me nenin 17, pika 1?

Dakord!

Kush është dakord me nenin 17, duke u hequr pika 4, për të kaluar te neni 13? Kush është pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet!

Neni 18: “Pezullim i përkohshëm i licencës së noterit, me kërkesën e tij”.

Vasilika Hysi – Ky është një nen shumë i rëndësishëm. Unë kam tri çështje. Noteri ka të drejtë të pezullojë licencën, por jo më pak se gjashtë muaj deri në tre vjet, për shkak se mund të zgjidhet apo të marrë një funksion publik. Si rregull, funksionet publike janë katër ose pesë.

Pyetja e parë: pse ka këtë diferencim dhe a mund të riparohet? Në lidhje me pikën 5 të këtij neni, unë kam një shqetësim tjetër. Çfarë ndodh nëse nuk ka asnjë vend vakant të shpallur. Pra, pasi përfundon afati i pezullimit, ne themi se noteri kthehet në vendin e punës. nëse nuk ka asnjë vend vakanti të shpallur, çfarë do të bëhet me noterin? Ligji nuk e zgjidh.

Gjithashtu, kam edhe një riformulim të pikës 7, që është nga pikëpamja e teknikës legislative. Aty thuhet se noteri nuk mund të bëjë kërkesë tjetër për pezullim të përkohshëm të licencës, jo më parë se katër vjet nga data e rikthimit në detyrë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni ose kur pezullimi kërkohet për një pikë tjetër, sipas parashikimeve të shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni.

Pra, është e njëjta përmbajtje, por vetëm e kam rregulluar, se nuk tingëllonte shqip.

Çështja tjetër është pika 7. Në pikën 7 thuhet se gjatë periudhës së pezullimit të licencës, noteri nuk mund të kryejë punë tjetër me pagesë, për më shumë se dhjetë orë në javë. Pra, për çfarë lloj pune bëhet fjalë? Në qoftë se do ta lejojmë të punojë dhjetë orë në javë, atëherë s’ka pse ta

pezullojë licencën, dhe punon si noter për dhjetë orë, me përjashtim të rasteve kur ka papajtueshmëri, siç mund të jetë një funksion publik që e ndalon. Nuk arrij ta kuptoj këtë “dhjetë orë në javë”, llojin e punës dhe se cili është qëllimi. Ai e pezullon licencën që të mbajë fëmijë apo se është i sëmurë, ndërsa nga ana tjetër themi se mund të punojë dhjetë orë në javë.

Këto janë tri çështje, për të cilat unë sugjeroj se do të ishte e nevojshme të sqaroheshin, sepse mund të ketë debate në lidhje me zbatimin e ligjit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Le t’i marrim me radhë gjërat.

Në lidhje me pikin 1: pse thuhet nga gjashtë muaj dhe jo më shumë se tre vjet? Pra, nuk ka përputhshmëri me mandatin e një të zgjedhuri. Pse e ke keni lënë tre vjet? Kjo është logjika. Unë po marr rastin e një deputeti që vjen në parlament, dhe ka qenë noter, kur dihet e kohëzgjatja e mandatit është katër vjet. Po marr vetëm rastin: pse është lënë tre vjet? Cila ka qenë logjika?

Po, zonja Bernhard!

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Arsyetimi është për të mos qenë shumë larg profesionit për një periudhë shumë të gjatë, në mënyrë që të mos largohet nga fusha e vet. katër vjet mund të jetë e pranueshme.

Ulsi Manja – Dakord!

Po, ministria?

Besmir Beja – Mund të bëhet një shtesë, sepse komenti i relatores është i drejtë. Në rastet e pezullimit për shkak të zgjedhjes ose emërimit në një funksion publik, pezullimi zgjat për aq sa zgjat funksioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Aq sa zgjat mandati, shkon shumë gjatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm një mandat. Përndryshe profesioni e humbet kuptimin. Ti mund të shkosh deri në 14 vjet në një funksion me mandat, dhe pas 14 vjetësh, sipas këtij përcaktimi ke të drejtë të pezullosh licencën me kërkesën tënde. Nuk shkon kjo. Se këtu flitet për pezullimin e licencës me kërkesën e vetë subjektit. Nuk mund të thuhet për mandate pambarimisht. Ti mund të marrësh tre mandate në parlament dhe të kesh të drejtë ta pezullosh licencën 14 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po rri pra aty ku je, se përparimi i sigurisë juridike nuk nënkupton pafundësisht mbajtjen e vendit bosh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Unë jam fare kundër këtij neni. Pse duhet t’i vëmë këto artificet në ligj? Ti thua: po e pezulloj unë profesionin tim për katër apo pesë vjet, sepse emërohem në një funksion publik, e pastaj do të kthehem prapë atje. Çfarë do të thotë kjo, se s’e kuptoj? Po për profesionet e tjera, a garantohet një gjë e tillë? Në qoftë se nuk garantohet edhe në profesionet e tjera një gjë e tillë, pse duhet ta garantojmë për noterin? Në qoftë se ai do të ikë, le ta lërë licencën dhe të vijë një tjetër. Pse duhet t’ia lëmë që të rrijë jo tre vjet, jo katër vjet, e pastaj të kthehet prapë.

Ulsi Manja – Po nuk është vetëm rasti i zgjedhjes. Janë edhe dy lloj rastesh, që nuk kanë lidhje me zgjedhjen. Janë edhe rastet e përkujdesjes ndaj fëmijës së mitur, dhe ato për shkaqe shëndetësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Jo, jo! Ti e di se me ligj i takon së ëmës apo të atit, që të kujdesen për fëmijën. Kjo i takon me ligj. Nuk ka lidhje me këtë. Me sa kuptoj unë, këtu bëhet fjalë për pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit. Bëhet fjalë vetëm për ato raste kur ai do të marrë një detyrë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pse duhet ta lëmë ne këtë?

Vasilika Hysi – Më fal! Diskutimin që po bëni ju, zoti Fino, ia vlen ta elaborojmë pak më tej. Ne i japim të drejtë një personi, i cili do të ushtrojë një funksion publik, dhe nuk i japim të drejtë një noteri, qoftë burrë apo grua, që mund të jetë edhe kryefamiljar, për t’u kujdesur për fëmijën e tij deri në moshën trevjeçare, që është e drejtë në Kodin e Punës. E dyta, për shkaqe shëndetësore, ai mund të mos jetë në gjendje; ka bërë një operacion të vështirë, ka nevojë për rikuperim, mund të ketë trajtime mjekësore, që nuk ka dalë në kemp, por ka nevojë për përkujdesje. Unë mendoj se “b”-ja dhe “c”-ja janë shumë të rëndësishme, ndaj mund të lihet afati trevjeçar.

Lidhur me zgjedhjen apo emërimin në një funksion publik, lënia e afatit trevjeçar është nul, sepse, të paktën për momentin, nuk më vijnë ndërmend funksione publike, të cilat të janë tre vjet, përveç të qenit ambasador, më duket.

Megjithatë, zonja Bernhard e tha se mund ta lëmë katër vjet, ose riformulimi që ofroi Ministria e Drejtësisë, por jam dakord që distanca duhet të jetë shumë e madhe, sepse humbet zanati.

Bashkim Fino – Unë thashë tjetër gjë, ti po thua tjetër gjë.

Vasilika Hysi – Jo, jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Pra, jemi dakord me nenin 18, që pikën 1 ta bëjmë jo më pak se gjashtë muaj dhe jo më shumë se katër vjet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si ishte propozimi i Ministrisë së Drejtësisë?

Katrin Treska – Mund të ketë edhe funksione publike që kanë mandat pesëvjeçar, kështu që më mirë do të ishte: për aq kohë sa zgjat funksioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Propozimi im është: për këto rastet e përgjithshme të rrijë kështu siç është, ndërsa për funksionet publike le të ketë një pikë më vete, ku të saktësohen funksionet publike deri sa të biem dakord, pesë vjet maksimumi, por jo më shumë, sepse nga shkëputja për një kohë të gjatë humbet edhe sensi.

Ulsi Manja – Unë mendoj të mos e diskutojmë rastin e deputetit...

Alket Hyseni – Jo të deputetit, të funksionit publik.

Ulsi Manja – Dakord! Po tani, çfarë presupozon? Të gjitha organet kushtetuese apo të krijuara me ligj, dhe ky ka qenë edhe debati që ka bërë herë pas here zoti Fino në komision, kur u mbaron mandati, bëhet rikthimi në pozicionin që kishte ose në një pozicion të barazvlefshëm me të. Pra, merr kuptim e logjikë, duke përjashtuar funksionin e deputetit. Për pjesën tjetër, duhet t'u garantojmë pjesën e rikthimit në detyrat prej nga vijnë. Sepse këtë e kemi bërë me të gjitha ligjet e tjera.

Alket Hyseni – E kemi edhe për detyrë publike, në fakt.

Ulsi Manja – Kështu që, unë dua një mendim për pikën 1 të nenit 18, nga komisioni EURALIUS, lidhur me propozimin që bën Ministria e Drejtësisë, që ta barazojmë me kohëzgjatjen e ushtrimit të funksionit publik. Flitet gjithmonë për mandat kushtetues ose për mandat që ia jep ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Problemi është se, po ta shohësh pikën 1 në raport me pikën 5, pika 1 është kot. Pse? Sepse në pikën 1, ke thënë: “Nëse i është zënë vendi, ky do të konkurrojë për një vend tjetër vakant”. Çfarë i ke garantuar ti me pikën 1? Asnjë gjë. Nuk i ke garantuar asnjë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka licencë, por nëse ka vend, mirë. Nëse s’ka vend, rri pa punë. Kjo është e gjitha. Mua më duket e pika 1 me pikën 5 janë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Bernhard.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Në qoftë se i kthehem paragrafit 3, aty është zgjidhja për këto çështje. Deri në një vit, kjo nuk ka ndonjë lloj ndjesie vakante. Ose mund të gjendet ndryshe.

Ulsi Manja – Deri në një vit, thotë Agnesi, e ruan. Mbi një vit vendi do të plotësohet në përputhje me ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai vetëm mban kartonin në shtëpi. Kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket, Agnesi thotë se nuk ka kuptim të mbahet vendi vakant mbi një vit, sepse mbi një vit do të ofrojë shërbimin. Ai që do të marrë vendin e noterit, për ta zëvendësuar atë, patjetër që duhet të marrë licencë edhe ai. Kësisoj, kjo më duket pikë shumë e ngatërruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E lëmë të hapur nenin 18, por pothuajse e shoh pa zgjidhje këtë.

Vasilika Hysi – E lëmë të hapur këtë pikë.

Ulsi Manja – Pra, neni 18 lihet i hapur, për t’i diskutuar edhe një herë këto shqetësime. Kalojmë te neni 19.

Vasilika Hysi – Te neni 19 thuhet se noteri nuk ushtron asnjë veprimtari tjetër publike dhe private, që ushtrohet kundrejt pagesës. Po pa pagesë, mund të kryejë, përveç mësimdhënies?

E thamë këtë për ta sqaruar, sepse këtu thuhet “vetëm me pagesë”, po pa pagesë a mund të kryhet?

Ulsi Manja – A mund ta bëjë noteri punën e përkthyesit?

Katrin Treska – Noteri mund ta bëjë vetë përkthimin nëse është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.

Ulsi Manja – Nëse do të jetë i licencuar si përkthyes zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, atëherë mund ta bëjë edhe funksionin e përkthyesit.

Alket Hyseni – Këtu kemi dy terma: “veprimtari tjetër publike” dhe “kundrejt pagesës”. Kjo duhet saktësuar pak, sepse po folëm për veprimtari publike, atëherë duhet t’i ndalohej çdo lloj veprimtarie tjetër.

Ulsi Manja- Është veprimtari publike dhe private.

Alket Hyseni – Për mua i rëndësishëm është termi “publik”. Detyrë publike tjetër me pagesë ose pa pagesë mund të bëjë. Cila është një detyrë tjetër publike që mund të mbajë noteri pa pagesë?! Asnjë. Nuk ka detyrë publike pa pagesë, prandaj duhet të saktësojmë disa gjëra.

Për sa i takon termit “privat”, kuptohet që mund të jetë një shoqatë, fondacion apo diçka tjerë, por jo veprimtari publike. Për mendimin tim, duhet të ndalohej çdo detyrë tjetër publike kundrejt pagesës, përveç mësimdhënies dhe veprimtarisë shkencore.

Vasilika Hysi – Edhe unë këtë shqetësim kam dhe duhet qartësuar, por ka raste që ne noterët i kemi angazhuar në reformën në drejtësi, e cila është veprimtari publike, e ka bërë...

Alket Hyseni – Është shkencore.

Vasilika Hysi – Jo, nuk është shkencore. Një pjesë e tyre kanë qenë pa pagesë dhe kanë kontribuar në përmirësimin e reformës në drejtësi. Grupi i punës që punoi më shumë se një vit për këtë ligj dhe nuk ka marrë ndonjë pagesë, e ka bërë si punë punë ekstra, sepse ka dashur të kontribuojnë dhe unë dua t’i falënderoj të gjithë. A lejohet ky angazhim?

Alket Hyseni – Më fal që ju ndërpreva, por janë koncepte të ndryshme. Ne po flasim për veprimtari publike kundrejt pagesës, që u ndalohej, përveç mësimdhënies dhe veprimtarisë shkencore. Prandaj, po e thirrë si ekspert, është veprimtari shkencore, është ekspertizë, është shkencë. Domethënë, Kuvendi mund ta marrë si ekspert në fushën e tij, por jo në veprimtari tjetër publike.

Ulsi Manja – Mua më duket se neni është i riformuluar shumë saktë.

Alket Hyseni – A mund ta ndalojmë noterin në këshillin mbikëqyrës të një fondacioni? Unë them të heqim emërtimin kategorik “kundrejt pagesës” dhe e lëmë siç është, sepse nënkuptohet që pa pagesë mund të bëjë çudira, por bie ndesh me funksionet.

Ulsi Manja –Këtë kuptim ka neni 19, që ushtrohet kundrejt pagesës, sepse për pjesën tjetër nuk i merr leje njeriu noteri. Pra, aty ku nuk merr lekë noteri mund të bëjë çfarë të dojë.

Alket Hyseni – Jo, i ndalohet nga funksioni, nuk ka lidhje me pagesën, por me faktin a mund të ushtrojë një funksion tjetër.

Ulsi Manja – A do të marrë lekë kur përkthen?! Patjetër që po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 19, me sugjerimin e bërë nga kolegu Fino?

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Është shumë i gjerë si term, sepse, në qoftë se thua “aktivitet privat”, është diçka shumë e gjerë që e bën privatisht. Për mua nuk ka kuptim. Aktivitet privat mund të jetë edhe luajtja me fëmijët e tu.

Alket Hyseni – Nuk pajtohet me asnjë veprimtari profesionale publike dhe private.

Ulsi Manja – Mua më duket se sugjerimi i kolegut Fino shkon edhe në raport me ligjin për konfliktin e interesit, sepse këtë formulim kemi edhe te ligji i konfliktit të interesit. Ushtrimi i funksionit të noterit nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër publike dhe private, me përjashtim të mësimdhënies dhe veprimtarisë shkencore sipas legjislacionit në fuqi. Pastaj kemi ligjin për konfliktin e interesit në fuqi, ku edhe noteri i nënshtrohet atij ligji.

Kush është pro nenit 19, me sugjerimin e kolegut Fino? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 20, “Zyra e noterit”.

Vasilika Hysi – Nuk kam asgjë për të shtuar për përmbajtjen, por të vetmen gjë që kam është që fjalia e dytë, “noteri mund të kryejë shërbime”, të dalë në paragraf më vete, sepse nuk ka lidhje me paragrafin e parë.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 20, me sugjerim të karakterit të teknikës legislative? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Zoti Fino, lidhur me shqetësimin tuaj, unë kam qenë në Komision të Venecies ato ditë që janë diskutuar këto nene, e kam marrë draftin dhe kam bërë komente. Unë jam dakord të diskutojmë për ligjin edhe pasdite, natën ose kur të doni ju, por ligji duhet të kalojë, sepse ju ishit në mbledhje grupi.

Ulsi Manja- Çështja nuk është për të kaluar ligjin, por zoti Fino ka një shqetësim. Në qoftë se relatorja me grupin e punës nuk kanë rakorduar për të mbyllur një draft integral, atëherë, meqenëse ligji ka 145 nene, unë them që do ta ndërpresim mbledhjen këtu dhe të rakordohen nenet në vazhdim me grupin e punës dhe nesër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Votojmë nenin 21, të mbarojmë me kreun II dhe te kreu III do ta ndërpresim shqyrtimin dhe miratimin nen për nen, ndërkohë, do të dakordësohemi.

Kolegia Bushka ka një sugjerim për nenin 21.

Klotilda Bushka – Te germa “d” e nenit 21, kur flitet për heqjen e licencës, e cila bëhet me urdhër të ministrit, një nga shkaqet për heqjen e saj është kur vërtetohet se ka marrë licencën në kundërshtim me kushtet ligjore të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Unë mendoj se kjo është shumë e gjerë dhe cenon sigurinë juridike, por mund të jem dakord që të fokusohet te fakti nëse e ka marrë mbi bazë të të dhënave false dhe të vërtetuara me një vendim penal të formës së prerë që e vërteton këtë, por jo kështu, sepse, në qoftë se ai është emëruar dhe komisioni e ka çuar në detyrë, atëherë, ai e ka fituar këtë të drejtë dhe nuk mund t’i hiqet. Licenca mund t’i hiqet vetëm në rastet kur ka bërë shkelje, kur të dhënat e sjella kanë rezultuar false dhe kur ka një dokument të pasaktë për vjetërsinë dhe për shkollën, por, nëse është marrë sepse e ka pasur mbiemrin e babait me A apo me E dhe nuk vërtetohet që është i njëjti person, ky formulim i germës “d” e sjellë këtë amulli. Kështu që unë dua që ta saktësojmë këtë.

Ulsi Manja – Edhe unë dua të shtoj diçka te neni 21, ku thuhet: “Heqja e licencës kur mbush moshën 70 vjeç”. Prapë e keni lënë 70 vjeç?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sipas legjislacionit në fuqi për pensionin, është e qartë, si drita e diellit, që noter 70 vjeç nuk ka.

Mimoza Sadushi– Mbush moshën për pension.

Ulsi Manja – Po, zonja Bernhard.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Unë mendoj se ju në Shqipëri keni mosha të ndryshme për gjyqtarët kushtetues dhe të Gjykatës së Lartë, kur ndërkohë ligji parashikon se mosha është 70 vjeç. Edhe në disa vende europiane mosha e daljes në pension është 70 vjeç, por tendenca është për të rritur moshën e pensionit.

Lidhur me germën “d”, duhet parë legjislacioni në fuqi në momentin e marrjes së licencës, në mënyrë që të evitohet efekti prapaveprues.

Ulsi Manja – Lidhur me çështjen e moshës 70 vjeç, me këtë parashikim nuk gjen zgjidhje shqetësimi që kishte Ministria e Drejtësisë, për mënyrën sesi do të futen në sistem elementet e rinj, sepse kjo e blndon. Nëse do ta lëmë sipas ligjit për sigurimet shoqërore...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk themi kur mbush moshën 70 vjeç, por kur mbush moshën e pensionit.

Mimoza Sadushi – Së pari, jemi i vetmi vend që moshën e pensionit e kemi 65 vjeç, pasi edhe vendet e tjera si: Kosova, Maqedonia dhe Serbia e kanë moshën 70 vjeç. Prandaj mendojmë që të ketë një moshë fikse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por ka një problem, pasi pas disa vjetësh mosha e pensionit do të shkojë 70 vjeç, atëherë, çfarë do të bëjmë me ligjin e noterisë? Megjithatë, ne kemi pasur një moshë 65 vjeç kur të gjithë dilnin në pension 60 vjeç. Nuk ka kuptim që të mbajmë një moshë 67 vjeç apo 68 vjeç.

Ulsi Manja – Fjalën e ka kërkuar zoti Fino.

Bashkim Fino – Lidhur me atë që tha zonja Bernhard, që edhe kolegët tanë në vendet e tjera e kanë, duhet të kemi se sa është mosha mesatare, pasi në Shqipëri mosha mesatare dikur ka qenë shumë e ulët, ndërsa sot ka fituar terren, është rritur dhe, për shkak të kushteve të mira, mund të rritet edhe më shumë dhe t'i afrohem Europës. Sa më shumë të rritet mosha mesatare, aq më shumë do të kemi mundësi që njerëzit të dalin më vonë në pension. Ne sot kemi një ligj të sigurimeve shoqërore, ku themi që njerëzit dalin në pension në këtë datë, qoftë për gra, qoftë për burra. Ai ligj është fleksibël, i cili ndryshon sipas kushteve dhe moshës mesatare të jetesës, që do të thotë që, nëse ne e vendosim në ligj “Mbush moshën e pensionit sipas legjislacionit në fuqi, do të thotë që pas një viti ose dy vjetësh mosha mesatare mund të rritet dhe mosha mesatare mund të shkojë edhe 72 vjeç, kjo sepse është në funksion të ligjit të sigurimeve shoqërore. Prandaj është mirë që ne ta lëmë kështu, që është në funksion të ligjit që del në pension sesa një moshë të caktuar 70 vjeç, sepse pas 15, 20 apo 30 vjetësh mosha mesatare mund të jetë edhe 80 vjeç, që do të thotë se këtu mosha mesatare për një noter që të lërë detyrën e tij duhet të jetë 75 vjeç. Prandaj unë them ta lëmë siç e ka legjislacioni në fuqi, që është e lidhur edhe me moshën mesatare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar një dispozitë të nenit të statusit, ku i referohej moshës së pensionit të parashikuar në ligj, sepse kjo përcakton mosha të ndryshme të daljes në pension për burrat dhe për gratë, që sipas Gjykatës Kushtetuese sjell pasiguri.

Ulsi Manja – Dua të bëj një pyetje. Kur del në pension një gjyqtar i një juridiksioni të zakonshëm, jo i Gjykatës Kushtetuese?

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesi) – Kjo është një çështje e hapur.

Ulsi Manja – Zonja Bernhard, një gjyqtar apo prokuror në Shqipëri del në pension ditën kur mbush moshën për pension sipas legjislacionit në fuqi.

Vasilika Hysi – Unë kam Kushtetutën para, ku në nenin 127 thuhet: “Mbush moshën 70 vjeç”, për Gjykatën Kushtetuese; për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë thuhet: “Mbush moshën e pensionit” dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm thuhet: “Mbush moshën e pensionit”.

Ulsi Manja – Sepse vetë ligjvënësi në Kushtetutë për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese dhe për anëtarin e Gjykatës së Lartë ka përcaktuar moshën 70 vjeç, ndërsa për të gjithë kategorinë tjetër të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë i referohet legjislacionit të sigurimeve shoqërore, “Mbush moshën e pensionit”. Pse duhet të barazohet noteri me anëtarin e Gjykatës së Lartë dhe anëtarin e Gjykatës Kushtetuese?

Vasilika Hysi – Gratë sot dalin në pension në moshën 60-61 vjeç, që do të thotë se një notere mund të dalë shumë shpejt në pension, kur ajo ka ende mundësi të japë dhe kjo është një çështje e vullnetit politik nëse do ta lëmë 70 vjeçe apo kështu, por nuk duhet të harrojmë që gratë sot dalin në pension në moshën 60 vjeç.

Bashkim Fino – Edhe unë ndoshta kam dëshirë të dal 60-61 vjeç në pension, por a e dini pse është bërë ligji i sigurimeve i tillë?! Sepse burrat kanë mundësi të paguajnë më shumë kontribute dhe nuk është barazuar mosha e pensionit burrë-grua. Ju i kërkon drejtat tuaja, por nuk keni thënë ndonjëherë që ta rrisim moshën e pensionit sa të burrave. Unë jam dakord që të barazohet mosha e daljes në pension dhe jemi në rregull. Ndërsa, në rastin konkret, meqenëse del më shpejt gruaja në pension, ti thua gjynah që doli kaq shpejt noteri. Po pse s’na e qan hallin dhe ne të tjerëve, noterëve burra?!

Unë jam dakord për zbatimin e moshës së pensionit sipas legjislacionit në fuqi.

Ulsi Manja- Zoti Fino, shumë faleminderit!

Nuk e di pse duhet të bëjmë debat për këtë pikë?!

Mimoza Sadushi- Më fal, por do të ketë një diskriminim për të gjitha noteret femra, të cilat po dalin herët në pension, kur deri sot e kanë pasur të barabartë me burrat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, të barabartë me burrat kanë qenë, 65 vjeç. T'i nxjerrësh para moshës së daljes në pension mua nuk më duket normale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimoza Sadushi- Jo, 65 ka qenë edhe për burrat dhe për gratë. Edhe gratë, pavarësisht se dilnin 55 vjeçe në pension dhe burrat 60, moshën e daljes në pension e kishin 65, ndërsa tani notere shumë të mira dalin në pension 60 vjeçe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Zonja Sadushi, si e ka ligji i vjetër?

Mimoza Sadushi Ligji i vjetër e ka 65.

Ulsi Manja- Pra, është unike, 65 vjeç.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Zoti Fino, kjo është e bukura, që s'ka një arsyetim bindës pse ndryshon nga 65-70 vjeç, por është thjesht një rritje mekanike për të mbajtur në sistem një *status quo*, siç e ke. Këtu ka dy diskutime, ose do të ngelet 65 vjeç, ose shkon sipas ligjit për pensionet, ndërsa për moshën 70 vjeç nuk bëhet fjalë.

Zonja Bernhard, meqenëse po shikonit legjislacionin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, keni diçka për të shtuar?

(Ndërhyrje në anglisht)

Ulsi Manja – Neni 21 mbetet i hapur, sepse do të shohim një vendim të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë rast, por gjithsesi mosha 70 vjeç është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ligji nuk bëhet për individë të caktuar, sepse ligji për një sekondë të djegë dhe për një sekondë të jep benefite.

Zonja Bushka, në tryezën e fundit të diskutimeve u ngrit shqetësimi që ka noterë që e kanë mbushur moshën 65 vjeç dhe vazhdojnë të ushtrojnë profesionin dhe ju e keni pranuar në tryezë me mua, që është e vërtetë se ka noterë që e kanë mbushur moshën dhe kanë vite që

ushtrojnë profesionin e noterit dhe nuk e dorëzojnë vulën. Kështu që kjo gjendje duhet të marrë fund.

Unë mendoj ta mbyllim shqyrtimin nen për nen të projektligjit dhe i lutem të gjithë grupit të punës së ligjit për noterinë, zonjës Sadushi, zonjës Treska dhe zonjës Bernhard, duke përfshirë edhe këshilltarët e komisionit, që sot të mbyllin draftin me relatoren, sepse relatorja kujtohet edhe pas mesnate të bëjë komente për ato që miratuam dhe unë nuk dua të hap më debate, sepse po t'u kthehem neneve nga 1 tek 21, Vasilika po i pa gjërat më syrin që nuk i pëlqejnë, ka përsëri gjëra të tjera që nuk do t' i pëlqejnë.

Uluni sot dhe përfundoj komentet që kishe për nene të caktuara. Edhe ministria të shikojë mos ka ndonjë koment. Pastaj, nëse ka mospërputhje, kemi votën këtu dhe e mbyllim gjënë.

Kështu që shumë faleminderit për sot! Nesër do të kemi vazhdimin e shqyrtimit nen për nen të ligjit për noterinë. Mundet që nesër ta bëjmë pasdite mbledhjen, sepse këto dy-tri ditë janë shumë të ngjeshura për komisionin.

E mbyllim mbledhjen për pikën e tretë të rendit të ditës.

Sekretare

Klotilda Bushka (Ferhati)

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit

Edlira Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2018, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kandidaturat për Komisioner të Avokatit të Popullit për vendet vakante në tri seksionet e këtij institucioni. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafa, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

Të ftuar:

1. Aljona Mansaku - kandidate për pozicionin Komisioner për Seksionin e Përgjithshëm
2. Andi Nano - kandidat për dy pozicione: Komisioner për Seksionin e Përgjithshëm dhe Komisioner në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre
3. Arjan Hoxha - kandidat për pozicionin Komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor

4. Artan Ballabani- kandidat për pozicionin Komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor
5. Edlira Cimbi - kandidate për pozicionin Komisioner në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre
6. Erjona Canaj - kandidate për pozicionin Komisioner në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre
7. Ermonela Ruspi - kandidate për dy pozicione: Komisioner për Seksionin e Përgjithshëm dhe Komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor
8. Ilir Kadiu - kandidat për pozicionin Komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor
9. Vilma Shurdha - kandidate për dy pozicione: Seksioni i Përgjithshëm dhe Komisioner në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre

Ulsi Manja – Vazhdojmë me pikën e katërt dhe të fundit që kemi në rendin e ditës: seancë dëgjimore me kandidaturat për komisioner të Avokatit të Popullit për vendet vakante në tri seksionet e këtij institucioni. Konkretisht, për komisioner në seksionin e përgjithshëm, komisioner në seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor dhe komisioner në seksionet e organet e administratës qendrore të pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore do të jetë kolegja Bushka.

Dua të sjell në vëmendje të kolegëve se sot do të kemi vetëm seancë dëgjimore. Vlerësimi i përmbushjes së kushteve ligjore dhe i meritës do të bëhen në një mbledhje tjetër të Komisionit për Çështjet Ligjore. Kështu që propozoj, me mirëkuptimin tuaj, mendoj që kandidatëve, të cilët kanë ardhur në këtë seancë dëgjimore, t'u vëmë në dispozicion 3 minuta. Nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura na është vendosur në dispozicion i gjithë dokumentacioni. Besoj se tre minuta kohë është e mjaftueshme. Sipas ligjit janë katër kandidatë për secilin nga pozicionet. Në zbatim të nenit 33/1, pika 4 e ligjit 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar”, Avokati i Popullit e ka zhvilluar procedurën paraprake të përzgjedhjes. Bazuar në kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 33 dhe nenin 33/1 të ligjit 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar” ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve dhe të platformës, si dhe një intervistë të strukturuar me gojë. Kjo procedurë është kryer nga institucioni i Avokatit të Popullit. Në zbatim të nenit 33/1, pika 6 e ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar”, Avokati i Popullit ka depozituar në Kuvend listën e kandidatëve për komisionerë për të tria seksionet vakante si më poshtë vijon.

Për pozicionin komisioner në seksionin e përgjithshëm është zonja Vilma Shurdha, e cila kandidon për dy seksione, zoti Andi Nano, që kandidon në dy seksione, zonja Ermonela Ruspi që kandidon për dy seksione dhe zonja Aljona Mansaku vetëm për pozicionin komisioner në seksionin e përgjithshëm.

Për pozicionin komisioner në seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor kanë ardhur kandidaturat e zotit Arjan Hoxha, zonjës Ermonela Ruspi, zotit Ilir Kadiu dhe zotit Artan Ballabani.

Për pozicionin komisioner në seksionin për organet e administratës qendrore të pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, kanë ardhur zonja Edlira Cimbi, zoti Andi Nano, zonja Vilma Shurdha dhe zonja Erjona Canaj.

Cila është procedura që ndiqet nga Komisioni i Ligjeve i Kuvendit?! Në zbatim të nenit 33/1, pikat 7, 8, 9 të ligjit 8454, 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, procedura që ndiqet në rastin konkret nga Kuvendi për përzgjedhjen e komisionerëve të Avokatit të Popullit është si më poshtë: komisioni i Kuvendit që mbulon çështjet ligjore, pra komisioni ynë, organizon seancën dëgjimore publike me katër kandidatët e përzgjedhur për secilin vend dhe, pas marrjes në shqyrtim të katër kandidaturave për çdo vend vakant, përzgjedh vetëm dy kandidatë për t’ia paraqitur për votim seancës plenare. Në rast barazie të votave, pra në rast se do të kemi më shumë se dy kandidatë, do të zgjidhen ata kandidatë që do të marrin mbështetjen më të madhe në komision. Dy kandidatët për secilin pozicion, që ne do të përzgjedhim, do të kalojnë për votim në seancë. Unë e theksova në fillim të fjalës sime që sot do të bëjmë vetëm seancën dëgjimore. Vlerësimin e përmbushjes së kushteve e të kriterëve ligjore dhe të performancës do t’i bëjmë në një mbledhje tjetër. Do të vazhdojmë sipas renditjes që kanë bërë këshilltarët e komisionit të bazë të dokumentacionit, kështu që fillojmë pa humbur kohë me kandidaten e parë, zonja Aljona Mansaku, e cila nuk është paraqitur. Ajo e ka konfirmuar pjesëmarrjen, por deri tani nuk ka ardhur.

Kalojmë te kandidati i dytë, zoti Andi Nano, i cili kandidon për dy pozicione, për komisioner për seksionin e përgjithshëm dhe për komisioner në seksionin për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

Zoti Nano, mire se erdhët në komision! Ju e ndoqët fjalën time dhe koha e përcaktuar për secilin kandidat është 3 minuta, sepse i gjithë dokumentacioni që ju keni paraqitur, sipas ligjit, është në tryezën e kolegëve të mi me të gjitha dokumentet që kërkon ligji.

Shkurtimisht, na thoni motivet që ju shtynë të bëheni pjesë e garës për të shkuar komisioner tek Avokati i Popullit.

Fjala është për ju.

Andi Nano – Faleminderit për mundësinë që më krijuat!

E dyta, jam i gëzuar që jam këtu sot, sepse shumicën e anëtarëve të komisionit kam pasur mundësi t’i njoh për shkak të eksperiencës sime të gjatë në administratën shtetërore. Gjithashtu, gjatë 10 vjetve të fundit kam pasur një eksperiencë të gjatë në shoqërinë civile, ku kam punuar me shumë projekte të shoqërisë civile. Nuk dua të zgjatëm shumë te pjesa teknike e CV-së sime, pasi

mendoj se e keni parë. Duke qenë se koha në dispozicion është shumë e shkurtër, dua të them se kam motivimin dhe dëshirën për të qenë komisioner, sepse mendoj se mund të jap kontributin tim tek Avokati i popullit për disa çështje, të cilat nuk janë të trajtuara ende deri më sot. E para, mendoj se shumë çështje që zgjidhen nga Avokati i Popullit sot nuk ndiqen në vijueshmëri. Domethënë, zgjidhet një çështje thelbësore nga ai, por mbaron aty. Ndërkohë që duhet të ketë një sensibilitet me të madh në lidhje me çështje që janë të ndjeshme, të cilat duhet të ndiqen edhe pas një viti, pra sesi ka shkuar ajo çështje.

E dyta, Avokati i Popullit ka një platformë online ku individët mund të shprehin shqetësimet e tyre. Unë do të doja që këtë platformë ta promovoja më shumë pranë shoqërisë civile, sepse shoqëria civile është më pranë njerëzve dhe mund ta promovojë atë.

Mendoj se Avokati i Popullit mund të bëjë edhe më shumë për meritokracinë brenda administratës publike. Personave që kanë qenë pjesë e administratës publike dhe për një arsye apo për një tjetër janë larguar prej saj duhet t'u lindë e drejta të kandidojnë, edhe pse e kanë humbur statusin e nëpunësit civil. Mendoj se këto janë tri gjërat që kisha.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Nano!

A kanë pyetje kolegët? Kam unë vetëm një pyetje të shkurtër. Një nga kushtet për t'u zgjedhur komisioner, bazuar në nenin 33, është të mos kenë qenë anëtar i partive politike, deputet, ministër apo zëvendësministër...

Andi Nano – Nuk kam qenë.

Ulsi Manja – Përderisa jeni kualifikuar nga Avokati i Popullit, presupozohet se është verifikuar kjo gjë.

Andi Nano – Jo, nuk kam qenë.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit për prezencën sot në komision! Ditë të mbarë!

Andi Nano – Faleminderit!

Ulsi Manja – Vazhdojmë me zotin Arjan Hoxha.

Zoti Arjan Hoxha kandidon për pozicionin e komisionerit në seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor.

Zoti Hoxha, mirë se keni ardhur në komision!

Në dispozicionin tuaj, si të gjithë kandidatët, komisioni ka vendosur si kohë në dispozicion tre minuta për të na folur rreth bekgraundit, formimit tuaj apo përmbushjes së kushteve e kriterëve ligjore, sepse dosja juaj është mbi tryezën e kolegëve të mi deputetë. Cila janë motivet

që ju bënë pjesë e garës për t'u zgjedhur komisioner në seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor?

Fjala është për ju.

Arjan Hoxha – Faleminderit për pyetjen tuaj!

Motivi kryesor që më ka shtyrë të jem një ndër kandidatët për t'u përzgjedhur si komisioner në Policinë e Burgjeve, në Policinë e Shtetit dhe shërbimin informativ dhe sistemin e drejtësisë është fakti që për një periudhë të gjatë kohore kam shërbyer në institucione të ndryshme të Policisë së Shtetit, po ashtu edhe në Policinë e Burgjeve. Aktualisht, ushtroj profesionin e avokatit dhe gjatë gjithë punës dhe studimeve të mia akademike deri në mbrojtjen e gradës “Doktor i shkencave” jam udhëhequr dhe udhëhiqem nga parimi që në çdo moment primare do të jetë njohja dhe respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, si një ndër motivet kryesore nga të cilat duhet të udhëhiqet çdo punonjës apo funksionar shtetëror gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të tij në funksionin që kryen. Kjo ka qenë arsyeja kryesore pse jam i motivuar dhe studimet e mia janë të fokusuar drejt arritjes së një qëllimi final, pra njohjes dhe respektimit të këtyre lirive e të drejtave të njeriut, të cilat jo më kot edhe nga ligjvënësi janë vënë në majën e piramidës së korpusit ligjor, që, përveç konventave, janë edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit!

A ka pyetje?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Hoxha!

Në skedën e paraqitur dhe të përgatitur nga Avokati i Popullit shoh që keni përvojë relativisht të gjatë si shef i Sektorit të Krimit Ekonomik, deri në vitin 2013, më pas keni një shkëputje, keni punuar për një institut kosovar. Cila është arsyeja e ndërprerjes së punës në Drejtorinë e Policisë së Qarkut të Tiranës dhe më pas keni kaluar në një sektor privat?

Faleminderit!

Arjan Hoxha – Nuk jam larguar me dëshirën time, por jam liruar nga Policia e Shtetit me motivacionin “për shpërbërje të funksioneve organike në pamundësi emërimi në një detyrë tjetër”, në mos gaboj, diku në tetor të vitit 2013, për të cilën kam ndjekur rrugën administrative. Më një fjalë, nuk jam larguar me një masë disiplinore për shkeljen e ndonjë detyre nga unë, thjesht për ristrukturim është parë e nevojshme që unë të mos jem më pjesëtar i forcave të organizatës të

Policisë së Shtetit. Prandaj për disa vjet kam punuar në Institutin e Kosovës për Menaxhim. Gjatë qeverisë teknike kam ushtruar edhe detyrën e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kisha më tepër në aspektin e ruajtjes së informacionit, sepse ne, që kemi punuar në këto organe, kemi certifikatën e sigurisë, pra nëse je personi i duhur për t'u njohur me këto lloje informacionesh apo nëse ka ndonjë problem tjetër që mund të jesh larguar nga këto forca.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hoxha!

A ka pyetje nga kolegët e tjerë? Nuk ka pyetje.

Shumë faleminderit, zoti Hoxha! Ditë të mbarë!

Arjan Hoxha – Faleminderit! Ditë të mbarë edhe ju!

Ulsi Manja – Vazhdojmë me kandidatin tjetër Artan Ballabani për pozicionin komisioner në seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor.

Zoti Ballabani, mirë se erdhët në komision! Ashtu si edhe për të gjithë kandidatët e tjerë, edhe në dispozicionin tuaj do të keni tre minuta për t'ju shpjeguar kolegëve motivet që ju keni dhe që ju kanë shtyrë për të marrë pjesë në këtë garë, sepse dokumentacioni i kërkuar sipas ligjit është në tryezën e punës së komisionit dhe secili nga kolegët është i njohur me të paraprakisht.

Fjala është për ju.

Artan Ballabani – Faleminderit!

Të nderuar deputetë të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

Unë jam Artan Ballabani dhe jam vetofruar për pozicionin e komisionerit në seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor tek Avokati i Popullit. E vlerësoj maksimalisht procesin e zhvilluar nga institucioni i Avokatit të Popullit, i cili më dha mundësi të jem pjesë e listës së përzgjedhur nga avokati për t'u dëgjuar në Komisionin e Çështjeve Ligjore të Kuvendit të Shqipërisë. Unë kam shprehur interesin tim për t'u bërë pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit në seksionin e sipërcituar dhe këtë shprehje interesi e kam bërë nisur nga arsimimi, përvoja e punës, aftësitë profesionale të fituara në mbi 17 vjet punë, të cilat i kam parashtruar edhe në CV-në personale.

Të nderuar deputetë, mendoj se për ju është me interes të citoj disa nga parimet që i kam shprehur edhe te letra e motivimit ose në platformën që kam prezantuar tek Avokati i Popullit.

Do t'i kryej detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke u mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin për Avokatin e Popullit, Kodin e Procedurës Administrative, ligjin për të drejtën e informimit, ligjin për të drejtat e të dënuarve, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Sjelljes së Mirë Administrative dhe rregulloren e brendshme të punës në institucionin e Avokatit të Popullit. Ky është një parim që e kam pasur gjatë punës sime të përditshme.

Do të veproj në mënyrë të pavarur për sa i përket pikëpamjes politike që të mos pengoj zbatimin e politikave, të vendimeve ose të veprimeve ligjore të autoriteteve të administratës publike, parim të cilin e kam shumë të thjeshtë, pasi nuk kam qenë asnjëherë anëtar i një partie politike, deputet, ministër, zëvendësministër apo në ndonjë funksion shtetëror. E gjithë veprimtaria e punës sime është në sistemin gjyqësor, në përmbardim gjyqësor dhe prokurori.

Në kryerjen e detyrave do të jem i ndershëm, i paanshëm, duke pasur parasysh vetëm interesin publik.

Do të jem i sjellshëm në marrëdhënie me qytetarët, duke u shërbyer atyre, si dhe me eprorët, kolegët e vartësit. Ky është një parim, të cilin e kam ndjekur gjatë gjithë jetës sime dhe gjatë gjithë marrëdhënies së punës. Nuk do të veproj arbitrarisht, në dëm të asnjë personi ose organizate dhe do të tregoj respektin e duhur për të drejtat dhe interesat personale të të tretëve; nuk do të pranoj dhe lejoj që interesat private të bien ndesh me pozitën publike, do të shmang konfliktin e interesit dhe do të zbatoj Kodin e Sjelljes së Mirë Administrative.

Në programin e veprimit për emrin e pozitës së ofruar, mendoj se kam konstatuar disa problematika, të cilat janë pjesë e përditshmërisë së punës së institucioneve që mbulon ky seksion. Kam përmendur aspektin ligjor për policinë, në aspektin administrativ po për policinë, për përmbardimin gjyqësor, për gjykatat dhe jam munduar që t'i parashtroj në platformën time. Nëse do të keni kohë, mund t'i citoj?

Ulsi Manja – Nuk është nevoja, sepse i kemi.

Faleminderit!

A kanë pyetje, kolegët?

Zoti Ballabani, kam unë një pyetje: aktualisht ju jeni në punë?

Artan Ballabani – Po, jam oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat.

Ulsi Manja – Aktualisht, jeni në Policinë Gjyqësore?

Artan Ballabani – Po.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka pyetje të tjera nga kolegët.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Artan Ballabani – Faleminderit! Ju uroj punë të mbarë!

Ulsi Manja – Kalojmë me kandidaten tjetër në radhë, zonjën Edlira Cimbi.

Edlira Cimbi – Përshëndetje!

Ulsi Manja – Zonja Cimbi, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Edlira Cimbi – Faleminderit!

Ulsi Manja – Ju jeni një nga kandidatet e kualifikuara nga Avokati i Popullit për pozicionin komisioner në seksionin për organet e administratës qendrore të pushtetit vendor dhe të të tretëve, që veprojnë për llogari të tyre. Koha në dispozicion për ju është 3 minuta. I gjithë dokumentacioni që ju keni paraqitur pranë Avokatit të Popullit është administruar nga Komisioni i Ligjeve dhe kolegët e kanë mbi tavolinë, ndaj në këtë limit kohe mund të shpalosni para kolegëve të mi të komisionit, arsyet dhe motivet që ju shtynë për të qenë pjesë e kësaj gare.

Fjala është për ju.

Edlira Cimbi – Faleminderit për kohën dhe dëgjuesën e organizuar!

Jam Edlira Cimbi dhe aktualisht jam drejtoreshë e Administrimit të Brendshëm në Agjencinë e Shërbimeve Publike të Integruar, agjenci e cila varet nga Këshilli i Ministrave. Tek kjo agjenci, ku unë punoj kryesisht mbuloj çështjet ligjore, pra sektorin ligjor dhe sektorin e burimeve njerëzore të shërbimeve.

Arsyeja që më shtyu të aplikoj për pozicionin e komisionerit në Avokatin e Popullit është sa e thjeshtë, aq edhe konkrete për mua, pasi mendoj se eksperiencia 20-vjeçare, që kam kryesisht në administratën publike, sidomos 3-vjeçari i fundit, më ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë gjatë punës për implementimin e reformës në shërbimet publike, më ka bërë të njihem drejtpërdrejt me marrëdhënien qytetar-administratë publike. Pra, të jem shumë e qartë për të dyja pozicionet, aty ku ligji punon dhe vepron për të mbështetur dhe për t'u garantuar, qytetarëve të vendit, por patjetër edhe qytetarët e huaj që janë rezidentë, garantim dhe trajtim të barabartë. Por, nga ana tjetër, me organizimin e fokus grupeve të ndryshme kemi parë edhe aspektin e qytetarëve, të cilët na kanë shtuar përpjekjet për të standardizuar këto shërbime publike dhe për të rritur standardet tona, duke i përafruar ato me Bashkimin European. Mendoj se eksperiencia ime në fushën legislative dhe

titulli që unë mbaj, si avokate, do të më ndihmojë dhe do të më shërbejë që në pozicionin e komisionerit në Avokatin e Popullit të jap kontributin tim kryesor për të bërë të mundur, duke u nisur nga fakti se ai është një institucion rekomandues, që rekomandimet e këtij institucioni të kenë një forcë dhe bazë ligjore, që të merren në konsideratë nga të gjithë organet e administratës publike.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Cimbi!

Zoti Leka ka një pyetje.

Edmond Leka – Zonja Cimbi, ju përmendët se institucioni i Avokatit të Popullit është institucion rekomandues dhe jo vendimarrës. Çfarë do të bënit ju më mirë që rekomandimet tuaja të merreshin në konsideratë nga administrata shtetërore?

Edlira Cimbi – Faleminderit për pyetjen!

Është e vërtetë që është një organ rekomanduese, por mendoj se forca e argumentit që duhet të ketë një avokat, eksperiencat e tij, të cilat duhet ta rrisin atë profesionalisht, mundësia që të hartosh një raport mbi baza të forta ligjore argumenti, do të bënte të mundur që, kushdo nga administrata publike, ta konsideronte atë si një oponencë konstruktive që do t'i shërbejë.

Mendoj se instituti i Avokatit të Popullit duhet të konsiderohet si një oponencë, i cili i jep një ekspertizë ligjore administratës publike dhe nuk është një institucion, që e kundërshton administratën publike, por e ndihmon me oponencën e tij për të përmirësuar bazat ligjore.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Cimbi!

Zoti Fino, prisni sa të mbarojë zoti Leka!

Edmond Leka – A mendoni se institucioni mund të ndikojë në implementimin e reformës në drejtësi?

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Cimbi!

Edlira Cimbi – Pa diskutim, mendoj se Avokati i Popullit, si institucion, ndikon dhe do të ndikojë gjatë gjithë periudhës, ashtu siç ka vazhduar dhe po vazhdon të implementohet reforma në drejtësi, dhe këtë gjë ai e ka në detyrat e tij funksionale. Por me ndryshimet që i janë bërë Kushtetutës është parashikuar që në përzgjedhjet e disa kandidatëve, në disa nga strukturat kryesore siç janë KLP-ja dhe KLGGJ-ja, Avokati i Popullit, përveç faktit të monitorimit, ka edhe të drejtat të shqyrtojë dosjet e atyre kandidatëve që vijnë nga përzgjedhja e avokaturës apo e shërbimit civil.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Cimbi!

Zoti Fino e ka kërkuar fjalën për pyetje.

Bashkim Fino - Faleminderit, zonja Cimbi!

Kam një pyetje më shumë për kureshtje: në këto momente ju jeni drejtoreshë e Administrimit të Brendshëm, pranë ADISA-s, goxha pozicion dhe goxha CV-i, që nuk ka nevojë për koment. Ndërkohë, kandidoni për komisionere në seksionin e organizatës qendrore të pushtetit vendor dhe të tretëve, që veprojnë tek Avokati i Popullit. Me CV-në që unë shikoj, ju keni eksperiencë për shërbimet publike apo edhe për institucionet qendrore, a keni eksperiencë për pushtetin vendor?

Edlira Cimbi – Faleminderit për pyetjen!

Siç edhe ju e cilësuat pak më parë, eksperiencën në administratën qendrore jo vetëm në këtë 3-vjeçar, por edhe më parë, pasi kam punuar në dy shoqëri tregtare, që janë dy shoqëri strategjike, siç ka qenë Albtelekomi dhe ARMO, që kanë qenë kapital publik, në këtë kuadër kam pasur një marrëdhënie konkrete, të drejtpërdrejtë si me pjesën e shoqatave të konsumatorëve, ashtu edhe në rastin e ARMO-s, kur kanë qenë punonjësit vendorë, të cilët mbanin komplet kombinatin e Ballshit dhe të Mallakastrës dhe herë pas here na kanë përplasur me situatat në lidhje me pushtetin vendor gjatë asaj periudhe. Aktualisht, në pozicionin që kam, një nga pikat kryesore të reformës së shërbimit publik është mundësia e përafrimit të standardeve të shërbimeve qendrore edhe me ato të pushtetit vendor, pavarësisht se pushteti vendor ka pavarësinë e tij. Ne jemi munduar që të paktën gjatë kësaj periudhe 3-vjeçare të kemi një bashkëpunim të mirë.

Ulsi Manja – Në rregull.

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Zoti Shameti ka kërkuar fjalën për pyetje.

Adnor Shameti - Faleminderit, zoti kryetar!

Një kuriozitet më shumë se sa pyetje, sepse po shikoj se po aplikojnë për këto pozicione të Avokatit të Popullit, për shembull, zotëria më parë ishte nga Policia Gjyqësore, zonja është në një pozicion shumë të rëndësishëm: e kërkon këtë pozicion për të qenë më rehat, apo për të qenë më intriguese?

Ulsi Manja - Zoti Shameti, si përherë është praktik.

Edlira Cimbi – Faleminderit, do t’jua shuajmë kureshtjen për këtë gjë!

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja - Zoti Shameti, më rehat kupton atë që të shkosh në punë, por, ju lutem, mund të vazhdoni!

Edlira Cimbi – Nuk ka problem, unë do t’jua shuaj kuriozitetin. Nuk mendoj aspak se pozicioni që aktualisht kam është më i vështirë apo më i rehatshëm se nga ai që po kërkoj. Ashtu siç sqarova edhe më parë, në rastin e Avokatit të Popullit, është një institucion, i cili, duke qenë rekomandues, mendoj se kërkon një angazhim shumë më të madh për ta detyruar dhe për ta ngritur në një nivel ekspertize. Në qoftë se i referohemi sot Komisionit të Venecies, është shumë i hapur mendimi.

(Diskutime pa mikrofon)

Mendoj se po, sepse të them të drejtën, jam njeri që motivohem nga qëllimi.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Cimbi!

Jam i bindur se zoti Shameti është i qartë në këtë pikë.

Faleminderit për prezencën tuaj në komision!

Edlira Cimbi – Ju falënderoj edhe juve për dëgjuesën dhe për pyetjet!

Ulsi Manja – Vazhdojmë me kandidaten tjetër në radhë, zonjën Eriona Canaj.

Mirë se erdhët në komision, zonja Canaj!

Eriona Canaj – Faleminderit!

Ulsi Manja - Ju jeni një nga kandidatet e kualifikuara nga Avokati i Popullit për pozicionin e komisionerit në seksionin për organet e administratës qendrore të pushtetit vendor dhe të të tretëve, që veprojnë për llogari të tyre. Koha në dispozicion për ju është 3 minuta. Pastaj kolegët ndoshta kanë pyetjet e tyre. Dokumentacioni juaj është i plotë dhe është në tryezën e punës së komisionit, ndaj shkurtimisht na thoni: pse dëshironi të shkoni komisioner tek Avokati i Popullit?

Eriona Canaj - Faleminderit!

Quhem Eriona Canaj, vij nga bota akademike dhe kam 10 vjet që e ushtroj këtë profesion. Ekspertiza ime lidhet me të drejtat e njeriut dhe e drejta e Bashkimit Europian. Kështu që në gjithë këto vite, le të themi se kam zhvilluar këtë lloj fushe, që është për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke sjellë në auditor qoftë pjesën teorike ashtu edhe rastet më praktike qoftë në nivel kombëtar, ashtu edhe europian dhe rajonal të Gjykatës së Strasburgut.

Patjetër që CV-ja ime është aty dhe keni pasur rastin që ta shikoni, prandaj nuk po zgjatem te pjesa e CV-së dhe e performancës sime, por le të themi se qëllimi dhe objektivat që kam lidhur me pozicionin që unë po aplikoj.

Kam pasur dëshirë që të marr pjesë në këtë pozicion pune në qoftë se do të krijohet mundësia dhe do të fitoj, kam dëshirë ta shikoj këtë fushë edhe nga pjesa praktike lidhur me trajtimin e rasteve që mund të vijnë për pretendim për shkelje ose cenim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kështu që, në këtë këndvështrim, mendoj se mund të jap kontributin qoftë edhe nga pikëpamja praktike.

Mendoj se deri diku e përmbush këtë pjesë, pasi jam marrë shpesh me shkeljet ose rastet e dhunimit, ose cenimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në këtë këndvështrim, mendoj se mund të japim edhe një kontribut në disa drejtime kryesore:

Së pari, lidhur me kompetencat lëndore që më atribuon ligji. Kështu që në këtë këndvështrim do t'u përmbahem të gjitha atyre kushteve të të tretëve që ka thënë ligji për punën e përditshme. Mendoj se mund të ketë diçka më shumë nga pikëpamja e performancës sime. Domethënë, një trajtim të rasteve specifike, kërcënim të të drejtave dhe pretendim të shkeljeve dhe lirive themelore të njeriut. Ndërkohë, përmirësimin e performancës dhe hartimin e raportimit, qoftë edhe në nivel rajonal, raportimi, hartimi dhe përpilimi e opinioneve dhe mendimeve ligjore të ndryshme për përmirësimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në këtë drejtim mendoj se një plus tjetër, do të jetë edhe bashkëpunimi me organizma ose me institucione të tjera ku patjetër të lidh puna në përditshmëri, qoftë shoqëria civile, qoftë titullarë ose drejtuesit e institucioneve...

Bashkim Fino - Të bëj një pyetje.

Ulsi Manja – Zoti Fino, të mbarojë zonja Canaj.

Paskeni folur pa mikrofon.

Zoti Fino, një sekondë, sepse zonja paska folur pa mikrofon.

Bashkim Fino – Nuk ka problem.

Ulsi Manja – Nuk kemi hallin tënd.

Mund të vazhdoni zoti Fino.

Bashkim Fino – Pyetja ime është e drejtpërdrejtë. Ju jeni një pedagoge e të drejtës publike. Unë shikoj se ju po kandidoni, pavarësisht se jeni me një CV-i të pasur, për komisionin e seksioneve të organeve të administratës qendrore të pushtetit vendor. Ndërkohë për mua do të ishte më mirë të konkurronit për komisioner në seksionin e përgjithshëm apo komisioner në sesionin e policisë, komisioner në shërbimet e Forcave të Armatosura e të tjera, që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut, në thelbin e asaj që ju jepni dhe mësim, se sa me organet e pushtetit qendror

dhe pushtetit vendor. Gjithsesi, CV-ja e saj është shumë më kompletuar. Mos vallë duhet të kandidonit në këto dy pozicione të tjera se sa në këtë pozicion? Këtë e kam thjesht për kulturë.

Eriona Canaj – Përshëndetje!

Unë ju falënderoj për ndërhyrjen tuaj!

Në fakt, unë kam kandiduar në dy pozicione, megjithatë njëri prej tyre me sa duket, nuk ishte shënuar në protokoll dhe më thanë se je rezultuese vetëm për këtë pozicion, kështu që do t'i shkoj deri në fund.

Ulsi Manja – Më fal, se më hape pak debat: ju në kërkesën tuaj keni aplikuar për dy pozicione?

Eriona Canaj – Nuk ka problem.

Ulsi Manja – Jo, jo ka problem për ne.

Eriona Canaj – Po kam aplikuar për dy pozicione: për seksionin e përgjithshëm dhe për administratën.

Ulsi Manja – Po të kalojmë ne tek ai përgjithshmi. Kërkesa juaj ka qenë për dyja pozicionet dhe kriteret janë unike. Pra, të tria pozicionet kushtet dhe kriteret e ligjit janë unike për kandidatët.

Eriona Canaj – Po intervistën e parë tek Avokati i Popullit e kam bërë për të dyja pozicionet.

Ulsi Manja – Jam dakord.

A mund ta kemi ne një aplikim tuajin për të dyja pozicionet, kërkesën që keni depozituar tek Avokati i Popullit?

Eriona Canaj – Patjetër, unë e kam dorëzuar atje dhe për secilën prej tyre kam dorëzuar edhe nga një platformë specifike.

Ulsi Manja – Të mbahet shënim.

Eriona Canaj – Kështu që mund ta integroj.

Ulsi Manja – Zoti Baku, dua kërkesën për aplikim të zonjës në dosje.

Faleminderit!

Kolegia Bushka ka një pyetje.

Klotilda Bushka – Vetëm një pyetje të thjeshtë, sepse është shumë e qartë nga materialet që keni depozituar, edhe nga mënyra se si u prezantuat, CV-ja dhe kualifikimi juaj. Vetëm se te gjuhët e huaja shikoj vetëm italisht. Dua të di: cilat janë gjuhët e huaja, sepse tek Avokati i Popullit

puna në gjuhën angleze, duke iu referuar të gjithë monitorimeve që ka Shqipëria, ku Avokati i Popullit ka rol është shumë e rëndësishme? Në skedën tuaj të përmbledhjes së dosjes që vjen nga Avokati i Popullit është shënuar vetëm italisht.

Ulsi Manja – Urdhëroni!

Eriona Canaj – Në fakt, jam njohëse e mirë e anglishtes, italishtes dhe bazik gjermanisht dhe spanjisht.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Baku, para se t’ia kaloj zonjës Hysi, shikoj se kërkesa e zonjës Canaj, që në datën 24.09.2018, është specifikisht për pozicionin komisioner në seksionin e përgjithshëm, objekt i veprimtarisë është: mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe grupeve vulnerabël, si dhe trajtimi i çështjeve që lidhen me arsimin dhe kujdesin shëndetësor. Pra, kërkesa juaj ka qenë për në pozicionin e seksionit të përgjithshëm. Ju thoni për të dyja pozicionet?

Eriona Canaj – Po.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Canaj, për aplikimin!

Në fakt, është e dyta herë që vini në parlament, sepse keni ardhur edhe për institucionet e vetingut. Unë kam një pyetje lidhur me aplikimin që ju po bëni tani për të punuar si komisioner pranë Avokatit të Popullit. Cila do të ishte vlera e shtuar? Çfarë do të bënit ndryshe nga çfarë ka bërë deri më sot seksioni i përgjithshëm i zyrës së Avokatit të Popullit?

Së dyti, ju thatë se keni aplikuar edhe për një seksion tjetër, cili është seksioni tjetër për të cilin kishit aplikuar?

Eriona Canaj – Në seksionin e përgjithshëm.

Vasilika Hysi – Po, ky është, sepse e keni me dokument. Po seksioni tjetër?

Eriona Canaj – Seksioni i administratës qendrore.

Ulsi Manja – Nuk ka kërkesë për këtë.

Eriona Canaj – I pari është i përgjithshmi, kurse i dyti është seksioni i organeve të administratës qendrore të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre. Këto janë dy pozicione që unë kam aplikuar.

Çfarë do të sillja më shumë: mendoj eksperiencia ime, profesionalizmi, gjithashtu të shtoj rastet e ndjekjes me iniciativë, përmirësim në hartimin e rekomandimeve dhe opinionëve ligjore,

ndjekjen rast pas rasti dhe më pas përfundimin me sukses të atyre pretendimeve që na vijnë. Patjetër kjo do të jetë në sajë të eksperiencës sime dhe të përmirësimit nga ana akademike dhe profesionale e imja.

Vasilika Hysi – Së fundi, aktualisht jeni dekanë në Fakultetin Juridik. Çfarë ju shtyn që të lini pozicionin e dekanes dhe gjithë këtë karrierë që keni bërë në fushën e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies për të kaluar tek Avokati i Popullit.

Eriona Canaj – Aktualisht, nuk jam më dekanë, kam dhënë dorëheqjen për shkak të pozicioneve të riorganizimit të fakultetit. Kështu që jam profesoreshë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Në fakt, zonja Canaj, unë vazhdoj të këmbëngul te pjesa e kërkesës ti do ta kesh shtuar me gojë atje kur ke shkuar tek Avokati i Popullit

Eriona Canaj – Jo, kam dorëzuar dokumentacionin.

Ulsi Manja – Unë këtu kam dokumentacionin. Kërkesën për pozicionin e parë ka seksionin e komisionarit të përgjithshëm dhe këtu e ka kërkesën me shkrim, dhe nuk më rezulton në dosje që të ketë një kërkesë për te seksioni i administratës. Kjo është e gjitha. Nuk po them se ti konkurron për të dyja, por me shkrim kërkesën e ke për atje. Kjo ka lidhje me procedurën e rregullt të ndjekur tek Avokati i Popullit, nuk ka lidhje me ty. Ti je e lirë të konkurrosh.

Bashkim Fino – Disa kanë ardhur me kërkesë për dy seksione për komisionerët.

Ulsi Manja – Në fakt, kjo ka ardhur vetëm me një seksion.

Eriona Canaj – I kam dorëzuar të dyja.

Ulsi Manja – Jo i është mohuar e drejta të jetë pjesë në të dyja, sepse është vetëm në seksionin e komisionerit të përgjithshëm.

Eriona Canaj - Intervistën përpara Avokatit të Popullit e kam bërë për të dy pozicionet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si mund ta provoj?

Ulsi Manja – Unë kam një problem me procedurën atje. Ju keni konkurruar për dy pozicione ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka mbaruar procedurën atje. Për procedurën e ndjekur atje do të kemi vendimarrje të tjera të Kuvendit.

Ju keni konkurruar për të dy pozicionet, i plotësoni kriteret për të qenë një nga kandidatët, por, në fakt, je vetëm për njërin pozicion dhe nuk je kualifikuar për të pozicioni tjetër. Ndërkohë, kërkesa është për Komisioner të Përgjithshëm.

Erjona Canaj – Te njoftimi “keni rezultuar fituese”, në fakt, është për Seksionin e Organeve të Administratës Qendrore.

Ulsi Manja – Tani e zgjidhim në këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erjona Canaj - Njoftimin e kam.

Ulsi Manja – Cilin njoftim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Njoftimin e Avokatit të Popullit?

Ajo ka kërkuar grurë, këta e kanë marrë në intervistë për misër.

Shumë faleminderit për prezencën tuaj në komision, zonja Canaj!

Erjona Canaj – Edhe unë ju falenderoj dhe ju uroj punë të mbarë!

Ulsi Manja – Vazhdojmë me kandidatin tjetër në radhë, zonja Ermonela Ruspi.

Ermonela Ruspi – Përshëndetje!

Ulsi Manja - Përshëndetje, zonja Ruspi! Mirë se erdhët në komision!

Ju jeni kandidate për në dy pozicione; Komisioner për Seksionin e Përgjithshëm dhe Komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor.

Dokumentacioni juaj është i plotë dhe ndodhet në tryezën e kolegëve të mi të komisionit. Ju lutem paraqisni shumë shkurt në harkun kohor të 3 minutave, si të gjithë kandidatët, arsyet që ju shtyn të bëheni pjesë e kësaj gare.

Fjala është për ju.

Ermonela Ruspi – Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë!

Fillimisht ju falenderoj për mundësinë që më dhatë për të më dëgjuar në komisionin tuaj!

Nisur nga përvoja ime 17-vjeçare akademike dhe profesionale, që pothuajse është e mbështetur në fushën e të drejtave të njeriut, vendosa të kandidoj për pozicionin e Komisionerit

në Seksionin e Përgjithshëm dhe në Seksionin për Policinë, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor. Ndër objektivat kryesore, nëse do të më jepej mundësia për të qenë komisionere, do të ishin:

1. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore brenda dhe jashtë vendit, për të kryer studime të përbashkëta me qëllim hartimin apo përmirësimin e politikave strategjike, legjislacionin në fushën e të drejtave të njeriut, krijimin e mundësive më të mëdha për informacion të qytetarëve tek Avokati i Popullit, integrimi edukimit për të drejtat e njeriut në të gjitha planet mësimore të sistemit arsimor shqiptar, jo vetëm në sistemin parauniversitar, nëpërmjet kurrikulave me zgjedhje apo si tema të veçanta në lëndët shoqërore në arsimin e mesëm, por edhe në sistemin e lartë.

2. Duke qenë se vij nga fusha akademike, sugjeroj që në programet e sotme, që organizohen nga universitetet, të jetë edhe edukimi për të drejtat e njeriut. Duke qenë se ne formësojmë profesionistët e ardhshëm publikë, është momenti i duhur që ata të edukohen me këto të drejta, në mënyrë që kur të përballen në administratën publike me individë apo grupe individësh për të kërkuar shërbime publike, të mos cenojnë nëpërmjet veprimeve të tyre apo mosveprimeve të paligjshme apo të parregullta të drejtat themelore të njeriut.

3. Një objektiv tjetër në interes të Seksionit të Policisë, Shërbimit Sekret dhe Burgjeve, është lobimi për gjenerimin e burimeve të mjaftueshme financiare nga ana e shtetit tek institucionet penitenciare, kjo për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, si: krijimi i kushteve të përshtatshme infrastrukturore, sigurimi i bazës materiale të nevojshme për të garantuar respektimin e të drejtave ligjore ndaj të paraburgosurve dhe të dënuarve, ofrimi i shërbimit shëndetësor dhe atij psikosocial, ofrimi i mundësisë për arsim dhe kurse të formimit profesional.

4. Njëkohësisht, në bashkëpunim me agjencitë përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, të bëhet trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të policisë për njohjen e akteve normative dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

5. Duhet punuar më shumë me sistemin e shkollave dhe me universitetet për afirmimin e të drejtave të njeriut. Duhet punuar nëpërmjet bërjes së aktiviteteve dhe dhënies së informacioneve për ta njohur më mirë këtë institucion.

Ulsi Manja - Shumë faleminderit, zonja Ruspi!

Po, zoti Fino!

Bashkim Fino – Zonja punon në Universitetin e Gjirokastrës dhe ka ardhur sot këtu, ndaj unë duhet të jem shumë i lumtur.

Ju thoni në CV-në tuaj sa nga data 02. 10. 2017 e në vazhdim jeni dekane e Fakultetit Ekonomik ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E në vazhdim thoni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, ju lini pozicionin e dekanes, që është goxha i lartë, dhe kërkoni të bëheni Komisionere në institucionin e Avokatit të Popullit.

Pse doni ta lini pjesën akademike? Përveç kësaj, keni qenë gjatë gjithë kohës anëtare e Senatit Akademik të Universitetit. Një nga pikat që studentët po diskutojnë është pikërisht moszgjidhja e problemit të senateve në përgjithësi, ku ju jeni një nga anëtarët.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja Ruspi.

Ermonela Ruspi – Unë kam kandiduar për këto pozicione para se të ndodhte protesta e studentëve, megjithatë jam në mbështetje të plotë të tyre dhe kam ngritur zërin edhe në organet vendimmarrëse për të drejtat e tyre. Një nga arsyt pse kemi arritur në këtë lloj gjendjeje është mungesa e informacionit dhe e transparencës për studentët.

Kam dëshirë të punoj si komisionere pasi të gjitha studimet e mia, si masteri, doktoratura dhe më pas i gjithë aktiviteti shkencor është fokusuar në fushën e të drejtave të njeriut. Mendoj se ka ardhur momenti që këtë *background* të krijuar në vite ta praktikoj në pozicionin e komisionerit.

Bashkim Fino – Shumë faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zonja Ruspi.

Po., zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ruspi!

Nëse ju do të merrni votëbesimin e Kuvendit, çfarë do të bënit ndryshe në drejtimin e seksionit që keni përzgjedhur në krahasim me punën që po bën aktualisht Avokati i Popullit?

Ermonela Rusi – Duke qenë se vij nga fusha akademike unë i mëshoj integritetit të edukimit të të drejtave të njeriut në ambientet universitare. Duke u njohur më mirë të drejtat e

njeriut, dhe këtu kemi përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm publikë, që do të jenë pjesë e administratës publike, studentët do të jenë të gatshëm dhe do të garantojnë gjatë dhënies së shërbimeve publike moscenimin e të drejtave themelore të subjekteve të vendosura.

Vasilika Hysi - Vetë Avokati i Popullit ka për detyrë promovimin, por jo vetëm. Ju çfarë do të ofroni ndryshe në mënyrë që ne duhet t'ju votojmë?

Ermonela Rusi – Do të ofroj mbrojtjen e kategorisë së shtresave vulnerabël, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, gratë e dhunuara e të tjera, me streha në çdo njësi administrative, si dhe lobimi më të madh për sa i përket buxhetimit, që edhe pjesa e infrastrukturës me numrin e shtretërve apo edhe me asistencën teknike, psikologë, sociologë, juristë e me radhë, të ishte më e gjindshme në të gjitha zonat e Shqipërisë për ta asistuar këtë gjë.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Ruspi!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Shumë faleminderit për prezencën në komision dhe ditë të mbarë!

Ermonela Rusi – Ju falenderoj!

Ulsi Manja - Vazhdojmë me kandidatin tjetër në radhë, zotin Ilir Kadiu.

Përshëndetje, zoti Kadiu! Ju jeni kandidat për pozicionin e Komisionerit në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor.

Dokumentacioni juaj është i plotë dhe kolegët e kanë mbi tryezë.

Ju lutem që brenda 3 minutave të prezantoni se cilat janë motivet që ju shtynë për të qenë pjesë e kësaj gare.

Fjala është për ju.

Ilir Kadiu - Faleminderit!

Pak a shumë roli i institucionit të Avokatit të Popullit dihet tashmë që ka të bëjë me garantimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Punën e tij funksionale kryesisht ky institucion e ushtron në bazë të hartimit të raporteve dhe rekomandimet që jep. Raportet kryesisht janë një hetim i thelluar administrativ. Këto raporte konsistojnë në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe identifikimin e personave të administratës publike, në rast të veprimeve apo mosveprimeve, kur kanë kryer shkelje administrative.

Dua të theksoj se hovi më i madh që mund të japim në hartimin dhe përpilimin e raportit që harton ky institucion, do të ishte kryesisht në fushën e përmirësimeve ligjore dhe kuadrit ligjor të institucionit, që do të jenë objekt kontrolli, sepse vetëm rritja e performancës së këtyre

institucioneve mund të na bëj që nesër të reduktojmë cenimin apo shkeljen e interesave apo të drejtat legjitime që mund të kenë qytetarë të ndryshëm. Pra, që të realizojmë një raport të besueshëm, duhet të kemi pak a shumë këto dy komponentë: raporti të jetë profesional, si dhe të jetë i paanshëm dhe i pandikueshëm. Në momentin kur ne rrëzojmë këta dy komponentë në momentin e hartimit dhe realizimit të raportit të institucionit të Avokatit të Popullit, mund të themi se kemi realizuar një raport të besueshëm në marrëdhënie me publikun.

Prandaj, gjatë hetimit administrativ, i mëshoj fort idesë se në bashkëpunimi i ngushtë me institucionin që është objekt hetimi, por edhe me agjenci të tjera, me shoqërinë civile, që ka ekspertizë në përmirësimin e kuadrit ligjor, aty ku kërkohet një amendim i Rregullores, një urdhër administrativ i titullarit apo një udhëzim, qoftë edhe një amendim i një VKM-je, do ta rriste ndjeshëm performancën e këtij institucioni, duke eliminuar shkakun e kësaj pasoje që na ka ardhur në rastet e një cenimi apo të një të drejte qytetare.

Në këtë kuadër, vetëm duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe me shoqërinë civile mund të arrijmë të hartojmë raporte të besueshme. Raporti i besueshëm bëhet vetëm duke u hartuar në mënyrë profesionale dhe të paanshme. Kjo është arma që ka institucioni i Avokatit të Popullit për raportin dhe rekomandimet.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Kadiu!

Zonja Hysi ka një pyetje.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Kadiu, që keni aplikuar në këtë institucion të nderuar dhe jeni përzgjedhur për t'u intervistuar!

Po shikoj CV-në tuaj, e cila është pasur në fusha që kanë të bëjnë me administratën publike. Masterin e keni bërë për të drejtën administrative, keni punuar në port, keni punuar si jurist në projekte të ndryshme, në bashki.

Pyetja ime është: pse nuk keni aplikuar për seksionin e përgjithshëm apo për seksionin e organeve të administratës vendore dhe qendrore, ku keni një CV-i shumë të pasur dhe keni përzgjedhur një seksion që lidhet me penalen: burgje, polici, shërbime inteligjente e të tjerë?

Së dyti, çfarë do t'i sillnit këtij seksioni, që ne të të votojmë?

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Hysi!

Shtypeni mikrofonin, zoti Kadiu.

Ilir Kadiu - Kjo është e vërtetë, zonja deputete. Edhe unë e kam pasur këtë dyshim dhe këtë dilemë brenda vetes sime në momentin që do të aplikoja, por edhe eksperiencia ime në fushën e avokatisë më ka dhënë shumë, që të mësoj në kuadrin e policisë, të burgjeve, por edhe të gjyqësorit dhe prokurorisë, që bëjnë pjesë në këtë seksion. E kam pasur dilemën se në cilin seksion do të kandidoja. Eksperiencia në fushën e avokatisë më ka dhënë mundësinë të aplikoj në këtë seksion.

Ulsi Manja - Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Kadiu!

Ditë të mbarë!

Ilir Kadiu - Faleminderit juve!

Ulsi Manja - Vazhdojmë me kandidatet e fundit në garë për këtë seancë dëgjimore, zonjën Vilma Shurdha.

Mirëdita, zonja Shurdha dhe mirë se keni ardhur në komision!

Vilma Shurdha - Faleminderit!

Ulsi Manja - Ju jeni kandidate për në pozicionin e komisionerit në seksionin për organet e administratës qendrore të pushtetit vendor dhe të tretëve, që veprojnë për llogari të tyre, si dhe në seksionin e përgjithshëm. Pra, jeni kandidate për dy pozicione.

Vilma Shurdha - Në seksionin e përgjithshëm në kuadër të platformës së dorëzuar dhe më pas të administratës.

Ulsi Manja - Po, për dy pozicione.

Vilma Shurdha – Po, për të dyja pozicionet.

Ulsi Manja - Pra, edhe për pozicionin e komisioneres në seksionin e përgjithshëm, edhe për komisionere në seksionin e administratës qendrore dhe pushtetit qendror.

Kolegët e kanë dokumentacionin tuaj mbi tavolinë, i cili është i plotë.

Do t'ju lutesha që, shkurtimisht, në harkun kohor prej 3 minutash, të na thoni motivet që ju shtynë të bëheni pjesë e kësaj gare. Më pas kolegët kanë të drejtën t'ju bëjnë pyetje.

Fjala është për ju.

Vilma Shurdhi - Faleminderit!

E paraqes kandidaturën time në kuadër të mandatit për komisioner në seksionin e përgjithshëm, pas bindjes se pas një eksperience të konsoliduar në sektorin privat, si

avokate (po flas për një eksperiencë 19-vjeçare, nga të cilat 12 vjet i përkasin ngushtësisht sektorit të punës sime si avokate dhe 7 vjet në sektorin publik, por natyrisht me një fokus në çështje që lidhen ngushtësisht me trajtimin e problematikave ligjore), i plotësoj kriteret e nevojshme për të kontribuar në përmbushjen e misioni të komisionerit, nisur nga fakti se ajo çfarë kam bërë gjatë këtyre 4 vjetëve përkon, konvergjon me rolin institucional të Avokatit të Popullit, që është mbrojtja e interesave të ligjshme ndaj veprimeve të rregullta apo mosveprimeve të rregullata apo të parregullta të administratës shtetërore. Prandaj, kam bindjen se eksperiencia ime pararendëse si avokate, praktikisht për një pozicion të tillë, është një vlerë e shtuar, përpos angazhimit tim për një dedikim profesional në funksion të përmbushjes së këtij misioni.

Ulsi Manja - Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Leka ka pyetje.

Edmond Leka - Faleminderit!

Faleminderit, zonja Shurdha!

Një pyetje kam: a e shikoni institucionin e Avokatit të Popullit si një strukturë që do të ndikojë në implementimin e reformës në drejtësi?

Vilma Shurdha - Institucioni i Avokatit të Popullit, në kuadër të detyrës funksionale të tij, pas përmbylljes së hetimit, ka rekomandimet, të cilat ndikojnë dhe përshkallëzohen deri në rekomandime legjislative për të targetuar problematikën e evidentuara. Kështu që në këtë kuadër, nëse evidentohen problematika, të cilat mund të targetohen dhe të gjejnë zgjidhje nëpërmjet ndryshimeve legjislative... Avokati i Popullit ka një rol në kuadër të rekomandimeve legjislative, tashmë për të targetuar elementet që duhet të gjejnë zgjidhje.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Shurdha!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Vilma Shurdha - Faleminderit!

Ulsi Manja - Atëherë, këtu mbaruam me seancën dëgjimore.

Para se ta mbyll mbledhjen e komisionit, më lejoni, të nderuar kolegë, t'ju vë në dijeni se në adresë të komisionit ka ardhur një ankesë nga njëri prej kandidatëve të përfshirë në garë, i cili nuk është kualifikuar në fazën e parë nga Avokati i Popullit. Bëhet fjalë për zotin Sotiraq Nushi, aktualisht ndihmëskomisioner i Avokatit të Popullit, i cili ngre disa shqetësime në lidhje me

procedurën e ndjekur nga Avokati i Popullit për trajtimin e kandidaturave të paraqitura pranë atij institucioni për pozicionin e 3 seksioneve.

E bëra këtë trajtim, sepse letra ngre dy probleme, që janë shqetësuese.

I pari, ka të bëjë me përmbushjen e kushteve dhe kriterëve që kërkon ligji, por sidomos të kushteve ligjore nga kandidatët që janë kualifikuar. Këshilltari i komisionit, së bashku me relatorin do të duhet të verifikojnë në mënyrë rigorozë përmbushjen e kushteve ligjore. Ka pretendime se disa prej kandidatëve të kualifikuar nuk përmbushin kushtin ligjor 10 vjet në profesion. Ndaj, ju ftoj që për të gjitha kandidaturat e paraqitura për secilin nga pozicionet, të shikohet me përparësi plotësimi i kushteve.

Së dyti, ngihet një pretendim për procesin e hapur publik dhe thotë: “Në shkelje të rëndë të nenit 33/1, pika 4, Avokati i Popullit nuk ka marrë në shqyrtim verifikimin dhe përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore me anë të një procesi të hapur dhe publik. Nuk është bërë publike lista e kandidatëve për komisionerë pas përfundimit të afatit kohor të shkrehjes së interesit; nuk është bërë publike metodologjia dhe niveli i vlerësimit të kandidatëve që morën pjesë në konkurrim, për çdo kusht ligjor dhe kriter të parashikuar në ligj; nuk u bë publik, as të paktën me pjesëmarrjen e punonjësve të një institucioni, procesi i konkurrimit të kandidatëve dhe paraqitja e platformave pranë komisionit *add hoc*, i ngritur pranë institucionit të Avokatit të Popullit; nuk është bërë publike lista me renditjen e kandidatëve nga ana e komisionit *add hoc*; nuk u bë publike lista dërguar Komisionit për Çështjet Ligjore.”

Pra, këtu ngrihen pretendime të shkeljes së nenit 33, pika 1, që ka të bëjë me procesin e hapur dhe publik, si detyrim ligjor.

Në këto kushte, do të kërkoja mirëkuptimin e kolegëve të komisionit, që për të gjitha këto shqetësime, në emër të komisionit, t'i kërkojmë institucionit të Avokatit të Popullit të na japë shpjegime për procedurën ligjore të ndjekur, në zbatim të nenit 33/1, pika 4, që ka të bëjë me procesin e hapur dhe publik.

A janë respektuar këto hapa, që i detyron ligji, nga institucioni i Avokatit të Popullit? Për secilën nga këto shqetësime, duhet të bashkëngjitet edhe dokumentacioni. Le të themi: u mbyll faza e shprehjes së interesit, atëherë ligji detyron të bëhet publike lista e kandidatëve. Ne duam faqen e internetit dhe listën e bashkangjitur, që t'i vihen në dispozicion komisionit. Këtë gjë e kërkoj edhe nga relatorja. Shkresa që do t'i shkojë Avokatit të Popullit, do të shkojë në emër të Komisionit të Ligjeve, sepse kjo ankesë i është drejtuar Komisionit të Ligjeve, por edhe Kuvendit

të Shqipërisë. Kjo është arsyeja që unë e bëra trajtimin e kësaj shkrese në komision, sepse letra i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë dhe ka hyrë në mënyrë zyrtare me numër protokolli.

Bledar Çuçi - A mund të bëj një pyetje, zoti kryetar?

Ulsi Manja - Po.

Bledar Çuçi - Faleminderit!

Çfarë ndodh nëse vihet re se janë bërë parregullsi? A përsëritet procedura?

Ulsi Manja - Këtë nuk di ta them me siguri, por di që Kuvendi, me vendimmarrjen e tij, mund t'i kthejë mbrapsht të gjitha kandidaturat me votë, për ta rihapur procesin nga e para.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër! Në dijeninë time e ka seanca plenare.

Po, zoti Baku.

(Diskutime pa mikrofon.)

Seanca plenare ka attribute të plota dhe kandidatët mund të riaplikojnë nga e para. Gjithsesi, zoti Baku dhe relatorja do të bëjnë një hetim, për të parë se si është zbatuar neni 33, pika 1 e ligjit.

Faleminderit për durimin, pasi ka qenë një seancë e gjatë!

Besoj se edhe nesër do të kemi një seancë të gjatë në Komisionin e Ligjeve, pasi Kuvendi i Shqipërisë ka dy data në dispozicion, datën 20 dhjetor dhe datën 21, ku do të diskutohet posaçërisht vetëm nisma e opozitës për vetingun në politikë. Data 20 është data e fundit kur duhet të kalojnë edhe ligjet që kemi në dorë, siç është ligji i noterisë dhe ligjet e paketës së tokës.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare

Klotilda Bushka (Ferhati)

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit

Edlira Rama

